VENDIM
Nr. 1077, datë 24.12.2020

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PESTË PERIODIK KOMBËTAR MBI ZBATIMIN E KONVENTËS "PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 1, të ligjit nr. 7767, datë 9.11.1993, "Për aderimin në konventën 'Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave'", me propozimin e Kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit të pestë për zbatimin e konventës së OKB-së "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave

SHQYRTIMI I RAPORTEVE, DËRGUAR NGA SHTETET PALË NË MBËSHTETJE TË NENIT 18, TË KONVENTËS SË OKB-së, PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE

SHQIPËRIA

Raporti i V Periodik Kombëtar

2020

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTIMEVE
I. HYRJE
II. MASAT E NDËRMARRA PËR ZBATIMIN E 16 NENEVE KRYESORE TË KONVENTËS, REKOMANDIMEVE TË KOMITETIT DHE VËZHGIMEVE PËRFUNDIMTARE
Neni 1 - Përkufizimi i diskriminimit ndaj grave
Neni 2 - Detyrimet kryesore
Neni 3 - Mekanizmat Kombëtarë për Mbrojtjen e të Drejtave të Grave
Neni 4 - Masat e veçanta të përkohshme
Neni 5 - Stereotipat gjinore
Neni 6 - Trafikimi
Neni 7 - Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike

Neni 8 - Përfaqësimi i grave në arenën ndërkombëtare
Neni 9 - Shtetësia
Neni 10 - Arsimi
Neni 11 - Punësimi
Neni 12 - Shëndetësia
Neni 13 - Përfitimet ekonomike dhe sociale
Neni 14 - Gratë rurale
Neni 15 - Barazia para ligjit
Neni 16 - Martesa dhe marrëdhëniet familjare
Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim
Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm
Mbështetja Teknike
SHTOJCA

LISTA E SHKURTIMEVE

AP	Avokati i Popullit
BE	Bashkimi Evropian
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DNJF	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas
KB	Kombet e Bashkuara
KiE	Këshilli i Evropës
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KKBGJ	Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MD	Ministria e Drejtësisë
MB	Ministria e Brendshme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OJF	Organizatë Jo Fitimprurëse
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
QKPA	Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkues
RSH	Republika e Shqipërisë
DPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
VP	Vëzhgimet Përfundimtare

I. HYRJE

Republika e Shqipërisë ka nderin të paraqesë Raportin e Pestë Periodik Kombëtar mbi zbatimin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave[1] para Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Komiteti CEDAW).

Ky raport i përgatitur në zbatim të nenit 18 të Konventës (CEDAW), u hartua në përputhje me udhëzimet mbi formën dhe përmbajtjen e raporteve që duhen paraqitur nga shtetet palë[2]. Raporti përmban informacion mbi zbatimin e neneve të Konventës dhe të rekomandimeve të

[1] Këtej e tutje CEDAW.

[2] CEDAW C/74/3, 18 dhjetor 2019, notë informative mbi përgatitjen e raporteve (neni 18) të Konventës CEDAW; rezoluta 68/268, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, 9 prill 2014, "Funksionimi i mekanizmave të konventave".

Komitetit të Konventës CEDAW, bazuar dhe në vëzhgimet përfundimtare (korrik 2016)[3] dhe përkon me periudhën kohore korrik 2016 – shtator 2020. Përshkrimi i situatës shoqërohet me një analizë të shkurtër të efekteve të masave të ndërmarra në zbatim të Konventës, garantimin e të drejtave të të gjitha grave në Shqipëri, si dhe vështirësive të ndeshura për adresimin në mënyrën e duhur.

Gjatë periudhës së raportimit, Shqipëria kaloi dy procese zgjedhore të rëndësishme: zgjedhjet parlamentare (2017) që konfirmuan në qeverisje koalicionin e majtë dhe zgjedhjet në nivel vendor (2019), që gjithashtu, për shkak të zhvillimeve politike, mundësuan zgjedhjen e kryebashkiakëve/kryebashkiakeve të koalicionit të majtë. Qeveria e re e vitit 2017 riorganizoi institucionet kryesore qendrore, si dhe një pjesë të atyre që kanë përgjegjësi specifike për zbatimin e kësaj Konvente.

Situata e emergjencës civile në nëntor të vitit 2019, për shkak të tërmetit dhe dëmtimeve të konsiderueshme të shkaktuara në disa zona të vendit, si dhe kriza për shkak të pandemisë COVID-19 kanë ndikuar në adresimin e plotë e të duhur të vëzhgimeve përfundimtare. Megjithatë, çështjet e fuqizimit të gruas dhe luftës kundër dhunës me bazë gjinore mbetën prioritete edhe gjatë kufizimeve e mbylljes për shkak të COVID-19. Ndër masat e marra që në fillim, Qeveria e Shqipërisë tregoi kujdes dhe veçoi adresimin e nevojave të grave e vajzave nga grupe të cenueshme.

Raporti u hartua si rezultat i koordinimit dhe përfshirjes së institucioneve qendrore dhe të pavarura, anëtare të Grupit Ndërministror të Punës, kryesuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me mbështetjen dhe kontributin e veçantë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Anëtarë të tjerë të GNP-së ishin: Ministria e Brendshme/Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Gjithashtu kontribut në këtë Raport kanë dhënë edhe institucionet e pavarura, si Kuvendi i Shqipërisë, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, etj.

Pavarësisht kufizimeve të vazhdueshme për shkak të pandemisë së COVID-19 u sigurua zhvillimi i një procesi gjithëpërfshirës ndërinstitucional, duke siguruar përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile apo organizatave ndërkombëtare, nëpërmjet konsultimeve *online*.

Versioni përfundimtar i raportit, u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave nr..., datë .... 2020.

II. MASAT PËR ZBATIMIN E 16 NENEVE KRYESORE TË KONVENTËS, REKOMANDIMEVE TË KOMITETIT DHE VËZHGIMEVE PËRFUNDIMTARE

Neni 1

1. Siç është raportuar edhe më parë, përkufizimi i diskriminimit ndaj grave në ligjin 9970/2008 për barazinë gjinore (neni 4/3), është tërësisht në përputhje me nenin 1 të CEDAW.

2. Kuvendi i RSH-së, ka ndërmarrë një sërë masash për plotësimin e rekomandimeve të Komitetit CEDAW dhe intensifikimin e përpjekjeve për promovimin e barazisë gjinore:

- Zhvillimin e seancave publike të Komisioneve të Përhershme të Kuvendit dhe raportimet vjetore të Prokurorit të Përgjithshëm, Avokatit të Popullit (AP), Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, etj., ku është kërkuar/dhënë informacion mbi rekomandimet e CEDAW;

- Zhvillimin e seancave dëgjimore me gra/vajza rome dhe egjiptiane, një pjesë e të cilave viktima të dhunës në familje, si dhe me të rinj/të reja mbi diskriminimin gjinor, bulizmin, dhunën në shkollë e dhunën me bazë gjinore;

[3] (CEDAW/C/ALB/CO/4).

- Ngritjen e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas (vendimi 113/2017), Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut (vendimi 13/2018), Nënkomisionit për Zhvillim të Qëndrueshëm (vendimi 11/2020), etj.;

- Zhvillimin e seancave dëgjimore nga Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe ndërmarrjen e veprimeve me fokus rritjen e efikasitetit të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit në mbarë vendin;

- Miratimin e programit të veprimit[4] "Për një Kuvend me ndjeshmëri gjinore", fokusuar te legjislacioni i ndjeshëm ligjor, përfaqësimi gjinor, organet e barazisë gjinore, planifikimet strategjike me ndjeshmëri gjinore, etj.;

- Ushtrimin e kontrollit parlamentar mbi zbatimin nga institucionet qendrore, vendore apo të pavarura, të parimit të barazisë (parashikuar në ligjin për barazinë gjinore). Gjetjet do të orientojnë propozimet mbi përmirësimet e nevojshme të ligjit dhe vijimin e kontrollit parlamentar;

- Rritjen e përfaqësimit të grave në parlament dhe organet e tij (41 gra deputete në këtë legjislaturë); në organizatat ndërkombëtare dhe delegacionet e përhershme (30% gra, kryetarja e Delegacionit të përhershëm parlamentar në Asamblenë Parlamentare të Atlantikut Verior – NATO - është grua); në organet kushtetuese dhe të krijuara me ligj, si dhe në shërbimin gjyqësor [për periudhën 2016 – 2018, Kuvendi ka emëruar drejtuese gra në institucione si: AP (vendimi 70/2017), Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, pranë AP (vendimi 41/2018), Komisioneri i Mekanizmit për Parandalimin e Torturës, pranë AP (vendimi 43/2018), Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit (ligji 45/2015)];

- Ruajtjen e kuotave gjinore në përbërjen e bordeve, komisioneve (nga 41 emërime, 23 gra) apo strukturat e reja në kuadër të reformës në drejtësi, etj.

Neni 2

3. Gjatë periudhës së raportimit, parimet e barazisë dhe ndalimit të çdo forme diskriminimi ndaj grave të parashikuara që në Kushtetutën e RSH-së, siç kërkohet dhe në nenin 2 të CEDAW, përfshihen ndër të tjera në:

- Ligjin 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH" ku parimi i mosdiskriminimit për një tërësi shkaqesh, duke filluar nga gjinia, renditet në parimet bazë për ofrimin e shërbimeve. Ligji gjithashtu parashikon ofrimin e shërbimeve të specializuara për gratë dhe vajzat e dhunuara apo të trafikuara, për gratë dhe vajzat shtatzëna ose prind i vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç, etj.;

- Ligjin 65/2016, "Për ndërmarrjet sociale në RSH" që ndër të tjera synon punësimin e personave të pafavorizuar në tregun e punës, si: personat që trajtohen me ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, jetimet/jetimët, gratë viktima të dhunës dhe trafikimit etj.;

- Ligjin 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në RSH" që përmirëson qasjen e viktimave në informacion përmes vendosjes së një koordinatori/koordinatoreje për marrëdhëniet me publikun në secilën prokurori, përgjegjës/përgjegjëse për informimin e viktimave;

- Ligjin 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", që prezantoi konceptin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor edhe në nivel të vetëqeverisjes vendore;

- Ligjin 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", ku barazia dhe mosdiskriminimi përmenden që në parimet e përgjithshme të tij. Ligji përcakton se çfarë do të thotë mbrojtje e fëmijës, duke qartësuar "masat e mbrojtjes" që mund të aplikojnë punonjësit/punonjëset kur konstatojnë raste të fëmijëve në situatë të pasigurt për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo

[4] Programi i veprimit "Për një Kuvend me ndjeshmëri gjinore" u përgatit me mbështetjen e OSBE-së "Për mbështetjen e Kuvendit dhe edukimin qytetar" dhe ekspertëve të zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtave të Njeriut (ODIHR) në Pogradec (tetor 2019) gjatë një takimi dypalësh me përfaqësues të Parlamentit të Maqedonisë së Veriut.
shih: https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/Programi%20me%20Ndjeshmeri%20Gjinore.docx.

shfrytëzimit. Për herë të parë parashikohet mbrojtja e fëmijëve në situatë rruge apo që punojnë/shfrytëzohen për punë, adresimi i formave të ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve, si bulizmi, dhuna në shkolla, në familje, abuzimi seksual, shfrytëzimi ekonomik, siguria e fëmijëve në internet, fëmijët e pashoqëruar ose viktima të trafikimit, etj.;

- Ligjin 37/2017, "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur" që garanton një kornizë ligjore për drejtësinë penale për fëmijët, promovon riintegrimin e fëmijës në konflikt me ligjin, mbrojtjen e të drejtave të fëmijës viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale dhe parandalon riviktimizimin/viktimizimin dytësor të fëmijës që ka qenë më parë viktimë e një vepre penale;

- Ligjin 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", që ndër të tjera garanton ndihmë juridike falas për kategori të veçanta: viktima të dhunës në familje, abuzimit seksual, trafikimit të qenieve njerëzore, të mitur/mitura në konflikt me ligjin, fëmijë në institucionet e përkujdesjes shoqërore, persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, etj.;

- Ligjin 35/2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, 'Kodi i Procedurës Penale'", të ndryshuar, ku parashikohen dispozita të reja ligjore, që përmirësojnë ndjeshëm pozitën e viktimës në çështjet penale, si dhe të drejta procedurale të posaçme për viktimën e mitur, të abuzuar seksualisht dhe të trafikimit të qenieve njerëzore;

- Ligjin 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në RSH", ku garantimi i mosdiskriminimit dhe i barazisë së plotë përpara ligjit jepen që në qëllimin e tij;

- Ligjin 70/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, 'Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pronës'", ku parashikohet se dispozitat e tij zbatohen për pasuritë e personave që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, mbi të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm, për kryerjen e veprave penale lidhur me trafikimin e të rriturve/rriturave dhe të miturve/miturave. Ky ligj përcakton krijimin e një fondi të posaçëm për parandalimin e krimit të organizuar, për të cilin përdoren si burim pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara (me vendimin e Gjykatës). Fondi i veçantë është caktuar për qëllime sociale, duke përfshirë rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të trafikimit;

- Ligjin 32/2017, "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë", ku parashikohet që masat e posaçme të mbrojtjes zbatohen ndaj personave që bashkëpunojnë me organet e drejtësisë;

- Ligjin 47/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, 'Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare'", i cili përmbushi rekomandimet e dhëna nga Komiteti CEDAW (2016) dhe nga GREVIO (2017). Janë forcuar masat mbrojtëse dhe procedurale për një përgjigje më efektive ndaj dhunës në familje dhe mbrojtjen e viktimave, përmes lëshimit të urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme, i paraprirë nga vlerësimi i riskut, për çdo rast që trajtohet. Për herë të parë, mbrohen gratë dhe vajzat në marrëdhënie intime, pa pasur lidhje formale me dhunuesit, si martesa ose bashkëjetesa. Ligji u ndryshua edhe në tetor 2020, duke saktësuar masat për largimin e dhunuesit nga banesa dhe kthimin me mbarimin e afatit të UMM/UM, programet specifike të rehabilitimit për dhunuesin, regjistrin e UMM/UM-ve, etj.;

- Ligjin 22/2018 "Për strehimin social", ku theksohet parimi i mosdiskriminimit, për planifikimin, pajisjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e strehimit për grupet sociale në nevojë për strehim. Nga programi i banesave të specializuara përfitojnë shtresat vulnerabël përfshirë viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe vajzat nëna;

- Ligjin 110/2018 "Për noterinë", që fuqizon pavarësinë ekonomike të gruas dhe është garant kryesor i të drejtave pronësore të saj, duke sjellë risi në çështjet e rregullimit të barazisë gjinore në aspektin e mbrojtjes së pasurive;

- Ligjin 111/2018 "Për kadastrën", që gjithashtu rregullon çështjet e barazisë gjinore, lidhur me regjistrimin e pasurisë së bashkësisë ligjore;

- Ligjin 69/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009, 'Për gjendjen civile'", ku parashikohet procedura e regjistrimit për rastet e paregjistruara, kur akti i lindjes lëshuar nga shteti tjetër ku ka ndodhur lindja, ka të dhëna të paplota/të pasakta;

- Ligjin 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", ku viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje apo nënat nën moshën 18 vjeç, specifikohen te grupet e veçanta të punëkërkues(e)ve të disavantazhuar(a) në tregun e punës, kanë prioritet për t'u përfshirë, duke përfituar nga programet aktive të punësimit, si programet e nxitjes së punësimit, programet e formimit profesional, shërbimet e ndërmjetësimit për punësim etj.". Ligji për arsimin dhe formimin profesional në RSH, i cili një nga parimet themelore ka dhe parimin e gjithëpërfshirjes. Sistemi i Arsimit dhe Formimit Profesional ofron mundësi arsimimi dhe formimi profesional për të gjithë, pa asnjë diskriminim";

- Ligjin 57/2019 "Për asistencën sociale në RSH" ku përcaktohen si përfitues/përfituese të ndihmës ekonomike ndër të tjera viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre, si dhe viktimat e dhunës në familje, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore;

- Ligjin 34/2019 "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara", ku theksohet miradministrimi dhe përdorimi eficient, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e konfiskuara nga organet e drejtësisë dhe pasurive të sekuestruara me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimi financiar i viktimave të krimit;

- Ligjin nr. 35/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, 'Kodi penal i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar", që konsiston në kriminalizimin e dhunës psikologjike, mbrojtjen e personave në lidhje ose ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, etj., pra që harmonizon përmbajtjen e këtij neni me nenin 3 të Konventës së Stambollit dhe ndryshimet në ligjin për dhunën në familje. Gjithashtu ligji parashikon ashpërsimin e dënimeve për disa figura të kësaj vepre penale;

- Ligjin 13/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, 'Për të Huajt'", ku parashikohet mbrojtje më e mirë për viktimat e huaja të trafikimit;

- Ligjin 59/2020 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet RSH dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për politikën për zhvillim për aksesin e barabartë gjinor në mundësitë ekonomike", që ka për objektiv mbështetjen e qeverisë shqiptare për të përmirësuar kuadrin e politikave për akses të barabartë gjinor në mundësitë ekonomike, duke u përqendruar te: rritja e aksesit të grave në pasuri; vendosja e rregullave të barabarta për rritjen e mundësive për gratë në tregun e punës; forcimi i rregullave institucionale për një politikëbërje të informuar gjinore;

- Ligjin nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" që garanton kushtet për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues;

- Ligjin nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, 'Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar", që garanton respektimin e parimit të barazisë gjinore. Sipas ligjit pjesëmarrja e drejtpërdrejtë dhe aktive në jetën politike dhe publike e gjinisë së nënpërfaqësuar përbën instrument themelor në konsolidimin e sistemit demokratik;

- Ligjin nr. 115/2020, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, 'Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar" ku parashikohet sistemi zgjedhor për Kuvendin dhe përcaktohet që ligji për zgjedhjet siguron përfaqësim gjinor;

- Ligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, 'Për mbrojtjen nga diskriminimi'"[5], ku parashikohet ndër të tjera shtimi i diskriminimit të shumëfishtë, diskriminimi ndërsektorial, gjuhës së urrejtjes, segregimit, ngacmimi seksual, etj., si dhe e drejta e KMD-së për

[5] Paraqitur në shkurt 2020 dhe miratuar në tetor 2020.

vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar papajtueshmërinë e një ligji me Kushtetutën, etj.

4. Të rëndësishme për t'u theksuar janë dhe tërësia e akteve nënligjore të miratuara për zbatimin e ligjeve të mësipërme, si dhe strategjitë apo planet e veprimit të miratuara, rishikuara e zbatuara gjatë periudhës së raportimit, në fushën e barazisë gjinore, ndihmës juridike falas, shëndetësisë, arsimit, pronësisë, mbrojtjes sociale, mbrojtjes nga diskriminimi, kundër dhunës në familje, kundër trafikimit, mbrojtjes së grupeve të veçanta, etj. (shtojca 1).

Njohuri mbi Konventën, protokollin shtesë, rekomandimet e përgjithshme

5. Ofrimi i njohurive mbi instrumentet ndërkombëtarë si CEDAW, promovimi i barazisë gjinore dhe veprimeve kundër diskriminimit gjinor mbeten tematika të rëndësishme të aktiviteteve për ngritjen/fuqizimin e kapaciteteve të gjyqësorit dhe profesionisteve/profesionistëve të tjerë, të organizuara nga Ministria e Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Policia e Shtetit, në bashkëpunim me institucionet/agjencitë ndërkombëtare. Gjatë periudhës së raportimit nuk kanë munguar aktivitetet trajnuese me gjyqtare/gjyqtarë, prokurore/prokurorë, oficere/oficerë të policisë gjyqësore, punonjëse/punonjës të policisë, etj.

6. Në Shkollën e Magjistraturës, njohuritë mbi CEDAW, protokollin shtesë dhe përdorimin në praktikë të tyre apo instrumenteve të tjerë ndërkombëtarë, janë pjesë e rëndësishme e kurrikulës arsimore të formimit fillestar të magjistrateve/magjistratëve. Kanë marrë njohuritë e nevojshme në këtë drejtim 93 magjistrate/magjistratë dhe 12 ndihmëse/ndihmësa, për vitet akademike: 2016: 25 magjistrate/magjistratë, 2017: 15 magjistrate/magjistratë, 2018: 7 magjistrate/magjistratë dhe 2019: 46 magjistrate/magjistratë dhe 12 ndihmëse/ndihmësa.

7. Zbatimi i drejtpërdrejtë i CEDAW, roli i gjykatës dhe sistemit të drejtësisë, standardet evropiane mbi barazinë dhe mosdiskriminimin, platforma HELP dhe ndalimi i diskriminimit të shumëfishtë, teoritë gjinore dhe paragjykimet në sallën e gjyqit, etj., kanë qenë disa nga tematikat kryesore të formimit vazhdues për 157 gjyqtare/gjyqtarë, prokurore/prokurorë, oficere/oficerë të policisë gjyqësore dhe inspektore/inspektorë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të trajnuar për periudhën 2016 – 2020, konkretisht: 44 pjesëmarrëse/pjesëmarrës në vitin 2016, 21 pjesëmarrëse/pjesëmarrës në vitin 2017, 64 pjesëmarrëse/pjesëmarrës në vitin 2019 dhe 18 pjesëmarrëse/pjesëmarrës në vitin 2020[6].

8. Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve dhe ekspertë të huaj kanë trajnuar gjatë vitit 2016 mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për çështjet që lidhen me barazinë gjinore 32 ndërmjetëse/ndërmjetës.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka zhvilluar[7] trajnime mbi njohjen dhe zbatimin e CEDAW dhe instrumenteve të tjerë ndërkombëtarë apo kuadrit ligjor në fuqi për barazinë gjinore dhe dhunën në familje, me 3,499 punonjëse/punonjës policie, për periudhën 2016 – 2020[8].

10. Çështjet gjinore dhe të riintegrimit të grave të dënuara janë pjesë e moduleve të trajnimit të stafit të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Për vitin 2019 janë trajnuar 40 punonjëse/punonjës të disiplinave të ndryshme të cilat/cilët punojnë me kategorinë e grave të dënuara/të paraburgosura.

11. Prokuroria e Përgjithshme raporton se ka marrë pjesë edhe në trajnime e vizita studimore të zhvilluara jashtë vendit, duke u përfaqësuar me prokurore/prokurorë, OPGJ dhe ndihmëse/ndihmës ligjorë[9].

Vendi i Konventës në sistemin ligjor dhe harmonizimi i legjislacionit

---

[6] Tabela e detajuar me tematikat dhe numrin e pjesëmarrësve gjendet bashkëlidhur raportit, si shtojca 2 e tij.

[7] Në bashkëpunim me ICITAP, Këshillin e Evropës, OSBE, PAMECA V, UN WOMEN, UNDP, etj.

[8] Tabela e detajuar me tematikat dhe numrin e pjesëmarrësve gjendet bashkëlidhur raportit, si shtojca 2 e tij.

[9] Informacioni me tematikat gjendet bashkëlidhur raportit, si shtojca 2 e tij.

12. CEDAW është e zbatueshme drejtpërdrejt në legjislacionin shqiptar. Megjithatë, KMD evidenton se numri i ankesave me pretendim diskriminimin gjinor, vazhdon të mbetet relativisht i ulët dhe në pjesën më të madhe të tyre janë gratë viktima të këtij diskriminimi, që në shumë raste shfaqet dhe si diskriminim i shumëfishtë. Mbetet problematik diskriminimi në punësim për shkak të shtatzënisë, lindjes, gjendjes shëndetësore, si nga institucionet publike dhe nga subjektet private.

13. Për të ushtruar sa më mirë funksionet e tij KMD hapi në vitin 2017 tri zyra rajonale në Shkodër, Gjirokastër dhe Korçë. Për periudhën 2016 – 2020, KMD ka trajtuar 33 çështje, nga të cilat 12 çështje diskriminimi vetëm për shkak të gjinisë: 3 çështje në vitin 2016 (nga 6 çështje gjithsej), 1 në vitin 2017, (nga 2 çështje gjithsej), 4 në vitin 2018 (nga 16 çështje gjithsej), 3 në vitin 2019 (nga 7 çështje gjithsej) dhe 1 për janar – prill 2020 (nga 2 çështje gjithsej)

14. KMD ka rekomanduar përmirësimin dhe harmonizimin e legjislacionit për: a) ligjin për gjendjen civile në lidhje me konceptin e "Kryefamiljarit" dhe detyrave të parashikuara nga ligji, për të garantuar marrjen e pëlqimit të të dy bashkëshortëve në procedurat e deklarimit të vendbanimit (2016); b) ligjin kundër dhunës në familje për harmonizimin me nenin 3 të Konventës së Stambollit dhe identifikimin drejtpërdrejt në ligj të mbrojtjes nga diskriminimi (2018); c)Kodin e Punës mbi: shmangien e diskriminimit të punonjëseve në rastet e llogaritjes së shpërblimit vjetor për punonjëset me leje lindje në mënyrë të ndryshme nga dhënia e masës së shpërblimit si gjithë punonjësit e tjerë që kanë punuar gjatë gjithë vitit; mos konsiderimin si diskriminim të rasteve kur llogaritja e shpërblimit vjetor për punonjëset/punonjësit me leje prindërore, bëhet në përpjesëtim me kohën e punuar, duke u zbritur periudha kur nuk është punuar për shkak të lejes; dhënien e shpërblimeve si inkurajim, apo shpërblimeve të një natyre që nuk kushtëzohen me punën e kryer në të shkuarën, për të gjithë punonjëset/punonjësit pavarësisht nëse kanë qenë me leje lindje apo leje prindërore.

15. Avokati i Popullit (AP) bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian kundër racizmit dhe intolerancës, rekomandoi zgjerimin e kategorisë së subjekteve përfituese të ligjit të ri për ndihmën juridike me viktimat e diskriminimit. Alokimi i mjaftueshëm i fondeve shtetërore, rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit, rritja e aksesueshmërisë pranë klinikave ligjore, janë disa nga masat kryesore që nevojiten për garantimin e ndihmës juridike falas për grupet në nevojë.

16. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) si autoriteti shtetëror përgjegjës për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje, zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e ligjeve, strategjive, planeve të veprimit dhe të gjitha detyrimeve kombëtare e ndërkombëtare të Shqipërisë në këto fusha. MSHMS-ja monitoron në mënyrë të përvitshme zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e saj të Veprimit 2016 – 2020; evidenton arritjet dhe sfidat e ndeshura nga institucionet përgjegjëse qendrore e vendore; raporton rezultatet e monitorimit në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore; dhe përgatit, argumenton e mbron të gjitha propozimet mbi përmirësimin e kuadrit ligjor dhe të politikave në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe direktivat e BE-së.

17. Ndryshimet e vitit 2018 të ligjit për dhunën në familje që mbështetin zbatimin e tij te CEDAW dhe Konventa e Stambollit, u propozuan nga MSHMS-ja, bazuar në Vëzhgimet Përmbyllëse të Komitetit të CEDAW (2016) dhe raportit të parë të Grupit të Ekspertëve për Veprimin kundër Dhunës ndaj Grave (GREVIO, 2017).

18. Grupet e cenueshme si viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje, nënat e reja, personat me aftësi të kufizuara, minoritetet, personat LGBTI, të moshuarat/moshuarit, etj., janë përfshirë/targetuar në ligjet e reja apo të përmirësuara mbi: shërbimet e kujdesit shoqëror, punësimin dhe programet e tij, sigurimet shoqërore, sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, strehimin social, pronësinë, ndihmën juridike, përshtatjen dhe aksesueshmërinë, mbrojtjen e fëmijëve, Kodin e Drejtësisë Penale për të mitur, Kodin e Procedurave Penale, etj.

Aksesi në drejtësi dhe ndihma ligjore

19. Ndërgjegjësimi i publikut dhe sidomos i grupeve të caktuara të grave, përmes organizimit të fushatave ndërgjegjësuese dhe aktiviteteve informuese dhe edukuese, fokusuar edhe tek aksesi në drejtësi (shiko nenin 5), është një ndër strategjitë efektive që përdoret prej vitesh në Shqipëri.

20. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e ligjit për ndihmën juridike, janë ministri i Drejtësisë, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe gjykatat kompetente.

21. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas (DNJF) pranë Ministrisë së Drejtësisë, ka zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuese mbi të drejtën e përfitimit të ndihmës juridike, me të miturat/miturit në Institutin e të Miturve Kavajë dhe pranë Institutit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Tiranë. Aktivitete ndërgjegjësuese po zbatohen edhe në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP) 2019 – 2023 ku DNJF-ja është anëtare e Rrjetit Kombëtar për Edukimin Ligjor të Publikut. DNJF ka publikuar dhe shpërndarë te Bashkia Tiranë, Avokati i Popullit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Kryeministria, manualin e thjeshtëzuar mbi kriteret dhe procedurën e përfitimit nga shërbimet e ndihmës juridike falas; ka shpërndarë në shtator 2020 rreth 500 postera (të përgatitur me EURALIUS V), tek institucionet kryesore në vend; si dhe përditëson rregullisht faqen zyrtare ndihmajuridike.gov.al

Forcimi i kapaciteteve të Komitetit Shtetëror për Ndihmën Juridike

22. Sipas dispozitave kalimtare të ligjit për ndihmën juridike Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike pushon së ekzistuari me ngritjen e DNJF.

23. Ligji parashikon se ndihma juridike parësore duhet të jepet nga punonjësët/punonjësit me trajnim të posaçëm, pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara dhe nga klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë. Në 24.9.2020, DNJF-ja zhvilloi modulin e parë të trajnimit të detyrueshëm të punonjëseve/punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, ku u theksua ndihma juridike që përfitojnë kategoritë e veçanta si viktimat e dhunës, abuzimit seksual, trafikimit, të miturit/miturat në konflikt me ligjin, etj. Moduli i trajnimit u miratua paraprakisht nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

24. Ndihma juridike dytësore, duhet të ofrohet nga avokatet/avokatët, sipas listës së miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Shkolla e Avokatisë është autoriteti përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e programeve të trajnimit fillestar dhe të trajnimit vazhdues avokat/avokatët. Ajo është organizuar dhe funksionon si strukturë e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë dhe ka pavarësi akademike. DNJF-ja ka hartuar draft programin e trajnimit vazhdues të ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, duke u fokusuar në kategoritë e veçanta përfituese/grupet vulnerabël dhe po dakordëson me Dhomën e Avokatisë Shqiptare, për të zhvilluar trajnimin vazhdues *online* brenda muajit tetor 2020 për 73 avokate/avokatë/ofrues të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore.

25. Ekzistojnë pesë Qendra të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore (QSHNJP)[10] dhe pritet të hapen edhe tre[11] të tjera deri në fund të vitit 2020. Për vitin 2019 – 2020, QSHNJP Elbasan ka trajtuar 47 raste, 3 nga të cilat raste dhune. Ndërsa për periudhën janar – shtator 2020, QSHNJP Tiranë, ka trajtuar 422 raste; Durrës 211 raste, Fier 126 raste, Lezhë 215 raste.

26. Janë 12 organizata jofitimprurëse të autorizuara nga ministri i Drejtësisë të japin ndihmë juridike parësore, me një shtrirje gjeografike në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër dhe Berat, të cilat kanë trajtuar gjithsej 283 raste[12].

---

[10] Në qytetin e Tiranës, Elbasanit, Fierit, Lezhës dhe Durrësit.

[11] Lushnjë, Pogradec, Gjirokastër.

[12] Për periudhën 10 – 30 shtator 2020, "Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza" ka trajtuar 27 raste, "Mbrojtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat" ka trajtuar 20 raste, "Qendra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara" nuk ka trajtuar ndonjë rast, "Intelektualët e rinj shpresë" ka trajtuar 5 raste, "Qendra për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri (CRCA)" ka trajtuar 6 raste, "Forumi i Gruas Elbasan" ka trajtuar 21 raste, "Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)" ka trajtuar 117 raste, "Të ndryshëm dhe të barabartë" ka trajtuar 17 raste, "*Albanian Legal and Territorial Institute* (ALTRI) ka trajtuar 5 raste, "Qendra për nisma ligjore qytetare" ka trajtuar 40 raste,

27. Ofrues të ndihmës juridike parësore, janë edhe Klinikat e Ligjit që funksionojnë pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë (janë lidhur marrëveshje me 9 prej tyre[13]). Pranë Klinikës së Ligjit në Ministrinë e Drejtësisë për periudhën kohore 1.2.2019 – 31.1.2020 janë trajtuar 1250 raste (21 raste dhune).

28. Për vitin 2019, avokatet/avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, kanë ofruar ndihmë juridike dytësore për 21 raste (2 raste dhune) dhe janar – shtator 2020 kanë përfituar ndihmë juridike dytësore 51 gra dhe 38 burra, ka 15 rrëzime të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe 1 vendim pushim çështjeje.

29..Në kuadër të shërbimit ligjor falas është përfshirë për herë të parë edhe ofrimi i shërbimit të ndërmjetësit ndaj grupeve në nevojë. Për të rritur numrin e rasteve për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve ka hartuar Strategjinë e Komunikimit dhe po zhvillon fushatë ndërgjegjësimi.

30. Avokati i Popullit (AP) deklaron se një pjesë e kërkesave për ndihmë juridike fillimisht drejtohet te ky institucion. Gjatë periudhës 2016 – 2017, AP adresoi pranë Komitetit Shtetëror të Ndihmës Juridike 43 kërkesa të individëve për përfitimin e ndihmës juridike falas (20 kërkesa nga gratë). Gjatë 2018 – 2019 u depozituan 68 kërkesa (18 nga gratë). Kërkesat e grave kanë objekt kryesisht çështje familjare (zgjidhje martese, kujdestari, detyrime pensioni ushqimor) dhe civile (shkaktim dëmi, pjesëtim pasurie, njohje vjetërsie në punë). Më të pakta në numër janë çështjet penale.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore mbi të drejtat e grave

31. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore ndiqet nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror dhe Privat. Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, ka ndjekur veprimet procedurale për ekzekutim brenda afatit ligjor të arsyeshëm të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me objekt "pensione ushqimore", "takim me fëmijë", "kujdestari fëmije", "urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes" dhe "urdhra të mbrojtjes". Çështjet përmbarimore me vendime gjyqësore mbi fëmijët, prekin veçanërisht gratë, pasi në përqindjen më të madhe të rasteve, fëmijët i lihen nënës për rritje dhe edukim dhe babai ka detyrim të paguajë pensionin ushqimor.

32. Të dhënat mbi çështjet e "detyrimit ushqimor" ndër vite[14]:

- për vitin 2016 janë 6100 çështje, nga të cilat në 1593 çështje nuk shlyhet detyrimi për pamundësi paguese nga ana e debitorit dhe janë aplikuar 70 kallëzime penale për mosdhënie të mjeteve për jetesë;
- për vitin 2017 janë 6132 çështje, nga të cilat në 1758 çështje nuk shlyhet detyrimi për pamundësi paguese nga ana e debitorit dhe janë aplikuar 80 kallëzime penale për mosdhënie të mjeteve për jetesë;
- për vitin 2018 janë 6547 çështje, nga të cilat në 2488 çështje nuk shlyhet detyrimi për pamundësi paguese nga ana e debitorit dhe janë aplikuar 65 kallëzime penale për mosdhënie të mjeteve për jetesë;
- për vitin 2019 janë 7221 çështje, nga të cilat në 2754 çështje nuk shlyhet detyrimi për pamundësi paguese nga ana e debitorit dhe janë aplikuar 55 kallëzime penale për mosdhënie të mjeteve për jetesë;
- për periudhën 1.1.2020 – 30.9.2020 janë 7205 çështje, nga të cilat në 2932 çështje nuk shlyhet detyrimi për pamundësi paguese nga ana e debitorit dhe janë aplikuar 43 kallëzime penale për mosdhënie të mjeteve për jetesë.

"Qendra Konsumatori Shqiptar" ka trajtuar 25 raste, "Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët" nuk ka pasur ndonjë rast.

[13] Janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës; Universitetin "Beder"; Kolegjin Universitar "Luarasi"; Kolegjin Universitar "Wisdom"; "*Albanian University*"; Universitetin "Aleksandër Mojsiu" Durrës; Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë; "Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë" dhe "Universitetin Evropian të Tiranës". Pritet që Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me Klinikën e ligjit pranë Kolegjit Universitar "Qiriazi", si dhe Klinikën e Ligjit pranë Universitetit "Mesdhetar të Tiranës".

[14] Për më shumë detaje referohuni në tabelën përkatëse shtojca 3.

33. Ndjekja e vazhdueshme e veprimeve procedurale nga përmbarueset/përmbaruesit gjyqësorë për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, si dhe aplikimi i sanksioneve ligjore, konfirmon përgjegjshmërinë e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror për ekzekutimin e titujve ekzekutivë, pavarësisht ngarkesës së lartë të çështjeve për përmbaruese/përmbarues.

34. Praktika përmbarimore evidenton vendime gjyqësore të cilat jo gjithmonë i përgjigjen interesit më të lartë të të miturës/miturit dhe mbartin problematikë që e bën të pamundur ekzekutimin e tyre. Kjo sidomos në rastet e vendimeve të kujdestarisë së fëmijës, ku jo në pak raste vlerësohen më tepër interesat e prindërve, ose në rastet e detyrimit ushqimor, ku shpesh fëmijët nuk marrin shumën e nevojshme për arsimim dhe mirërritje. Roli i psikologes/psikologut në proceduarat e ekzekutimit është i domosdoshëm, por nuk janë të pakta rastet kur kreditori refuzon të parapaguajë shpenzimet për psikologen/psikologun, duke mos realizuar ekzekutimet me objekt "takim me fëmijën".

35. Problem në ekzekutimin e vendimeve paraqet dhe vështirësia në verifikimin e vërtetimit të të ardhurave të prindit debitor i cili/e cila duhet të paguajë detyrimin për ushqim. Kjo pasi një numër i konsiderueshëm personash nuk regjistrojnë aktivitetin e tyre sipas kërkesave të ligjit, ose nuk kanë lidhur kontratë për punën që kryejnë dhe nuk u rezulton asnjë e ardhur apo pasuri e luajtshme/e paluajtshme në emër të tyre. Kjo çon në pamundësinë për shlyerje të detyrimit për shumë prej këtyre çështjeve dhe moszbatimin e vendimit gjyqësor.

36. Problem është dhe emigrimi i shumë debitorëve, të cilët/cilat kanë zgjidhur martesën, nuk paguajnë detyrimin ushqimor dhe nuk u rezulton pasuri e sekuestrueshme. Për rrjedhojë këta tituj ekzekutivë mbeten të pazbatuar sepse prindi debitor nuk merr pagesë papunësie, pasi është larguar dhe nuk plotëson kushtet e ligjit për ta përfituar atë. Kjo ndikon në mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, pra në mosrealizimin e të drejtës ligjore të palës së interesuar. Këto janë pengesa të natyrës legjislative dhe praktike. Organizimi i trajnimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit me temë «pensionet ushqimore» dhe «takim me fëmijën» (2019), vërteton përgjegjshmërinë e strukturave përkatëse për ekzekutimin e këtyre titujve ekzekutivë, duke vlerësuar gjithmonë interesin më të lartë të fëmijës.

Barra e provës

37. Kodi i Punës i ndryshuar (2015) detyron punëdhënësit/punëdhënëset për marrjen e masave për parandalimin e ngacmimit seksual dhe shqetësimeve me natyrë seksuale, si dhe penalizimit të viktimës për shkak të raportimit për incidentet e dhunës në vendin e punës. Në rastin e diskriminimit për arsye të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, punëdhënësi/punëdhënësja detyrohet të provojë se nuk ka bërë shkelje të parimit të trajtimit të barabartë, dhe në rastin e ngacmimit seksual, ligji e kalon barrën e provës te punëdhënësi/punëdhënësja ose personi që pretendohet të ketë bërë ngacmimin.

38. Kodi i Procedurave Administrative (2016) parashikon se në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj (neni 82/2)[15].

39. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi i ndryshuar, miratuar në 15 tetor 2020, përcakton se "Në rastet kur pala ankuese paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim" (neni 33, pika 7/1).

Neni 3

40. Qeveria e re (2017) bëri një riorganizim të fushave të përgjegjësisë së ministrive dhe çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje iu ngarkuan Ministrisë së

[15] Për më shumë detaje mbi kuadrin ligjor për barrën e provës referohuni shtojcës 4.

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)[16], ndërkohë që nga shtatori 2013 deri në shtator 2017 kjo përgjegjësi ishte e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (e cila u shkri[17]).

41. MSHMS-ja, përveçse për shëndetësinë, është përgjegjëse dhe për zhvillimin e politikave për adresimin e dhunës me bazë gjinore, abuzimit ndaj fëmijëve, grave dhe grupeve të tjera, barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mosdiskriminimin për shkak të orientimit seksual, aftësisë së kufizuar, përkatësisë etnike, etj. Këto përgjegjësi përmbushen nëpërmjet Sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore, brenda Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

42. Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore (me anëtarësi të rinovuar sipas urdhrit të Kryeministrit nr. 239, datë 13.12.2017) është organi këshillimor për drejtimin, përcaktimin dhe zhvillimin e politikave shtetërore për barazinë gjinore, si dhe për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga Konventa e Stambollit.

43. Institucionet shtetërore qendrore dhe vendore kanë detyrimin ligjor të bashkëpunojnë me ministren/ministrin që mbulon çështjet e barazisë gjinore për të shkëmbyer informacion dhe lehtësuar përmbushjen e funksionit të saj/tij. Ky bashkëpunim lehtësohet përmes Nëpunëseve/Nëpunësve të Barazisë Gjinore (NBGJ). Në nivel qendror janë caktuar NBGJ në 11 ministri dhe pika kontakti në Policinë e Shtetit dhe INSTAT. Në nivel vendor 58 nga 61 bashki kanë NBGJ, të cilat/cilët në shumicën e rasteve luajnë dhe rolin e koordinatores/koordinatorit vendor kundër dhunës në familje.

44. Urdhri i Kryeministrit 32/2018 cakton zëvendëskryeministren/zëvendëskryeministrin si koordinatore/koordinator kombëtar për barazinë gjinore, me rol koordinues për fuqizimin e mekanizmit kombëtar për barazinë gjinore.

45. Kuvendi, në 4.12.2017, miratoi rezolutën "Për dënimin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe rritjen e efektshmërisë së mekanizmave ligjorë për parandalimin e saj", në zbatim të së cilës u ngrit Nënkomisioni "Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas", pranë Komisionit të përhershëm për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Ky nënkomision në kuadër të kontrollit parlamentar kërkon informacion mbi zbatimin e SKBGJ-së, raportim për situatën e dhunës në familje, apo për çështje të diskriminimit ndaj grave, zhvillon seanca dëgjimore me grupet e interesit dhe institucionet.

46. Aleanca e Grave Deputete (me anëtarësi të rinovuar në vitin 2017) është rezultat i lëvizjes lobuese të grave deputete, me synim nxitjen e barazisë gjinore në Parlament dhe avokimin për përfshirjen e perspektivës gjinore në ligje.

47. Ministri i Drejtësisë, lançoi Zyrën e Koordinimit kundër dhunës në familje në 25.11.2017, për bashkërendimin e veprimeve institucionale në nivel qendror e vendor, për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen e viktimave të dhunës në familje, kryesisht grave dhe vajzave, si dhe ofrimin e ndihmës në përshkallëzimin e veprimeve institucionale në këtë drejtim. Zyra ka në përbërje përfaqësuese/përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (Shërbimi Social Shtetëror) dhe Ministria e Brendshme (Drejtoria për Krimet, pranë Sektorit për Dhunën në Familje dhe Mbrojtjen e të Miturve).

Koordinimi dhe bashkëpunimi efektiv

48. MSHMS-ja, në të gjithë fushatat kombëtare të ndërgjegjësimit, koordinohet me ministritë e linjës dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Koordinimi ndërinstitucional është i pasqyruar dhe në tërësinë e aktiviteteve të SKBGJ 2016 – 2020, apo në plane të tjera veprimi për Romët dhe

[16] VKM-ja nr. 508, datë 13.9.2017, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale".

[17] Përgjegjësitë për rininë kanë kaluar te ish Ministria e Arsimit dhe Sporteve – aktualisht Ministria e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë, përgjegjësitë për punësimin kaluan te ish Ministria e Financave – aktualisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë, etj.

Egjiptianët, LGBTI, PAK, etj. Trajtimi i rasteve të dhunës në familje, dhunës ndaj grave e vajzave, abuzimit të fëmijëve, etj., bëhet përmes qasjes shumësektoriale të koordinuar.

49. Koordinimi ndërinstitucional qendror e vendor, si dhe me të gjithë aktorë e partnerët, ka mundësuar mbledhjen dhe reflektimin e zërit dhe shqetësimeve të grave/vajzave nga grupet e cenueshme. Prania e organizatave të shoqërisë civile, sidomos të të drejtave të grave, në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore, apo në konsultimet që zhvillon shteti për hartimin e legjislacionit dhe politikave të reja, ose rishikimin e atyre ekzistuese, është një tjetër mundësi për adresimin e nevojave të grave nga grupet e cenueshme.

50. Policia e Shtetit koordinon veprimet dhe bashkëpunon me AP, KMD, MSHMS, si dhe organizatat/partnerët ndërkombëtarë. 70 punonjëse/punonjës policie kanë marrë trajnime mbi çështjet gjinore gjatë vitit 201618; 15 takime/tryeza janë realizuar gjatë vitit 2018 me KMD, 30 takime gjatë 2019-tës me MSHMS-në dhe 10 takime në vitin 2020 me partnerët ndërkombëtarë, mbi barazinë gjinore dhe kundër diskriminimit.

51.KMD dhe AP kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi (maj 2018) për koordinimin dhe bashkëpunimin efektiv në kuadër të garantimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, veçanërisht për mosdiskriminim dhe barazi në ligj dhe para ligjit, promovimin e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individëve, si dhe monitorimin e zbatimit të LBGJ.

Zbatimi i buxhetimit gjinor dhe SKBGJ & DHF 2011 – 2015

52. Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor (BPGJ) është pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020 dhe është përfshirë në menaxhimin e sistemit buxhetor përmes ndryshimeve të ligjit përkatës (2016). Ligji për financat e vetëqeverisjes vendore (2017) ka krijuar mundësitë për përfshirjen e efektshme të BPGJ në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit financiar vendor (programimi i buxhetit vjetor dhe afatmesëm, monitorimi dhe raportimi, vlerësimi dhe auditimi). Në mënyrë të detyrueshme, NJVV-ve u ngarkohet që të paktën në një nga objektivat e politikave të programeve të adresojnë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit gjinorë. NJVV-të gjatë raportimit duhet të përfshijnë detyrimisht si tregues financiar shpenzimet për politikat që mbështesin barazinë gjinore nga shpenzimet e përgjithshme.

53. Aplikimi i BPGJ[19] ndër vite:

Viti	Nr. i programeve buxhetore	Nr. i programeve buxhetore që përfshijnë BPGJ-në	Nr. i objektivave	Nr. i produkteve	Fondet buxhetore për BPGJ-në (në milion USD)	% e totalit të shpenzimeve buxhetore
2015 – 2017	84	9	11	14	38.4	1%
2016 – 2018	84	20	27	23	63.4	1.73%
2017 – 2019	84	24	32	33	90	2.3%
2018 – 2020	84	28	41	41	120	2.4%
2019 – 2021	74	33	52	52	285	6.3%

54. Vlerësimi i zbatimit të SKBGJ & DHF 2011 – 2015, zhvilluar përmes një procesi pjesëmarrës, i parapriu hartimit të SKBGJ 2016 – 2020 ku u reflektuan gjetjet dhe u adresuan sfidat e evidentuara, si në vijim.

55. Qëllimi strategjik mbi forcimin e mekanizmit kombëtar të barazisë gjinore u zbatua pjesërisht. Evidentohet përmirësimi i ndjeshëm i kuadrit ligjor por edhe vështirësia e mekanizmit kombëtar për organizimin e aktiviteteve, koordinimin me institucionet qendrore, dhe monitorimin e vlerësimin në mënyrën e duhur, të angazhimeve për barazinë gjinore. Alokimi i fondeve të mjaftueshme dhe fuqizimi i rrjetit të NBGJ në nivel vendor dhe qendror, mbeten sfidat kryesore.

[18] Mbështetur nga ICITAP dhe UN WOMEN.

[19] Burimi: "Raporti Kombëtar për zbatimin e platformës për veprim Pekin+25", prill 2019.

56. Qëllimi strategjik 2, mbi pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje u zbatua pothuajse tërësisht. Ndryshimet e Kodin Zgjedhor (2015) rritën kuotat gjinore nga 30% në 50% për gratë kandidate në këshillat bashkiake dhe rritën përqindjen e anëtarëve gra nga 12% (2011) në 34% (2015). U rrit pjesëmarrja e grave në misionet paqeruajtëse dhe strukturën policore. Fuqizimi i grave/të rejave brenda partive politike dhe ndryshimet në Kodin Zgjedhor në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017 u evidentuan si sfida.

57. Qëllimi strategjik 3, mbi fuqizimin ekonomik dhe social të grave dhe burrave u zbatua pjesërisht. Rritja e numrit të grave të mbështetura nëpërmjet programeve të punësimit dhe trajnimit profesional, përmirësimi i kuadrit ligjor mbi kredinë dhe sipërmarrjen e grave, mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe mbështetjes financiare, u evidentuan si kryesore.

58. Qëllimi strategjik 4 mbi dhunën me bazë gjinore dhe në familje u zbatua pjesërisht. Të dhënat treguan rritje të dukshme në raportimin dhe menaxhimin e rasteve, veçanërisht të dhunës në familje. Trajtimi i të gjitha formave të dhunës ndaj grave, harmonizimi i kuadrit ligjor ekzistues dhe zbatimi i tij në praktikë, përmirësimi i aksesit në drejtësi, rritja e cilësisë dhe numrit të shërbimeve të dedikuara për viktimat/të mbijetuarat e dhunës, zgjerimi i masave parandaluese, angazhimi i më shumë burrave/djemve në veprimet kundër dhunës, përmirësimi i aksesit në shërbime veçanërisht për gratë në zonat rurale apo grupet të cilat pësojnë diskriminim të shumëfishtë, ishin disa nga sfidat e evidentuara.

Integrimi i rekomandimeve të Komitetit në SKBGJ 2016 – 2020

59. SKBGJ 2016 – 2020 u përgatit mbi vlerësimin e mësipërm, përmes një procesi konsultues gjithëpërfshirës. Qëllimet strategjike: i. fuqizimi ekonomik i grave dhe burrave; ii. garantimi i pjesëmarrjes dhe angazhimit faktik dhe të barabartë të grave në vendimmarrjen politike e publike; iii. reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje; iv. fuqizimi i rolit koordinues dhe monitorues të Mekanizmit Kombëtar të Barazisë Gjinore, si dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë për avancimin e barazisë gjinore.

60. SKBGJ 2016 – 2020 mbështetet në angazhimet dhe standardet ndërkombëtare e të BE-së për barazi gjinore, strategjitë kryesore kombëtare, detyrimet nga konventat ndërkombëtare, përfshirë: CEDAW, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Platforma për Veprim e Pekinit, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, etj.

Mbështetja për forcimin e rolit të Avokatit të Popullit (AP)

61. Kuvendi ka treguar vëmendje të veçantë për zbatimin e rekomandimeve të institucionit të AP. Me vendimin 49/2017, është krijuar mekanizmi ndërinstitucional Kuvend – institucione të pavarura – qeveri, si dhe Platforma Ndërinstitucionale *Online*, si një sistem transparent vlerësimi efikas mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura nga ekzekutivi dhe agjencitë e varësisë. Kjo platformë ndikon drejtpërsëdrejti në forcimin e rolit dhe mbështetjen e institucionit të AP.

62. AP po fuqizon veprimtarinë e tij për mbrojtjen e të drejtave të qytetareve/qytetarëve, nxitjen e llogaridhënies nga organet qeveritare, monitorimin e zbatimit të Konventave të rëndësishme të ratifikuara (përfshirë CEDAW), hartimin e raporteve të veçanta në fushën e barazisë gjinore (mbi dhunën ndaj grave, ngacmimin moral dhe seksual në administratën publike, situatën e komunitetit LGBTI, monitorimin e buxhetimit gjinor, etj.).

63. AP kufizohet në garantimin e mbrojtjes së të drejtave të grave vetëm për shkelje nga organet publike. AP ndan qëndrimin se miratimi nga Kuvendi në 2018 i Rezolutës për njohjen dhe mbështetjen e veprimtarisë së mbrojtës(e)ve të të drejtave të njeriut në promovimin, nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, është me rëndësi në drejtim të forcimit të bashkëpunimit të të gjithë aktorëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në këtë fushë.

64. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB) i ka krijuar akses AP për inspektim të rregullt të pavarur të trajtimit të grave në sistemin e burgjeve, përmes Mekanizmit për Parandalimin e Torturës. Rekomandimet e dhëna janë bërë pjesë e Planit të Veprimit për Përmbushjen e Rekomandimeve të AP. Akses për monitorim u është krijuar edhe OJF-ve, me të cilat DPB ka marrëveshje bashkëpunimi.

65. MSHMS shqyrton me kujdes të gjitha rekomandimet e AP mbi promovimin e barazisë gjinore dhe luftën kundër diskriminimit gjinor, siç reflektohen në: a) plotësimin e kuadrit nënligjor për shtrirjen e skemës së ndihmës ekonomike në të gjithë vendin dhe përdorimin e formulës së pikëzuar, për targetimin më të mirë të familjeve të varfëra; b) hartimin e udhëzimeve për kriteret e reja mjekësore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe ngritjen e komisionit shumëdisiplinor me punonjëse/punonjës socialë dhe mjeke/mjekë, të cilat/cilët vlerësojnë edhe barrierat për pjesëmarrje në aktivitete të përditshme; c) dizenjimin e shportës së shërbimeve sociale përcjelljen te 61 bashkitë për ta konsideruar gjatë riorganizimit të strukturave vendore; d) miratimin e ligjit 65/2016 për ndërmarrjet sociale për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël; e) përmirësimin e veprimeve kundër dhunës në familje me miratimin e ndryshimeve ligjore dhe udhëzimeve përkatëse për zbatimin e tyre, fuqizimin e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit në rang vendi dhe unifikimin e qasjes përmes standardeve, protokolleve e procedurave standarde të veprimit; f) fuqizimin e kapaciteteve të profesionisteve/profesionistëve për adresimin e çështjeve të komunitetit LGBTI (trajnime gjatë vitit 2019 me punonjëset/punonjësit e shëndetësisë dhe plotësim i modulit gjatë vitit 2020 me një kapitull mbi barazinë gjinore); etj.

Neni 4

66. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka forcuar masat për të minimizuar çdo formë të diskriminimit të grave nga minoritetet gjuhësore, etnike, me aftësi të kufizuara, etj., përmes: takimeve me organizatat që punojnë me këto grupe; trajnimit të 160 punonjëseve/punonjësve për përmirësimin e njohurive mbi ligjet për barazinë gjinore dhe kundër diskriminimit; trajnimit të 252 punonjëseve/punonjësve të rolit zbatues dhe rolit të parë drejtues mbi ngacmimin seksual në vendin e punës (2016); trajnimit të 69 drejtueseve/drejtuesve të policisë mbi perspektivën gjinore (2017); trajnimit të 80 punonjëseve të policisë gra, të vlerësuara me çmime në Konferencat e Shoqatës Ndërkombëtare të Grave Police, etj.

67. Policia e Shtetit ka rritur përfaqësimin e grave, ku aktualisht rezultojnë 14.4% ose 1539 gra (962 punonjëse policie dhe 577 punonjëse civile). Në nivel drejtues në Policinë e Shtetit janë 14 gra. Në mbështetje të SKBGJ, Policia e Shtetit hartoi Planin e Veprimit "Për integrimin e punonjëseve të policisë gra" dhe zhvillon trajnime mbi barazinë gjinore, CEDAW, etj., (1507 gra në Policinë e Shtetit të trajnuara për 2016 – 2020).

68. Nga studimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbi "Barazinë gjinore dhe diskriminimin në organet e emëruara të pushtetit vendor" (2019), evidentohet se: është i nevojshëm ndryshimi i ligjit 139/2015 për vetëqeverisjen vendore, për adresimin e kuotës gjinore prej 30%, sipas parashikimeve të nenit 15 të ligjit për barazinë gjinore; duhet krijuar një mekanizëm efikas që të garantojë përfaqësimin e gruas gjatë rekrutimit të punonjëseve/punonjësve në administratën publike vendore; duhet të jetë i detyrueshëm respektimi i kuotës gjinore në të gjitha entet, shoqëritë tregtare, agjencitë, etj., që krijon pushteti vendor.

69. Në mbështetje të grupeve që përjetojnë diskriminim të shumëfishtë janë miratuar e, zbatuar strategji/plane veprimi në fushën e shëndetësisë, arsimit, pronësisë, mbrojtjes sociale, mbrojtjes nga diskriminimi, kundër trafikimit të qenieve njerëzore, etj., si: "Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në RSH 2016 – 2020"[20], "Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI në RSH 2016 – 2020"[21], Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar"[22], etj., që përmbajnë masa të veçanta për përfshirjen dhe integrimin e grave të këtyre grupeve, në shoqëri, punësim, pjesëmarrje dhe akses në të gjitha shërbimet.

[20] Miratuar me VKM-në nr. 1072, datë 23.12.2015. Shiko: http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2015/12/241.pdf
[21] Miratuar në 25 maj 2016.
[22] Miratuar në qershor 2016.

70. Rritja e përfaqësimit të grave nga grupe të cenueshme është përfshirë dhe në Planet Vendore të Veprimit për Barazinë Gjinore të hartuara nga 10 bashki të vendit, që kanë nënshkruar edhe Kartën Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore[23] (Karta është nënshkruar nga 13 Bashki: Gjirokastër, Tiranë, Korçë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Përmet[24], Bulqizë, Dibër, Librazhd, Cërrik, Pogradec dhe Kamzë[25]).

71. Shtimi i subvencioneve për punëdhënëset/punëdhënësit të cilat/cilët punësojnë gra nga grupet e veçanta, parashikimi i grupeve të veçanta të disavantazhuara në një tërësi ligjesh, miratimi i ligjit mbi minoritetet (2017); planifikimi i veprimeve për zvogëlimin e varfërisë dhe fuqizimin ekonomik, sidomos për gratë në zonat rurale, etj., janë disa prej masave të tjera të veçanta, të ndërmarra për grupet që pësojnë diskriminim të shumëfishtë.

Neni 5

72. Shqipëria prej vitesh organizon aktivitete ndërgjegjësuese mbi legjislacionin, mekanizmat mbrojtjes dhe shërbimet, në kuadër të fushatës botërore të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore (25 nëntor – 10 dhjetor). Koordinimi i aktiviteteve përmes MSHMS[26] në partneritet me ministritë e linjës dhe institucionet vendore e organizatat e shoqërisë civile, parashikohet edhe në SKBGJ 2016 – 2020. Sloganet kryesore gjatë fushatave kanë qenë: 2016: "Dhuna është e papranueshme. Denoncojeni atë!, 2017: "Fund dhunës ndaj grave e vajzave!", 2018: "Më dëgjo dhe mua!", 2019: "Brezi i barazisë kundër dhunës seksuale".

73. Aktivitete ndërgjegjësuese në kuadër të fushatës UNiTE: mesazhe nga gratë/të mbijetuarat e dhunës[27]; mesazhe nga grupet me diskriminim të shumëfishtë[28]; mesazhe mbi rolin e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit[29]; platforma avokuese me zërin e të rinjve/rejave, medias dhe rrjeteve të organizatave të shoqërisë civile, për adresimin e praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore, OZHQ-të dhe ICPD[30]; përdorimi i mjeteve inovative kundër dhunës më bazë gjinore[31]; ndriçimi i godinave të ndryshme shtetërore apo simbolike me portokalli, etj. Fushata dhe aktivitete ndërgjegjësuese janë realizuar edhe gjatë muajit mars të çdo viti.

74. KMD organizoi në korrik 2017, Ditë të Hapura[32] me përfaqësuese/përfaqësues të komunitetit Rom dhe Egjiptian, për sensibilizimin mbi ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, njohjen me problemet e komunitetit dhe marrjen e ankesave. Kjo iniciativë vijoi gjatë vitit 2020[33] me organizatat që veprojnë në terren. Gjatë janar – mars 2018 KMD organizoi 12 seminare ndërgjegjësuese me punonjëset/punonjësit e arsimit, njësive të shërbimeve sociale, mbrojtjes nga dhuna në familje dhe mbrojtjes së fëmijëve në nivel bashkie, zyrave rajonale të punësimit dhe OJF-ve të specializuara[34]. Gjatë vitit 2020 janë organizuar 2 fushata ndërgjegjësuese me spote të

---

[23] https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf.

[24] Me mbështetjen e UN Women, nga të cilat Bashkitë e Gjirokastrës dhe Përmetit nuk e kanë hartuar Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore 2018 – 2020.

[25] Me mbështetjen e projektit të USAID-it për Planifikimin dhe Qeverisjen Vendore, nga të cilat vetëm bashkia Kamzë nuk e ka hartuar Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2020 – 2023.

[26] Me mbështetjen e agjencive të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

[27] http://abcnews.al/grise-masken-folfushata-kunder-dhunen-ne-familje/.

[28] https://www.youtube.com/watch?v=rejoAqVHlB4.

[29] https://www.facebook.com/PNUDSHQIPERI/photos/pcb.1669355986456504/1669355389789897/?type=3&theater/https://twitter.com/PoliciaeShtetit/status/943867810295566341?s=19.

[30] Në mënyrë të veçantë UNFPA ka punuar në këtë drejtim për informimin e të rejave e të rinjve dhe organizatave të shoqërisë civile, por edhe për advokimin me gratë deputete për çështje që lidhen me dhunën me bazë gjinore dhe ICPD.

[31] "Jo vetëm në 8 Mars" titullohej video që fitoi *bootcamp* me studentë të Universitetit të Tiranës, për përgatitjen e fushatave ndërgjegjësuese. www.al.undp.org/content/albania/en/home/presscenter/articles/2016/03/08/on-international-women-s-day-students-launch-an-innovative-campaign-to- end-violence-against-women-and-girls-.html.

[32] Në Shkodër, Fier, Berat dhe Korçë.

[33] Në Fier dhe Shkodër.

[34] Në Durrës, Elbasan, Lushnjë, Fier, Vlorë, Lezhë, Shkodër, Korçë, Kukës, Berat, Gjirokastër, Tiranë.

shkurtra, si dhe sensibilizim në platformat *online*. Janë hartuar broshura informuese dhe janë zhvilluar takime virtuale të vazhdueshme me aktiviste/aktivistë të shoqërisë civile për iniciativa të përbashkëta në organizimin e paradave dhe ekspozitave ndërgjegjësuese.

75. Studimet e viteve të fundit, tregojnë se martesa e fëmijëve është një çështje e eksploruar pak, që prek vajza nga grupe të ndryshme shoqërore; nxitet kryesisht nga pabarazia gjinore, varfëria e përjashtimi social dhe ka një sërë efektesh të dëmshme. Nën vëmendjen e MSHMS-së, u prezantua në dhjetor 2018 një studim cilësor35 me të dhëna mbi njohuritë, qëndrimet, besimet, perceptimet, pritjet shoqërore, nxitësit, sanksionet dhe normat që lidhen me martesën e fëmijëve në Shqipëri. Gjetjet dhe rekomandimet do të orientojnë adresimin e mëtejshëm të kësaj çështjeje.

76. Sipas INSTAT-it, në vitin 2017, 16.9% e martesave të regjistruara përfshinin një bashkëshorte nën 19 vjeç dhe 0.5% një bashkëshort nën 19 vjeç. 20 vajza rezultonin të martuara para moshës 18 vjeç, gjatë vitit 2019, 4 më pak se në vitin 2018. Në vitin 2019 përqindja e vajzave të martuara në moshat 15 deri 17 vjeç është shumë e ulët, ndërsa shënon vlerat më të larta në moshën 18 dhe 19 vjeç, përkatësisht 8.2% dhe 6,8%. Ndërsa djemtë nuk kanë martesa para moshës 18 vjeç dhe përqindja e djemve të martuar në moshën 18-19 vjeç është nën 1,0%.

Dhuna me bazë gjinore: Ndihma ligjore falas dhe linja telefonike 24-orëshe

77. Informacioni mbi ndihmën ligjore falas gjendet në paragrafët 22, 23 të këtij raporti.

78. Linja Kombëtare e Këshillimit 116–117 u lançua më 24.11.2016, si shërbim 24/7 sipas standardeve të miratuara në përputhje me Konventën e Stambollit. Në 2017, janë pritur 1489 telefonata dhe janë kryer 636 këshillime ballë për ballë; në 2018, 2540 telefonata dhe 708 këshillime ballë për ballë; në 2019, 3014 telefonata dhe 861 këshillime ballë për ballë; janar – shtator 2020, 4226 telefonata dhe 488 këshillime ballë për ballë, (gjatë prillit 2020 numri i telefonatave u rri me 60% krahasuar me vitin e kaluar). Linja e Këshillimit ka funksionuar edhe gjatë situatës së mbylljes/izolimit për shkak të pandemisë COVID-19. Format e dhunës së raportuar janë psikologjike (57%), fizike (42%), ekonomike (31%) dhe seksuale (7 raste), shpesh të kombinuara. Denoncimi i dhunës seksuale mbetet ende në shifra të ulëta.

79. Në shërbim të publikut është edhe linja e telefonit 129 (ose 112 për Tiranën) e Policisë së Shtetit, 24/7, pa pagesë, për denoncimin e krimeve, përfshirë edhe rastet e dhunës në familje apo asaj me bazë gjinore. Në linjën telefonike të Policisë numri i telefonatave për dhunë në familje është: 1567 telefonata në vitin 2016; 2463 telefonata në vitin 2017; 2607 telefonata në vitin 2018; 1855 telefonata në vitin 2019 dhe 1,554 telefonata për janar – shtator 2020.

80. Ministria e Drejtësisë ka mundësuar shërbimin telefonik 24 orësh, me nr. jeshil pa pagesë 08001010, ku çdo individ mund të telefonojë dhe t'i ofrohet shërbimi i ndihmës juridike falas.

81. Fëmijët e dhunuar mund të telefonojnë ALO 116111, shërbim i specializuar, pa pagesë 24/7, i një organizate jo-fitimprurëse, që mbështetet edhe nga buxheti i shtetit. ALO 116111 ka pritur 2345 telefonata dhe referuar 774 raste në vitin 2016, 2374 telefonata dhe 581 raste të referuara në vitin 2018, 2212 telefonata dhe 1034 raste të referuara në vitin 2018; 4765 telefonata dhe 979 rate të menaxhuara për vitin 2019.

Funksionimi i Mekanizmave të Koordinuar të Referimit

82. Trajtimi i rasteve të dhunës në familje bëhet përmes përgjigjes shumësektoriale të mirëkoordinuar, pra Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR) në nivel vendor. MKR janë ngritur në 5636 nga 61 bashkitë në vend dhe po punohet në 5 bashkitë e tjera për ngritjen e MKR brenda vitit 2020. Paralelisht është punuar/po punohet për rritjen e efektivitetit të MKR-ve ekzistuese, bazuar në raportin e vlerësimit të vitit 2019.

83. Fuqizimi i kapaciteteve të koordinatoreve/koordinatorëve vendorë, mbi kuadrin ligjor të ndryshuar, trajtimin e rasteve për forma të caktuara të dhunës (dhuna seksuale), përmirësimin e

---

[35] Raporti "Martesa e Fëmijëve - Njohuritë, Qëndrimet dhe Perceptimet ndër komunitetet e prekura në Shqipëri", në bashkëpunim të ngushtë me UNICEF dhe UNFPA në Shqipëri dhe me mbështetjen financiare të Agjencisë Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

[36] Me mbështetjen e UNDP, UN Women, SCPA, SIDA dhe organizatave të tjera ndërkombëtare e OJF-ve.

koordinimit mes anëtarëve të MKR-ve dhe përdorimin e procedurave standarde të veprimit apo protokolleve të menaxhimit të rasteve, si dhe informimi/edukimi i publikut përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe përditësimi i sistemit REVALB, janë disa prej drejtimeve kryesore të ndërhyrjes në këto bashki, të udhëhequra/nën kujdesin e MSHMS.

84. Me urdhrat e ministres së MSHMS-së u miratuan (shkurt 2020), Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për punonjëset/punonjësit e shëndetësisë dhe të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të MKR-ve[37]. Për punonjëset/punonjësit e shëndetësisë u miratuan dhe PSV për zvogëlimin e rrezikut të përjetimit të dhunës me bazë gjinore në situata të emergjencave civile. Përdorimi i PSV-ve rrit efektivitetin e funksionimit të MKR-ve. Në korrik 2020 u zhvilluan 9 trajnime *online* me koordinatoret/koordinatorët vendorë, punonjëset/punonjësit e shëndetësisë dhe të shërbimit social të 61 bashkive, mbi përdorimin e PSV-ve, me 1678 pjesëmarrëse/pjesëmarrës gjithsej.

85. Dy protokolle për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje nga anëtarët e MKR (një lidhur me situatën COVID-19), u përgatitën[38] dhe përcollën te 61 bashkitë në vend, për miratim nga Komitetet Drejtuese të MKR-ve (maj 2020). Paralelisht u organizuan 2 trajnime *online* me koordinatoret/koordinatorët vendorë të 61 bashkive. Po përgatiten protokolle specifike për menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale te të miturat/miturit dhe të rriturat/rriturit.

86. VKM 334/2011 për funksionimin e MKR-ve po rishikohet që të përputhet me të gjitha përditësimet ligjore dhe rekomandimet e dhëna, përfshirë dhe nga CEDAW apo GREVIO. Janë zhvilluar konsultimet e para[39] dhe po përgatitet drafti i rishikuar.

Shërbimet mbështetëse të specializuara

87. Në Shqipëri ekzistojnë 18 shërbime mbështetëse të specializuara strehimi, të menaxhuara nga shteti, OJF-të ose në bashkëpunim, nga të cilat 7 strehëza afatgjata dhe 11 strehëza emergjente (9 të ngritura gjatë 2016-2020). Funksionimi i tyre rregullohet me standardet e miratuara, në përputhje dhe me Konventën e Stambollit. Në prill 2020 u miratua me urdhër 254/2020 të ministres së MSHMS-së protokolli i funksionimit të strehëzave në situatën e COVID-1940, për zbatimit e të cilit u zhvillua një trajnim *online* me 37 punonjëse të strehëzave dhe koordinatorëve/koordinatoreve vendore të bashkive ku ekziston shërbimi.

88. "Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje" strehëz shtetërore për viktimat e dhunës në familje ka trajtuar për këtë periudhë: 75 raste (28 gra, 47 fëmijë) në vitin 2015; 95 raste (36 gra, 59 fëmijë) në vitin 2016; 85 raste (35 gra, 50 fëmijë) në vitin 2017; 91 raste (35 gra, 56 fëmijë) në vitin 2018; 91 raste (38 gra, 53 fëmijë) në vitin 2019 dhe 48 raste (18 gra, 30 fëmijë) gjatë janar – shtator 2020.

89. Qendra e parë për menaxhimin e krizës për rastet e dhunës seksuale "LILIUM", u ngrit në 3.12.2018, me fonde të buxhetit të shtetit, në zbatim të rekomandimeve të CEDAW e GREVIO. Ofrohet shërbimin emergjent, me një ndalesë, 24/7 dhe afatshkurtër (24 – 72 orë), për viktimat/të mbijetuarit/mbijetuarat e dhunës seksuale dhe familjarët e tyre. Ngritja e shërbimit u parapri nga vlerësimi i situatës, prezantimi i modeleve ndërkombëtare[41] dhe vizita studimore në Korenë e Jugut, paralelisht me përgatitjen e standardeve të funksionimit[42]. Në LILIUM ofrohet modeli socio-shëndetësor, me ekip multidisiplinar me mjekë ligjorë, gjinekologë, pediatër, psikiatër, psikologë klinikë, punonjës socialë, punonjës të policisë, prokurorisë, avokatë dhe infermierë. Për trajtimin afatgjatë të rasteve rol të veçantë luan bashkëpunimi me MKR-të. Ambientet e rikonstruktuara të qendrës përmbushin standardet e shërbimit. Gjatë pandemisë

[37] Të përgatitura me mbështetjen e UNFPA.
[38] Me mbështetjen e PNUD-it.
[39] Me mbështetjen e PNUD-it.
[40] Me mbështetjen e UN Women. Shiko: https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/05/Urdhri-254-per-protokoll-strehezat..pdf.
[41] Me mbështetjen e UN Women.
[42] Me mbështetjen e PNUD-it.

COVID-19 u përgatit rregullore shtesë për funksionimin e saj. Në LILIUM janë trajtuar 60 raste të dhunës seksuale.

	0–6 vjeç	**7–12 vjeç**	**13–18 vjeç**	**19–25 vjeç**	**26–46 vjeç**	**47–60 vjeç**	**mbi 60 vjeç**
Viti 2019							
Vajza/gra	0	4	19	4	2	2	0
Djem/burra	2	1	3	2	0	0	0
Viti 2020							
Vajza/gra	0	8	9	2	1	0	0
Djem/burra	1	0	0	0	0	0	0

90. Këshillimi për burrat dhe djemtë dhunues kryhet nga Linjat e Këshillimit për Djem dhe Burra (LKDB) të ngritura në Tiranë dhe Shkodër. Gjatë periudhës 2016 – 2020 LKDB Tiranë ka trajtuar 366 raste, nga të cilët rastet e referuara kishin detyrim pjesëmarrjen në programin e rehabilitimit për dhunuesit.

Periudha	**Raste gjithsej**	**Referuar nga institucionet**	**Vetëreferuar**
2016	46	39	7
2017	67	53	14
2018	90	78	12
2019	110	76	34
Janar – qershor 2020	53	23	30

91. Të drejtën për kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera nga autoritetet, organizatat, institucionet përgjegjëse e kanë viktimat e veprës penale[43], të miturit/miturat, të abuzuarit/abuzuarat seksualisht, dhe viktimat e trafikimit.

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore

92. Policia e Shtetit ka plotësuar dhe dërguar në gjykatë kërkesë padi për UM/UMM, për 11,879 raste gjithsej, ose 2207 raste në 2016-tën; 2593 raste në 2017-tën; 3037 raste në 2018-tën; 2836 raste në 2019-tën dhe 1206 raste në janar – qershor 2020.

93. Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, ka ekzekutuar tërësisht brenda afateve 296 vendime UMM/UM për vitin 2016; 430 vendime gjatë vitit 2017; 502 vendime gjatë vitit 2018 dhe 360 vendime gjatë vitit 2019. Për vitin 2019 janë dhe 215 vendime (147 UM dhe 68 UMM) në ekzekutim të vazhdueshëm. Gjatë janar – prill 2020 janë 160 vendime të regjistruara për ekzekutim, nga të cilat 60 të ekzekutuara tërësisht, 5 pushuar me vendim gjykate dhe 95 në ekzekutim të vazhdueshëm.

94. Përmbaruesit janë përballur me: a) mbingarkesë dhe volum pune; b) masa mbrojtjeje të paqarta të përcaktuara në vendimin e gjykatës, apo raste kur dhunuesi detyrohet të dalë nga banesa dhe Gjykata ka përcaktuar si detyrim të Shërbimit Social pranë pushtetit vendor për të gjetur strehim për dhunuesin/debitorin, shërbim ky që pushteti vendor nuk e garanton; c) mungesë bashkërendimi me institucionet shtetërore për plotësimin e nevojave për viktimat e dhunës në familje, përfshirë mbështetje financiare, shërbime mjekësore e sociale, strehim, trajtim psikologjik, etj. Organizmi i gjatë vitit 2020 i trajnimit të përmbaruesve gjyqësorë për ekzekutimin e kësaj kategorie të titujve ekzekutivë, bashkërisht me gjyqtare/gjyqtarë, prokurore/prokurorë, punonjëse/punonjës policie, urdhrin e psikologut, etj., është domosdoshmëri.

Neni 6
Hetimi, ndjekja penale dhe dënimi i trafikantëve

95. Shqipëria renditet në "Grupin 2" sipas Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit. Zbatimi i Planit të Veprimit të Luftës kundër Trafikimit të Personave 2018 – 2020, monitorohet nga sektori antitrafik në Ministrinë e Brendshme. Veprimet fokusohen kryesisht në rivitalizimin dhe forcimin e strukturave kombëtare; identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave;

[43] Për më shumë detaje mbi të drejtat e viktimës referohuni shtojcës.

kontrollin e trafikimit të brendshëm, kryesisht të fëmijëve dhe grave; përmirësimin e standardeve të identifikimit dhe mbrojtjes së viktimave; intensifikimin e aktiviteteve për parandalimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut etj.[44].

96. Në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale (2017), parashikohet se Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon ndër të tjera, çdo vepër penale të kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal. Trafikimi i qenieve njerëzore përfshihet në kompetencat e kësaj gjykate, vetëm nëse vepra penale ka qenë produkt i veprimtarisë së grupeve të sipërcituar. Në të kundërt, këto vepra gjykohen nga gjykatat e rretheve gjyqësore.

97. Ligji 34/2019 për administrimin e pasurive të sekuestruara/konfiskuara mundëson mirëadministrimin dhe përdorimin eficient, efektiv dhe ekonomik të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga organet e drejtësisë dhe pasurive të sekuestruara me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, rikthimin në komunitet të pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimin financiar të viktimave të krimit.

98. Ligji 70/2017 "Për ndryshimet në ligjin për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pronës", zbatohet për pasuritë që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nga persona mbi të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm, për kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet e Kodit Penal të "Trafikimit të personave të rritur" dhe "Trafikimit të të miturve".

99. Policia e Shtetit për vitin 2016, ka identifikuar 69 vepra penale të trafikimit në persona dhe 103 vepra penale të lidhura me fushën e trafikimit në persona; ka realizuar 22 operacione policore me 222 autorë nga të cilët 41 të arrestuar, 17 të shpallur në kërkim, 33 të ndaluar, 130 ndiqen në gjendje të lirë; ka kryer 2 operacione policore në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë. Për vitin 2017, nga Strukturat për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme janë referuar në Prokurori 94 procedime penale; janë ndjekur 2 hetime të përbashkëta me homologët ndërkombëtarë në ngarkim të një grupi prej 18 shtetasish shqiptarë; janë evidentuar 202 vepra penale për trafikim të personave, nga të cilat 154 zbuluar me 260 autorë; janë goditur 7 grupe kriminale me 92 persona të implikuar me 69 autorë, nga të cilët 37 arrestuar, 8 ndaluar, 19 proceduar në gjendje të lirë dhe 5 shpallur në kërkim. Për vitin 2018 janë identifikuar 38 vepra penale të trafikimit të personave dhe 93 vepra penale që kanë lidhje me trafikimin e personave; janë finalizuar 3 operacione me 25 autorë, 7 autorë të arrestuar në flagrancë, 16 ndiqen në gjendje të lirë dhe 4 në kërkim. Për vitin 2019, janë evidentuar gjithsej 134 vepra penale në fushën e trafiqeve të paligjshme. Të dhëna të tjera nga Prokuroria, Ministria e Drejtësisë dhe Gjykatat e disa shkallëve, jepen në shtojcën 7.

Identifikimi i viktimave të trafikimit

100. Për identifikimin e emigrantëve të parregullt që hyjnë/dalin në/nga Shqipëria, janë trajnuar45 134 punonjëse/punonjës të policisë kufitare (2016).

101. Akademia e Sigurisë në bashkëpunim me Departamentin e Kufirit dhe Migracionit46 kanë zhvilluar gjatë vitit 2016 trajnime me mbi 40 punonjëse/punonjës të Policisë së Kufirit dhe Migracionit.

102. Për vitin 2018, nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin janë trajnuar 41 punonjëse/punonjës, ku 23 punonjëse/punonjës janë trajnuar mbi trafikimin e qenieve njerëzore[47] dhe 18 punonjëse/punonjës mbi identifikimin e grupeve vulnerabël në flukset migratore mikse[48].

103. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit u trajnuan gjatë vitit 2019 rreth 1,163 punonjëse/punonjës të Policisë Kufitare dhe Migracionit mbi Procedurat Standarde të Veprimit

---

[44] Kuadri ligjor kundër trafikimit të qenieve njerëzore paraqitet i detajuar në shtojcën 6 të raportit.
[45] Nga *Caritas*-i Shqiptar.
[46] Me mbështetjen e Organizatës Ndërkombëtare të Migracionit (IOM).
[47] Organizuar nga FRONTEX dhe Akademia e Sigurisë.
[48] Organizuar në bashkëpunim me IOM.

të Strukturave për Kufirin dhe Migracionin për Identifikimin, Mbrojtjen dhe Referimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Të dhëna mbi trajnimet jepen në shtojcën 8.

Mbrojtja e viktimave të trafikimit

104. Legjislacioni shqiptar parashikon përjashtimin e viktimave të trafikimit nga dënimi, jo nga ndjekja penale. Neni 52/a, paragrafi 2, i Kodit Penal: "Personi i dëmtuar nga veprat penale, që lidhen me trafikimin e personit, mund të përfitojë përjashtimin nga dënimi, për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ka qenë i detyruar t'i kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme". Në praktikë nuk ushtrohet ndjekja penale ndaj viktimave të trafikimit për vepra penale që janë detyruar të kryejnë si pasojë e trafikimit. Në raste të tilla, organi procedues argumenton se viktima nuk duhet të përgjigjet penalisht për shkeljet e kryera për shkak të trafikimit, pasi vullneti i saj ka qenë i cenuar dhe mungon ana subjektive e kryerjes së veprës penale.

105. Pothuajse në çdo rast të hetuar, viktimat e trafikimit vendosen në qendra të specializuara ku u jepet strehim, ushqim dhe shërbime të tjera falas. Ato kanë të drejtë të hyjnë në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, nëse ndjehen të kërcënuara. Asistenca dhe mbrojtja e viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit nuk është e kushtëzuar nga bashkëpunimi i saj me organet e drejtësisë.

106. Kodi i Procedurës Penale i ndryshuar (2017) parashikon që viktimat e trafikimit kanë të drejtë të: refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me jetën private, që qartësisht nuk kanë lidhje me veprën penale; kërkojnë të dëgjohen nëpërmjet mjeteve audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Për të miturin/miturën viktimë të trafikimit apo shfrytëzimit seksual, Kodi ka parashikuar në mënyrë të veçantë të drejtat dhe garancitë që njohu Konventa e Lanzarote, mbi shoqërimin e fëmijës nga një person i besuar prej tij; ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale; zhvillimit të gjykimit pa praninë e publikut; etj.

Financimi i njësive të lëvizshme

107. Ekzistojnë 6 njësi lëvizëse[49] në: Tiranë, Vlorë, Elbasan, Dibër, Kukës dhe Shkodër. Vetëm për vitin 2019, janë identifikuar 42 viktima/viktima të mundshme trafikimi.

Rritja e fondeve për qendrat e shërbimeve

108. Ekziston një strehëz e specializuar kombëtare dhe tri strehëza të specializuara të OJF, të cilat mbështeten edhe nga buxheti i shtetit[50]. Këto strehëza kanë trajnuar stafin për të mundësuar sigurinë e viktimave. Kohët e fundit, një tjetër OJF në Tiranë[51] ofron kujdes të menjëhershëm për fëmijët viktima dhe strehim deri në 21 ditë.

QENDRAT E SHËRBIMEVE	FONDI I TRANSFERUAR SIPAS VITEVE NË LEK				
	2016	**2017**	**2018**	**2019**	**2020**
Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit	21,704,000	22,219,660	22,476,939	20,910,000	20,820,000
Organizata "Të Ndryshëm dhe të Barabartë", Tiranë	6,473,439	9,804,597	8,467,317	9,054,487	9,054,487
Organizata "Tjetër Vizion", Elbasan	7,769,002	5,792,615	7,599,365	7,982,615	7,982,615
Qendra "Vatra", Vlorë	7,635,367	10,489,020	10,729,920	11,283,364	11,283,364

Neni 7

[49]Njësitë e lëvizshme janë grupe të përbëra me burime njerëzore nga institucionet shtetërore, konkretisht punonjës i policisë dhe PMF e njësisë ku vepron, dhe një anëtar i OJF-ve. Target grupi më së shumti janë fëmijët në situatë rruge dhe personat vulnerabël. Standardet e funksionimit të tyre janë hartuar në bashkëpunim me organizatën "Të Ndryshëm dhe të Barabartë".

[50] Qendra Kombëtare e Pritjes për Viktimat e Trafikimit (QKPVT) në Tiranë; Qendra "Të Ndryshëm dhe të Barabartë" në Tiranë; Qendra "Tjetër Vizion" në Elbasan; Qendra Kombëtare e Pritjes për Viktimat e Trafikimit (QKPVT) në Tiranë.

[51] OJF "Plan & Go".

Kuotat gjinore në zgjedhjet politike

109. Në këtë legjislaturë, Kuvendi i Shqipërisë, numëron 41 gra deputete, numrin më të lartë të grave krahasuar me legjislaturat e mëparshme; nënkryetarja e Kuvendit dhe drejtueset e tre Komisioneve të Përhershme dhe tre Nënkomisionieve janë gra. Kabineti Qeveritar ka 8 gra ministre (57%). Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor në vitin 2020 theksojnë që detyrimi për respektimin e parimit të barazisë gjinore u përket subjekteve zgjedhore, administratës zgjedhore dhe gjykatës. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka të drejtë të ndërhyjë në çdo kohë të kërkojë pushimin e cenimit të këtij parimi dhe, në rast mosveprimi, të ndërhyjë kryesisht për rivendosjen e tij.

110. Gjatë periudhës gusht 2016 – qershor 2017, që përmbyll legjislaturën parlamentare 2013-2017, KQZ ka plotësuar tri vakanca të njoftuara nga Kuvendi, në një prej të cilave u zbatua sanksioni plotësues mbi barazinë gjinore: me vendimin 108/2016, mandati i deputetit iu dha kandidates së radhës grua, në listën shumemërore të Partisë Demokratike, qarku Dibër.

111. Në zgjedhjet parlamentare 2017 u regjistruan 18 parti politike dhe 2,666 kandidatë/kandidate, nga të cilët/cilat 1,073 gra (40%). Sipas nenit 67, pika 6 të Kodit Zgjedhor, për çdo zonë zgjedhore të paktën 30% e listës shumemërore dhe një në tre emrat e parë duhet t'i përkasin secilës gjini. Kur shkelet kriteri i gjinisë në përbërjen e listave të kandidatëve/kandidateve për deputetë, KQZ vendos sanksione administrative. KQZ vendosi gjobë në masën 1 milion lekë për Partinë Socialiste (mosrespektim i kuotës gjinore në qarkun Berat), 1 milion lekë për Partinë Lëvizja Socialiste për Integrim (mosrespektim i kuotës gjinore në qarkun Tiranë), dhe në masën 12 milion lekë për Partinë Demokratike (mosrespektim i kuotës gjinore në të 12 qarqet, shifra më e lartë financiare penalizuese për një parti politike që prej aplikimit të sistemit të kuotave).

112. Partia Demokratike depozitoi ankim në Kolegjin Zgjedhor me objekt kundërshtimin i vendimit 566/2017 për sanksionin administrativ për barazinë gjinore por Kolegji Zgjedhor vendosi rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të KQZ-së.

113. Në vitin 2019, pas njoftimit nga Kuvendi i Shqipërisë për krijimin e 58 vakancave, mandate që i përkisnin Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim, KQZ zbatoi procedurat për plotësimin e tyre duke respektuar kriterin e gjinisë.

114. Për zgjedhjet vendore 2019, u regjistruan 97 kandidatë/kandidate për kryetarë/kryetare bashkie (80 burra, 17 gra) dhe 231 lista shumemërore për këshillat bashkiakë me 9872 kandidatë/kandidate (5,033 burra, 4,839 gra). Këshillat Bashkiakë kanë 43,7% gra fituese në përbërje të tyre. Gjatë procesit të verifikimit të listave shumemërore rastet e konstatuara të mosplotësimit të kriterit gjinor iu kthyen propozuesve për korrigjim/plotësim, në respektim të procedurave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor. Brenda afatit ligjor, subjektet përkatëse ridepozituan listat shumemërore të kandidatëve/kandidateve për këshillat bashkiakë, duke respektuar kriterin e kuotës gjinore.

115. Në kushtet e korrigjimit/saktësimit të listave shumemërore sa i përket respektimit të kuotave gjinore, KQZ nuk zbatoi ndaj asnjë subjekti zgjedhor sanksionin e përcaktuar në Kodin Zgjedhor lidhur me barazinë gjinore: atë të refuzimit të listës së kandidatëve për këshillin e bashkisë. Mandatin e anëtarit/anëtares të Këshillave Bashkiakë e fituan 1,619 kandidatë/kandidate të listave shumemërore (913 burra, 706 gra).

116. Në të gjitha proceset zgjedhore të zhvilluara gjatë periudhës së raportimit, partitë politike për të cilat përcaktohet detyrimi i kuotës gjinore 30% në propozimet e anëtarëve të komisioneve zgjedhore të nivelit të dytë (KZAZ), e kanë zbatuar atë.

Monitorimi i zbatimit të kuotës në pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje

117. Studimi i publikuar në vitin 2019 nga KMD[52] evidentoi se: a) nga 58 bashki që kanë dhënë informacion, 37 kanë më shumë se 1 zëvendëskryetar/zëvendëskryetare dhe 21 kanë vetëm një zëvendëskryetar (asnjë grua); b) në 20 bashki me të vetmin zëvendëskryetar burrë, asnjë

[52] "Barazia gjinore dhe diskriminimi në organet e emëruara të pushtetit vendor" në bashkëpunim me UN Women Shqipëri.

nuk drejtohet nga kryetare grua. Nga 37 Bashki me 2 apo më shumë zëvendëskryetarë/zëvendëskryetare, vetëm 15 kanë respektuar kuotën gjinore me 30% apo më shumë. 20 nga 37 bashkitë nuk kanë asnjë grua zëvendëskryetare megjithëse bashkia ka në strukturë të paktën 2 të tillë; c) nga 343 Administratore/administratorë të emëruar në këto 58 bashki, janë vetëm 52 gra (ose 15%).

118. Në personelin akademik të institucioneve publike dhe jopublike të arsimit të lartë, ka rritje të numrit të grave nga 55% në vitin akademik 2015 – 2016, në 56.6% në vitin akademik 2018 – 2019. Edhe numri i mësueseve gra është rritur nga 74% në vitin shkollor 2015 – 2016, në 77% në vitin shkollor 2019 – 2020. Organika e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka 50% gra më shumë në vitin 2020 krahasuar me vitin 2016.

119. Në Ministrinë e Kulturës, ministrja është grua, 15 drejtuese gra (24 burra) dhe aparati ka 59 punonjëse gra dhe 22 burra.

120. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka të punësuara 113 gra (59%) ndërsa në poste drejtuese janë 31 gra (50%).

121. Në strukturat e policisë, numri i punonjëseve gra është shumë i ulët dhe nuk ka ndryshime të konsiderueshme në pesë vitet e fundit. Për vitin 2019, ndër 10,434 punonjës/punonjëse të policisë, klasifikuar sipas gradave dhe gjinisë, 14,5% janë gra. Në nivelet e larta drejtuese, asnjë grua është në pozicionin Drejtues Madhor. Në vitin 2019, vetëm 1 grua zë nivelin e Drejtuesit të Lartë dhe 1 grua në nivelin e Drejtuesit të Parë. Numri i punonjëseve gra vjen duke u rritur me uljen e nivelit të gradave duke arritur nivelet më të larta për gradat Inspektore dhe Nënkomisare. Në vitin 2019, në totalin e grave të punësuara, gratë Inspektore përbëjnë 43,7% dhe gratë Nënkomisare 11,4%.

122. Në Forcat e Armatosura, në vitin 2016 një grua bëhet e para Gjenerale Brigade dhe emërohet komandante e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, aktualisht në detyrë zv./shefe e Shtabit të Përgjithshëm të FA; në vitin 2018 emërohet në detyrën e Prefektes së Tiranës një ish ushtarake grua (kolonele në rezervë). Deri në mars 2019 kishin detyra si ministre, sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Mbrojtjes, zv./shefe e Shtabit të Përgjithshëm të FA, drejtore, zv./drejtore, zv./ATASHE, gjithsej 9 gra civile dhe 4 gra ushtarake. Nga viti 2014 deri në mars 2019 kanë marrë pjesë në misione, operacione të NATO-s në Afganistan, Letoni, Kosovë, Detin Egje rreth 50 gra ushtarake (oficere, nënoficere, ushtare). Për herë të parë në vitin 2019 mori pjesë në mision në Afganistan një grua nëntogere në detyrë komandante toge. Për herë të parë në prill 2019, 2 ushtarake gra oficere janë bërë pjesë e misionit të OKB në Sudanin e Jugut. Në vitin 2019, gratë në FA zënë 19,4%.

123. Grave pronare ose administratore në ndërmarrjet aktive, për vitin 2019 janë 25,4% nga 25,7% në vitin 2018. Përqindja e grave pronare/administratoreve është më e lartë në ndërmarrjet e vogla (me 1 – 4 të punësuar) me 25,8% gra, përqindje kjo më e vogël, krahasuar me vitin 2018. Në kategoritë e tjera të ndërmarrjeve (5 – 9 të punësuar, 10 – 49 dhe mbi 50 punonjës) përqindja e pronareve/administratoreve gra është rritur, krahasuar me vitin paraardhës.

124. Përqindja e grave të punësuara në sektorin publik në nivelin e lartë të menaxhimit, për periudhën 2014 – 2020.

1/2020 – 8/2020	40.3%
2019	41.3%
2018	44.2%
2017	40%
2016	38.8%
2015	34.8%
2014	41.3%

125. Përqindja e grave të emëruara në të gjitha pozicionet në shërbimin civil (ekzekutiv, menaxhim i ulët, menaxhim i mesëm, menaxhim i lartë):

Përqindja e vitit/femra

2019	49%
2018	54%
2017	58%
2016	60%
2015	56.4%
2014	60%

Pjesëmarrja e grave nga komunitete të disavantazhuara

126. Ligji 96/2017 për mbrojtjen e pakicave kombëtare, parashikon dispozita mbi pjesëmarrjen e grave/të rejave nga minoritetet në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike në veçanti, në çështjet lidhur me ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e kulturës, traditave dhe identitetit të pakicës së cilës ato i përkasin.

Neni 8

127. Në vitin 2018 ishin 14 gra Ambasadore, 1 grua e ngarkuar me punë (nga 72 përfaqësi diplomatike). Në totalin e 63 diplomatëve/diplomateve në MEPJ, 52.4% janë gra dhe 47.6% burra. Në pozicionet drejtuese në MEPJ: 1 zëvendësministre, 1 drejtore e Përgjithshme, 4 Ddrejtore dhe 10 përgjegjëse sektori janë gra. Pjesëmarrja e gruas në misionet diplomatike në vitin 2019, ishte në nivele të krahasueshme me burrat. Përqindja e grave në postet Ambasador dhe Sekretar të Tretë ishte më e ulët krahasuar me burrat; në postet ministër fuqiplotë, ministër këshilltar, këshilltar, sekretar i parë dhe i dytë përqindja e grave është më e lartë.

Pjesëmarrja në misionet diplomatike, 2019

	Numër		%	
Posti	**Burra**	**Gra**	**Burra**	**Gra**
Ambasador	36	15	70.6	29.4
Ministër Fuqiplotë	3	6	33.3	66.7
Ministër Këshilltar	6	7	46.2	53.8
Këshilltar	9	11	45.0	55.0
Sekretar i Parë	8	16	33.3	66.7
Sekretar i Dytë	13	20	39.4	60.6
Sekretar i Tretë	2	1	66.7	33.3

128. Në Përfaqësitë tona diplomatike, janë 76 gra diplomate (49%) dhe në poste drejtuese në Përfaqësi, 15 gra (29%). Respektimi i kuotës gjinore është përfshirë dhe në PBA 2019 – 2021 të MEPJ-së.

Neni 9

Eliminimi i kufizimeve

129. Çështja mbi fëmijët e paregjistruar të lindur në Greqi, nga prindër të pa pajisur me dokumentacion të rregullt apo leje qëndrimi në këtë shtet, për të cilët nuk mundësohet vendosja e emrit të fëmijës në shërbimin e gjendjes civile ku është mbajtur akti i lindjes, është zgjidhur në vitin 2016 nëpërmjet regjistrimit të këtyre fëmijëve në bazë të një deklarate të mbajtur nga prindërit në shërbimin konsullor shqiptar.

130. Për vitin 2017, sipas statistikave të nxjerra nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, 38,513 fëmijë janë lindur dhe regjistruar po këtë vit dhe 6,387 fëmijë janë lindur në vitin 2016 dhe regjistruar në vitin 2017. Për janar-gusht 2018, 21,482 fëmijë janë lindur dhe regjistruar dhe 7,006 fëmijë të lindur në vitin 2017 janë regjistruar në vitin 2018. Në vitin 2019, u regjistruan 28,853 fëmijë dhe për janar – gusht 2020, janë regjistruar 17,610 fëmijë.

131. Gjatë vitit 2018, janë ndryshuar disa dispozita mbi procesin e regjistrimit të fëmijëve, në ligjin për gjendjen civile, që stimulojnë regjistrimin e fëmijëve menjëherë pas lindjes53,

[53] Qeveria Shqiptare ka miratuar VKM-në nr. 740, datë 12.12.2018, "Për përcaktimin e ndihmës së

regjistrimin e fëmijëve të lindur dhe të pa regjistruar, si dhe të fëmijëve që kanë lindur apo mund të lindin jashtë shtetit54. Gjithashtu parashikohet procedura e regjistrimit për fëmijët e lindur jashtë vendit për të cilët akti i lindjes është i paplotë (pa emrin e fëmijës), dhe deklarata e lindjes për një fëmijë të gjetur, me prindër të panjohur bëhet nga përfaqësuesit e autoriteteve përkatëse të qeverisjes vendore, njësitë e rendit publik nën juridiksionin territorial, aty ku gjendet foshnja. Në rastet kur fëmija nuk është regjistruar nga subjektet e lartpërmendura, procedura e regjistrimit përfundon nga gjendja civile dhe punonjëset/punonjësit e njësisë së mbrojtjes së fëmijëve. Nëpunësja/Nëpunësi i gjendjes civile, pranë institucioneve të shërbimit spitalor ku kryhet lindja, kryen veprimet e verifikimit *online* të statusit të nënës dhe regjistron fëmijën e lindur në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

132. Siç është raportuar më parë, legjislacioni shqiptar mbi shtetësinë e grave dhe fëmijëve të tyre është tërësisht në përputhje me nenin 9 të Konventës.

Neni 10

133. Gjatë 2014 – 2020 janë marrë masa për përfshirjen në arsim të fëmijëve dhe të rriturave/rriturve Romë dhe Egjiptianë. VKM-të dhe udhëzimet e miratuara mundësojnë: a)tekstet shkollore dhe transportin falas për arsimin bazë; b) regjistrimin me përparësi të fëmijëve romë në kopshte, arsimin bazë dhe "gjimnazin me kohë të pjesshme"; c) pagesën vetëm 50% të tarifës së shkollimit në ciklin e dytë të studimeve (master) për studentet/studentët romë dhe egjiptianë[55]; d)lehtësimin e procedurave të regjistrimit/rikthimit në shkollë të fëmijëve që, për rrethana të përcaktuara, nuk e kanë ndjekur arsimin bazë për të paktën dy vite shkollore, kanë braktisur shkollën, identifikohen si të paregjistruar në shkollë ose janë fëmijë në situatë rruge; e)lehtësimin e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme nga të rriturat/rriturit që nuk kanë arritur ta mbarojnë arsimin bazë me kohë të plotë, duke u pranuar në një apo dy klasa më të larta se klasa për të cilën zotërojnë dokument shkollor, kur aprovohet nga komisioni përkatës56; f)përjashtimin e studenteve/studentëve romë dhe egjiptianë nga tarifa e shkollimit në ciklin e parë të studimeve bachelor[57]; g)nënshkrimin e marrëveshjeve ndërministrore për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të arsimit të detyruar dhe fëmijëve në situatë rruge; h)eliminimin e qëndrimeve përjashtuese dhe inferiore ndaj romëve e egjiptianëve në komunitetin shkollor; i)ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kulturor të nxënëseve/nxënësve dhe studenteve/studentëve romë, egjiptianë, etj.

134. Prej tre vitesh, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e vartësisë në nivel vendor plotësojnë portalin "RomAlb", si burim të dhënash. Zbatimi i Planit Kombëtar të

---

menjëhershme financiare (*bonus*) për nënat me foshnjat të porsalindura dhe procedurës së dhënies së tij". Kjo ndihmë financiare është akorduar për ata fëmijë të lindur në Shqipëri dhe jashtë vendit, të regjistruar në kohën e duhur, sipas afateve kohore të parashikuara në dispozitat e ligjit të gjendjes civile. për fëmijët që do të lindin, qeveria shqiptare nga 1 janari 2019, veç bonusit prej 5 000 lekë që jepeshin për regjistrimin brenda afateve të parashikuara në ligj, jep për çdo lindje edhe një bonus tjetër plus, që sipas rastit kap vlerën: 35 000, 75 000 ose 115 000 lekë. Ky proces është rregulluar me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe me udhëzim të përbashkët të dy ministrave, Ministrit të Brendshëm dhe ministrit Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

[54] Janë hartuar tre akte nënligjore, tre udhëzime të ministrit të Brendshëm të cilët kanë hyrë në fuqi dhe kanë filluar efektet e tyre për zgjidhjen e rasteve. Udhëzimi nr. 284, datë 11.3.2019, "Për procedurën e mbajtjes së aktit të lindjes të fëmijëve, në rastet kur nuk është respektuar afati kohor i regjistrimit të tyre, brenda 60 ditëve nga data e lindjes". Udhëzimi nr. 285, datë 11.3.2019, "Për krijimin, administrimin dhe përditësimin e regjistrit të përkohshëm për lindjet e raportuara". Udhëzimi nr. 286, datë 11.3.2019, "Për përcaktimin e procedurës administrative që zbatohet nga zyrat e gjendjes civile kur në aktin e lindjes mbajtur jashtë Republikës së Shqipërisë është e paplotësuar rubrika e emrit".

[55] VKM-ja nr. 780, datë 26.12.2018.

[56] Për pikat "d" dhe "e", shiko udhëzimin nr. 17, datë 9.5.2018, "Për procedurat e ndjekjes së arsimit të detyruar nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë dhe për arsimimin me kohë të pjesshme në arsimin bazë".

[57] VKM-ja nr. 40, datë 23.1.2019.

Veprimit për Integrimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian, 2016-2020, edhe për vitin 2020, mbetet një nga sfidat e MASR-së.

135. Gjatë vitit shkollor 2018 – 2019 ndoqën arsimin parauniversitar 15,923 nxënëse/nxënës romë dhe egjiptianë (4,823 romë, 11,100 egjiptianë) ose 915 nxënëse/nxënës më shumë se, një vit ë parë. Gjatë vitit shkollor 2019 – 2020, ndoqën arsimin parauniversitar 14,515 nxënëse/nxënës romë dhe egjiptianë (4,862 romë, 9,653 egjiptianë), ose 39 nxënëse/nxënës romë më shumë se një vit më parë. Nga 3,792 nxënëse/nxënës romë në arsimin bazë dhe atë të mesëm të lartë, 1,703 janë vajza. Nga 7,915 nxënëse/nxënës egjiptianë në arsimin bazë dhe atë të mesëm të lartë, 3513 janë vajza.

136. Numri i të rejave/grave rome dhe egjiptiane në arsimin parauniversitar me kohë të pjesshme katër vitet e fundit, ka ardhur në rritje. Në vitin shkollor 2017 – 2018 arsimin parauniversitar e ndoqën 12 nxënëse rome, ndërsa vitin shkollor 2019 – 2020 e ndoqën 32 nxënëse. Në vitin shkollor 2016 – 2017 arsimin parauniversitar e ndoqën 16 nxënëse egjiptiane, ndërsa vitin shkollor 2019 – 2020 e ndoqën 28 nxënëse.

137. Kuadri ligjor i arsimit siguron mosdiskriminim për shkak të gjinisë apo aftësisë së kufizuar. Baza e të dhënave për fëmijët me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor, përditësohet çdo vit shkollor, me të dhëna të detajuara (moshë, gjini, klasë, lloji i paaftësisë dhe vendbanimit) mbi të cilat përcaktohen nevojat për mbështetje për fëmijët me AK.

138. Për vitin shkollor 2019 – 2020 mbi 33% (N=1,540) e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin bazë dhe të mesëm të lartë janë vajza. Vetëm 10% e tyre ndjekin shkollat speciale ndërsa 90% ndjekin shkollat e zakonshme. Rreth 50% e nxënësve me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin e mesëm të lartë, janë vajza.

139. Komisionet Multidisiplinare që funksionojnë pranë çdo institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar", vlerësojnë në fillim të çdo viti shkollor, si dhe herë pas here gjatë vitit, nevojën e fëmijës me aftësi të kufizuara për mësuese/mësues ndihmës dhe për plan individual mësimor. Gjithashtu nxënësi me aftësi të kufizuara, vlerësohet dhe nga komisioni i shkollës, i cili ndjek ecurinë e fëmijës, harton dhe zbaton planin e tij individual.

140. Për vitin shkollor 2019 – 2020, numri i mësueseve/mësuesve ndihmës për nxënëset/nxënësit me AK në institucionet e arsimit parauniversitar, përfshirë edhe institucionet e arsimit parashkollor, ishte 1,318 mësuese/mësues, nga të cilat/cilët 158 janë në institucione private. Në krahasim me një vit më parë, numri i mësueseve/mësuesve ndihmës u rrit mbi 34%.

141. Përqindja e braktisjes së arsimit nga ana e vajzave është ulur nga 0.61% në vitin shkollor 2016 – 2017 në 0.58% në vitin shkollor 2018 – 2019, nga ku:

a) Në arsimin bazë është ulur nga 0.53% në vitin shkollor 2016 – 2017 në 0.46% në vitin shkollor 2018 – 2019;

b) Në arsimin fillor është ulur nga 0.50% në vitin shkollor 2016 – 2017 në 0.44% në vitin shkollor 2018 – 2019;

c) Në arsimin e mesëm është ulur nga 0.56% në vitin shkollor 2016 – 2017 në 0.47% në vitin shkollor 2018 – 2019.

142. Sipas të dhënave nga INSTAT, përqindja e studenteve/studentëve të diplomuar sipas viteve akademike në fushat e shkencës, inxhinierisë, etj. jepet në tabelën në vijim[58]:

Fushat	**2016 – 2017**		**2017 – 2018**		**2018 – 2019**	
	F	**M**	**F**	**M**	**F**	**M**
Inxhinieritë, prodhim dhe ndërtim	5%	14%	5.8%	16.1%	5.3%	17.5%
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	5%	4%	4.7%	3.5%	4.7%	2.9%
Teknologjitë e informacionit e komunikimit	4%	9%	4.7%	10.4%	3.7%	8.6%
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari	2%	4%	2.9%	5.9%	2.2%	5.3%

[58] INSTAT, botimet "Gra dhe burra në Shqipëri", për vitet 2018, 2019 dhe 2020.

Neni 11

143. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) dhe Plani i veprimit për zbatimin e saj 2019–2022, është miratuar me VKM-në nr. 659, datë 10.10.2022, duke konfirmuar si relevante të katër prioritetet strategjike (nga vlerësimi i zbatimit të saj). U rishikuan treguesit deri në vitin 2022, të cilët bazohen në një bazë të dhënash, në bashkëpunim të ngushtë me INSTAT-it. Të gjithë treguesit e shërbimeve të monitorimit dhe programet e ofruara nga Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA) përfshijnë tregues të barazisë gjinore, të pasqyruar në programin statistikor të rishikuar në çdo fundviti, dhe pasqyruar në të gjitha raportet periodike. Edhe treguesit në sistemin e informacionit në tregun e punës, të bazës së të dhënave shtetërore për Sistemin e Shërbimit të Punësimit, përmbajnë të dhëna të ndara sipas seksit.

144. Për sa i përket popullsisë 15–64 vjeç, pjesëmarrja e grave në forcat e punës është rritur: 58,3% për vitin 2016, në 57,7% për vitin 2017, 59,7% për vitin 2018 dhe 61,6% për vitin 2019. Totali i punësimeve të realizuara nga zyrat e punësimit rezulton 25,170 punësime për vitin 2016 (53,5% gra), 23,136 punësime për vitin 2017 (50,5% gra), 32,846 punësime në vitin 2018 (50,4% gra) dhe 30,391 punësime në vitin 2019 (49% gra). Është zvogëluar numri i punëkërkueseve/punëkërkuesve të papunë afatgjatë nga 54,323 persona (28,007 gra) në vitin 2016, në 35,194 persona (19,221 gra) në vitin 201959.

145. Shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç në vitin 2019 është 68,2% për burrat dhe 54,4% për gratë. Struktura e të punësuarve sipas statusit të aktivitetit tregon se 27,1% e grave janë të punësuara me pagë, ndërsa 15,2 % e tyre janë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes. Për burrat e punësuar këto shifra janë përkatësisht 31,3% dhe 10,8%. Burra të vetëpunësuar përbëjnë 26,1%, ndërsa gratë e vetëpunësuara 12,1%. Për gratë dhe burrat e moshës 15 – 64 vjeç mbizotëron punësimi në sektorin e bujqësisë.

146. Përqindja e grave (dhe burrave) të punësuar në "Bujqësi" nga viti 2016 ka rënë: 45,4% gra dhe 36,2% burra në vitin 2016, 42,5% gra dhe 34,9% burra në vitin 2017, 42,3% gra dhe 33,5% burra në vitin 2018 dhe 41,6% gra dhe 32,3% burra në vitin 2019. Rënie vihet re edhe në sektorin "Industri nxjerrëse, energji, gaz dhe furnizim me ujë", me të punësuar: 1% gra dhe 3,9% burra në vitin 2016, 0,6% gra dhe 3,7% burra në vitin 2017, 0,8% gra dhe 3,3% burra në vitin 2018 dhe 0,8% gra dhe 3,2% burra në vitin 201960.

147. Në vitin 2019, shkalla e papunësisë për burrat në moshën 15-64 vjeç është 12,2 %, kundrejt 11,8 % të grave. Shkalla e papunësisë për të dy gjinitë ka pësuar rënie krahasuar me një vit më parë. Situata e papunësisë për burrat është përmirësuar më shumë krahasuar me gratë, duke pësuar një rënie prej 1,0 pikë përqindje krahasuar me 2018, ndërsa për gratë rënia është 0,5 pikë përqindje61.

148. Numri i punëkërkueseve/punëkërkuesve të papunë pjesëmarrës në programe të nxitjes së punësimit, për vitin 2016 ishte 5,211 persona (2,233 gra), për vitin 2017 ishte 5,264 persona (3,239 gra), për vitin 2018 ishte 4,808 persona (2,260 gra) dhe për vitin 2019 ishte 5,338 persona (3,045 gra).

149. Numri i punëkërkueseve/punëkërkuesve të papunë të regjistruar në kurse formimi profesional për vitin 2016 ishte 12,710 persona (7,032 gra), për vitin 2017 ishte 17,297 persona (6,200 gra), për vitin 2018 ishte 12,403 persona (4,931 gra) dhe për vitin 2019 ishte 8,818 persona (3.882 gra).

150. Gjatë vitit shkollor 2017 – 2018 u regjistruan në shkollat e mesme profesionale publike në të gjithë vendin 19.019 nxënëse/nxënës, nga të cilat/cilët 2,715 vajza (14%). Gjatë vitit shkollor 2018-2019 u regjistruan 19,311 nxënëse/nxënës, nga të cilat/cilët 3,102 vajza (16%).

---

[59] INSTAT, "Gra dhe burra në Shqipëri, 2020". Shiko: http://www.instat.gov.al/media/7376/burra-dhe-gra-2020.pdf.

[60] INSTAT, "Gra dhe burra në Shqipëri", 2020.

[61] Burim: Anketa e Forcave të Punës. Për më shumë të dhëna mbi punësimin dhe gratë, referohuni në tabelat përkatëse në shtojcën 9 të këtij raporti.

151. Paga mesatare bruto për një të punësuar sipas gjinisë, ndër vite ka pësuar këto ndryshime: për vitin 2016 ishte 50,084 lekë në muaj për burrat dhe 44,354 lekë në muaj për gratë, për vitin 2017 ishte 51,392 lekë në muaj për burrat dhe 46,018 lekë në muaj për gratë, për vitin 2018 ishte 53,181 lekë në muaj për burrat dhe 47,490 lekë në muaj për gratë dhe për vitin 2019 ishte 54,940 lekë në muaj për burrat dhe 49.411 lekë në muaj për gratë.

152. Në vitin 2019, sektori ekonomik, në të cilin hendeku gjinor në paga është më i lartë, është sektori i Prodhimit, ku vlera e HGJP-së arrin në 24,6%. Ndërsa sektori ekonomik ku HGJP arrin vlerën më të ulët, prej 0,7%, është sektori i ndërtimit. I parë sipas grup profesioneve kryesore, HGJP-ja arrin vlerën më të lartë për Zejtarët, dhe punonjësit e montimit të pajisjeve dhe makinerive, me 24,2%. Vlerën më të ulët HGJP-ja e arrin për Forcat e armatosura, me 3,0%, pra burrat kanë një pagë mesatare mujore bruto 3,0% më të lartë sesa gratë.

153. Shërbimet e punësimit publik janë falas për punëdhënëset/punëdhënësit dhe punëkërkueset/punëkërkuesit. Ligji 15/2019 përcakton që shteti shqiptar është i detyruar të marrë të gjitha masat e nevojshme për krijimin e infrastrukturës së nevojshme fizike, burimeve njerëzore dhe materiale për të siguruar, në zyrat e punësimit, shërbime të specializuara për grupe me nevoja të veçanta, që kërkojnë ndihmë për përfshirjen e tyre në tregun e punës. Informacioni jepet në forma dhe formate që janë të arritshme dhe të kuptueshme edhe për punëkërkueset/punëkërkuesit e papunë me aftësi të kufizuara.

154. Të dhëna administrative nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit

	2015	**2016**	**2017**	**2018**	**2019**
Totali i punëkërkuesve të papunë	145,147	93,889	83,497	64,781	68,589
Punëkërkuese të papuna femra	73,208	49,735	44,220	34,172	36,523
Të papunë që mbështeten me të ardhura (Përfitues të ndihmës ekonomike dhe pagesës së papunësisë)	65,458	45,738	41,251	22,345	24,651
Femra	33,061	23,960	21,181	11,225	12,454
Punëkërkues të papunë afatgjatë	68,885	54,323	42,594	32,473	35194
Femra	33,721	28,007	21,622	17,850	19,221
Punëkërkues të papunë nga grupet e veçanta	13,470	7,600	7,162	6.557	7,919
Femra	6,164	3,778	3,602	3,168	3,835
Totali i punësimeve të realizuara nga zyrat e punësimit	1,222	25,170	23,136	32,846	30,391
Femra	53%	53,5%	50,5%	50,4%	49%
Të papunë të përfshirë në programet e nxitjes së punësimit	5,805	5,211	5,264	4,808	5,338
Femra	70%	56%	62%	55%	50%
Punëkërkues të papunë që ndjekin falas kurse profesionale në qendrat publike	13,887	12,710	9,461	8,470	8714
Femra	5,672	5,678	4,454	4,779	4,832

Neni 12
Metodat kontraceptive

155. Kujdesi shëndetësor i integruar për gratë në qendrat shëndetësore në të gjithë vendin përfshin: kujdesin para, gjatë dhe pas lindjes për nënën dhe fëmijën, planifikimin familjar, parandalimin dhe diagnostifikimin e hershëm të kancerit të gjirit e të qafës së mitrës, shëndetin seksual, parandalimin dhe trajtimin e infeksioneve seksualisht të transmetueshme (IST) dhe infeksioneve të tjera të sistemit riprodhues, menaxhimin e dhunës ndaj gruas dhe në familje, etj. Shërbimi synon uljen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë amtare dhe perinatale, pakësimin e shtatzënive të padëshiruara, aborteve të pasigurta, shtatzënive të hershme, lindjeve prematurë dhe nën peshë, ofrimin e shërbimeve të sigurta për kryerjen e abortit, si dhe kontrollin e IST.

156. Të dhënat mbi abortet ndër vite:

Vitet	**Lindje**	**Aborte**	**Raporti i abortit**	**Lidhja: Lindje/aborte**

2015	32,715	5,880	180	5.6	:1
2016	31,733	5,410	170	5.9	:1
2017	30,869	5,279	171	5.8	:1
2018	28,934	5,532	191	5.2	:1
2019	28,561	5,183	181	5.5	:1

157. Pjesa më e madhe e aborteve kryhen nga gratë e grup-moshës 20 – 34 vjeç. Për grup-moshën 15 – 19 vjeç në moshën 16 vjeçare kemi vlerën më të lartë të këtij treguesi: 132 aborte për 1,000 lindje të gjalla. Në vitin 2019, numri më i lartë i aborteve është kryer nga gratë me nivel arsimor arsim bazë dhe të mesëm të lartë, duke zënë një peshë përkatësisht me 34,8 % dhe 25,6 %. Peshën më të vogël e zënë gratë me nivel arsimi fillor (2,6 %), ndërsa përqindja e aborteve nga gratë me arsim të lartë është 23,3 %. Sipas statusit martesor, 78,2 % e aborteve janë kryer nga gratë e martuara dhe 7,8 % nga gratë beqare. Abortet nga gratë e divorcuara ose të ve janë në nivele shumë të ulëta. Abortet e kryera nga gratë e papuna ose të pasiguruara, ndër vite, ndjekin të njëjtin trend dhe nivele të përafërta, duke përbërë rreth 55,1 % të aborteve gjithsej. Në vitin 2019, përqindja e aborteve të kryera nga gratë e punësuara shënoi një rritje prej 2,1 pikë përqindje, krahasuar me vitin e kaluar.

Akses në shërbimin shëndetësor për gratë e marxhinalizuara

158. Të gjithë shqiptarët nga 35 - 70 vjeç kanë mundësinë ta bëjnë kontrollin shëndetësor pa asnjë pagesë pranë qendrës shëndetësore të vendbanimit të tyre. MSHMS ka organizuar një fushatë të madhe ndërgjegjësimi për këtë qëllim ("Si je?") me postera e materiale informuese për të shpjeguar hapat që ndiqen për kryerjen e kontrollit shëndetësor dhe rëndësinë e tij. Viti 2019 shënoi një numër kontrollesh të realizuar prej 482,716 raste ose 7717 më shumë nga projeksioni vjetor prej 475,000 rastesh

159. "Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë, 2016 – 2020" edhe pse formalisht kufizohet në pesë vite, projekton objektivat themelorë të përmirësimit të kujdesit shëndetësor për dekadën e ardhshme, pra deri në vitin 2025. Strategjia parashikon shtimin e investimeve në infrastrukturën shëndetësore dhe pajisjet mjekësore për të garantuar akses dhe cilësi universale në ofrimin e kujdesit shëndetësor. Për vitet 2020 – 2021 janë parashikuar rikonstruksione të qendrave shëndetësore në qytete/njësi administrative (105 qendra shëndetësore vetëm për vitin 2020) me fond limit 651,153,042 lekë, i ndarë në dy vite; për vitin 2020 është akorduar vlera 422,991,042 lekë dhe diferenca për vitin 2021.

160. Në luftën kundër tumoreve, MSHMS punon në disa drejtime, në zbatim dhe të Planit Kombëtar kundër Tumoreve 2011–2020. Gjithsej në rang vend janë të instaluar 17 mamografi (15 stacionarë dhe 2 të lëvizshëm) që mundësojnë ofrimin e shërbimit nga veriu në jug të vendit. Nga të dhënat e sistemit publik ku përfshihen mamografi të lëvizshme dhe mamografi stacionare të vendosura në sistemin spitalor rezulton se në vitin 2016 janë kryer 8837 ekzaminime, në vitin 2017 janë kryer 10393 ekzaminime, në vitin 2018 janë kryer 16032 ekzaminime dhe në vitin 2019 janë kryer 19626 ekzaminime.

161. Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të forcimit të edukimit seksual gjithëpërfshirës në shkolla, përmes përpjekjeve të MASR, Institutit të Edukimit të Vazhduar, partneritetit me organizata të shoqërisë civile dhe mbështetjes financiare të organizatave ndërkombëtare. Programi i trajnimit të mësueseve/mësuesve përmban 110 orë trajnimi gjithsej të shtrira në një vit, që zhvillohen në module 3-4 ditore, ndërmjet të cilave jepen dhe detyra individuale që mbështesin përgatitjen në këtë drejtim.

162. Programi "Aftësitë e Jetës dhe Edukimi Seksual", konsiston në një numër modulesh të përfshira në lëndët e biologjisë, edukatës shëndetësore dhe edukimit fizik. Programet për grupmoshat 10–12, 12–16 dhe 16–18 vjeç janë të detyrueshme dhe gjithsej parashikohen 140 orë mësimore. Në këto lëndë trajtohen ndër të tjera: zhvillimi i trupit në grup mosha të caktuara, riprodhimi dhe organet riprodhuese, pjekuria seksuale, zhvillimi i fetusit gjatë shtatzënisë dhe

ndikimi i drogave, sëmundjeve dhe dietës, metodat kontraceptive, aborti dhe marrëdhëniet seksuale në moshë të hershme, IST më të përhapura në vendin tonë përfshirë HIV/AIDS, gonorreja, sifilizi etj.

Buxheti për sektorin shëndetësor

163. Prej vitit 2015, pacientet/pacientët shqiptarë përfitojnë paketat shëndetësore të nefrologjisë dhe kardiokirurgjisë falas, në spitalet publike dhe private me 10 shërbime spitalore: Dializa, Transplanti i veshkave, Terapia e flakjes akute, *Pacemaker* definitive, Angiografi koronare, Angioplastikë koronare, Interventet valvolare, Interventet kongenitale, By pass koronar, Implanti koklear për fëmijët me probleme dëgjimi. Këto paketa financohen 100% nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe zbatohen në bazë të protokolleve të miratuara nga MSHMS-ja. Financimi dhe realizimi i ndërhyrjeve kryhet fillimisht në sektorin publik. Për rastet përtej kapaciteteve të institucioneve shëndetësore publike, FSDKSH i financon këto paketa edhe në spitalet jopublike. Pacientët e përfitojnë shërbimin sipas një listë-pritje me rregulla të qarta e transparente.

164. Shqipëria mbetet vend me prevalencë të ulët të infeksionit HIV(0.03% dhe incidenca është 0.003%). Megjithatë, vihet re një tendencë në rritje e rasteve të reja në vitet e fundit.

Shpeshtësia e HIV/AIDS-it sipas viteve dhe gjinisë[62]

Vitet	Numër		%	
	Burra	Gra	Burra	Gra
2016	105	23	82.0	18.0
2017	69	25	73.4	26.6
2018	76	26	74.5	25.5
2019	72	29	71.3	28.7

165. Trajtimi dhe kujdesi ndaj personave me HIV/AIDS ofrohet në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", kryesisht në Shërbimin e Sëmundjeve Infektive dhe Shërbimin e Pediatrisë, si dy shërbime ku ofrohet kujdes i drejtpërdrejtë, si dhe në shërbime të tjera ndihmëse, si ai i imazherisë, Shërbimit të Laboratorëve Klinik dhe Shërbimit të Mikrobiologjisë, Shërbimit të Imunologjisë dhe të Farmacisë. Preparatet antiretrovirale të linjës së parë të mjekimit sigurohen falas nga një fond i posaçëm i MSHMS-së[63].

Numri kumulativ i personave me HIV që marrin mjekim me ARV	
2015	
Femra	130
Meshkuj	293
Gjithsej	423
2016	
Femra	145
Meshkuj	352
Gjithsej	497
2017	
Femra	157
Meshkuj	411

[62] Burimi: Instituti i Shëndetit Publik.

[63] Burimi është marrë nga "Dokumenti Strategjik dhe Plani i Veprimit për Shëndetin Seksual dhe riprodhues 2017 – 2021" i MSHMS (faqe 42).Shiko: https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/SRH_National_Strategic_Document_2017_-_2021.pdf

Gjithsej	568
2018	
Femra	179
Meshkuj	402
Gjithsej	581
2019	
Femra	187
Meshkuj	424
Gjithsej	611

Neni 13

166. Kuadri ligjor i përmirësuar mbi mbështetjen me shërbime shoqërore e fuqizimin ekonomik të grave, përfshirë dhe nga grupet e favorizuara, u analizua më sipër në këtë raport, (neni 2). Për vitin 2019, 0.5% e popullsisë ka qasje në paketën bazë të shërbimeve të kujdesit social, krahasuar me 0.4% që kishte në vitin 2017.

167. VKM-ja e miratuar në vitin 2018, në mbështetje të ligjit për ndërmarrjet sociale parashikon një fond mbështetës për to në vlerën prej 249,760,000 lekë, për periudhën 2019 – 2021, nga të cilat 37,000,000 lekë për krijimin e vendeve të reja të punës; 7,776,000 lekë për sigurimin e detyrueshëm shoqëror dhe shëndetësor të punonjësve të ndërmarrjeve shoqërore që u përkasin grupeve në disavantazh dhe pjesa tjetër për aktivitetin e tyre duke paraqitur një plan biznesi. Njësia ekonomike duhet të punësojë të paktën 3 punonjës të rinj nga kategoritë e pafavorizuara brenda 12 muajve nga momenti i marrjes së subvencionit. Dhënia e subvencioneve kushtëzohet nga punësimi i personave nga grupet e pafavorizuara dhe kohëzgjatja e kontratës duhet të jetë jo më pak se 2 vjet.

168. Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) gjithashtu mund të aplikojnë për fondin social, për të përmbushur nevojat e grupeve të pafavorizuara. Pothuajse 80% e NJVV-ve kanë përgatitur Planet Sociale me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare dhe Shërbimit Social Shtetëror, ku janë përfshirë masa edhe për viktimat e dhunës dhe trafikimit, sikurse dhe për grupet e tjera të pafavorizuara të grave. Por jo të gjitha këto plane janë miratuar në këshillat bashkiakë. Në prill 2019, MSHMS shpalli thirrjen e parë për aplikim nga NJVV nën Fondin Social dhe në nëntor 2019, 14 bashki morën 69,117,366 lekë (ose rreth 690 mijë euro) nga buxheti i ministrisë për financimin e shërbimeve sociale për 12 muaj. Shërbimet sociale të financuara lidheshin me mbulimin e nevojave për invalidët, të moshuarit, fëmijët dhe gratë në situata emergjente, të cilët jetojnë në marrëdhënie abuzive familjare, etj. Për vitin 2020 janë financuar dy bashki për ngritjen e qendrave të emergjencës në kuadër të Fondit Social.

169. Për vitin 2019, rezultojnë 4.932 gra përfituese nga skema e Ndihmës Ekonomike (NE). Në situatën e gjendjes së fatkeqësisë natyrore, nga skema e NE, rreth 63,510 familje kanë përfituar dyfishin e pagesës së ndihmës ekonomike. Ndërsa 4,524 familje, të cilat kishin aplikuar për ndihmë ekonomike nga muaji Korrik 2019 deri në Mars 2020 dhe nuk kishin përfituar nga skema e NE, pavarësisht se nuk ishin pjesë e skemës, por u identifikuan si familje në nevojë, morën një pagesë prej 16,000 lekë.

170. Janë trajtuar me pagesë 3000 lekë/muaj viktima të dhunës në familje: 42 raste për vitin 2016, 9 raste, për vitin 2017, 11 raste për vitin 2018 dhe 55 raste për vitin 2019.

171. Shërbimet shoqërore publike ofrohen në 30 qendra rezidenciale dhe 119 qendra komunitare/ditore, ndërsa shërbimet shoqërore jopublike ofrohen nga OJF ose organizata fetare në 86 qendra komunitare/ditore dhe 41 qendra rezidenciale; gjithsej në 276 qendra shërbimesh, të llojeve të ndryshme. Qendrat jopublike sigurojnë rreth 46% të shërbimeve shoqërore, përkundrejt 54% të totalit që sigurohen nga qendrat publike, ndërsa qendrat komunitare/ditore

sigurojnë rreth 74% të shërbimeve shoqërore përkundrejt 26% që sigurohen nga qendrat rezidenciale. Për vitin 2019, numri i përfituesve nga shërbimet rezidenciale dhe ditore publike të ofruara nga shteti është 1716 dhe numri i fëmijëve që përfitojnë kujdestari alternative dhe jo shërbim rezidencial është rritur me 13%, ndërsa numri i popullsisë që ka qasje në paketën bazë të shërbimeve sociale është 0,5% e popullsisë. Fondi në total i cili shkon për financimin e shërbimeve sociale për vitin 2019 në bashki dhe qarqe është 149,195,353 lekë. Janë financuar për vitin 2019, 12 shërbime të specializuara në 6 qarqe, me vlerë totale 62,000,000 lekë.

172. Plani i Veprimit për Riintegrimin social-ekonomik të grave dhe vajzave viktima/viktima të mundshme të trafikimit, miratuar në 2016[64] ka për qëllim mbulimin e ri/integrimit socio-ekonomik të grave dhe vajzave viktima/viktima të mundshme trafikimi në fushat e fuqizimit ekonomik, punësimit dhe formimit profesional, strehimit, arsimimit dhe kujdesit social[65].

173. Ligji 111/2018, "Për kadastrën", rregullon çështjet e barazisë gjinore, lidhur me regjistrimin e pasurisë së bashkësisë ligjore. Nëse pasuria, objekt i kontratës së kalimit të pronësisë, është pasuri e fituar gjatë martesës, në përputhje me nenin 76, të Kodit të Familjes, regjistrimi në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë bëhet në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve, për sa kohë ata nuk provojnë se i nënshtrohen një regjimi pasuror martesor të veçantë. Gjithashtu, ky ligj i jep të drejtë drejtorisë vendore të korrigjojë ose përditësojë të dhënat kadastrale për pasuritë e paluajtshme në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve, të fituara gjatë martesës përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, në rast se kjo kërkohet me shkrim nga bashkëshorti/bashkëshortja që nuk është i/e regjistruar. Kjo dispozitë zbatohet edhe për regjistrimin e pasurive të legalizuara, si dhe për regjistrimin e kontratës së sipërmarrjes, porosisë e të premtimit për shitje, kur këto të fundit synojnë kalimin e pronësisë së objektit në ndërtim, në të ardhmen.

174. KMD në vitin 2018, i ka dërguar rekomandim Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për marrjen e masave në lidhje me çështjen e regjistrimit të lejes së legalizimit në emër të të dy bashkëshortëve ose ish-bashkëshortëve.

Neni 14

175. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural planifikon masa që adresojnë zvogëlimin e varfërisë dhe fuqizimin ekonomik, sidomos për gratë në zonat rurale. Udhëzimi për përdorimin e fondit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për Skemat Kombëtare parashikon 5 pikë (bonus) për aplikantet gra për Skemat e Investimeve. Lidhur me Skemat Kombëtare, Programi për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2018 janë realizuar disa masa, si: i) mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20 milion lekë – nga e cila kanë përfituar 5 aplikuese gra; ii) mbështetje për ngritjen e inkubatorëve të prodhimit të produkteve tradicionale të zonës, në 70% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë 15milion lekë kundrejt planit të biznesit - nga e cila kanë përfituar 5 aplikuese gra; iii) mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari për turizmin rural nga 6 deri 10 dhoma, në 50% të vlerës të faturave tatimore por jo më shumë se një milion e pesëqind mijë lekë – nga e cila kanë përfituar 5 aplikuese gra.

176. Për vitin 2016 janë ofruar shërbime ekstensioni për 7100 fermere gra (11%). Për fondin e programit të bujqësisë dhe zhvillimin rural kanë aplikuar 2,650 fermere/fermerë, nga të cilat kanë përfituar 479 gra (18%).Për vitin 2017, janë ofruar shërbime ekstensioni për 7300 gra fermere, (11%). Për fondin e programit të bujqësisë dhe zhvillimin rural kanë aplikuar 999 fermere/fermerë, nga të cilat kanë përfituar 159 gra fermere (16%). Për vitin 2018 janë ofruar shërbime ekstensioni për 7300 fermere (11%). Numri i aplikueseve gra në Skemat Kombëtare të Mbështetjes për vitin 2018 është 779 gra, të ndara 734 gra në skemat direkte dhe 45 gra në skemat e investimeve. Numri i përfitueseve gra në këto skema është 627 gra, të ndara në 607 gra në skema direkte dhe 20 gra në skemat e investimeve. Për vitin 2019, nga skemat e

[64] VKM-ja nr. 115, datë 17.2.2016.

[65] Shih aneksin mbi aktivitetet e zhvilluara në kuadër të fuqizimit ekonomik.

subvencioneve Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ka shpallur fitues 4009 aplikantë nga të cilët 571 gra (19%). Buxheti i disbursuar për gratë fermere për vitin 2019 është afërsisht 99 milion lekë. Strukturat e ekstensionit në 4 Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, kanë kontaktuar dhe ju kanë ofruar akses në informacion rreth 70,000 fermerëve nga të cilat 7,000 gra (ose 10%).

Neni 15

Gratë e moshuara

177. Në vijim të rekomandimit të dhënë pasi u analizuan ligjet sektoriale që rregullojnë çështjet e moshës së tretë (ligji për asistencën sociale, strehimin social, shërbimet e përkujdesjes shoqërore, etj.), si dhe reformat e deritanishme që i kushtojnë vëmendje kësaj kategorie (përfshirja sociale, reforma e pensioneve, reforma shëndetësore, etj), është dakordësuar që bërja e një ligji të veçantë për moshën e tretë është i panevojshëm.

178. Është miratuar dokumenti politik kombëtar për moshimin, shoqëruar me plani e veprimit për periudhën 2020-2024 (VKM 864/2019). Ai trajton të drejtat e të moshuarave/moshuarve për shërbime shoqërore dhe shëndetsore, në përputhje me nevojat e tyre; përafrimin e shërbimit te klienti; garantimin e të drejtës së përfitimit dhe të zgjedhjes së alternativës së shërbimit; ofrimin e shërbimeve multidisiplinare, me synim ri/integrimin dhe/ose përmirësimin e cilësisë së jetës së të moshuarave/moshuarve; shpërndarjen e përgjegjësive ndërmjet aktorëve të ndryshëm të shoqërisë; fuqizimin e bashkive për të realizuar përgjegjësitë e tyre; etj.

179. Gjatë vitit 2018, struktura e pensioneve urbane dhe rurale sipas llojit të pensionit është pothuajse e njëjtë. Mesatarisht, 78% e pensioneve urbane janë pensione të pleqërisë (gjithsej 394,744 persona, nga të cilët 190,663 gra); 13% pensione invaliditeti (63,045 persona nga të cilët 26,033 gra); dhe 9% pensione familjare (46,861 persona, nga të cilët 22,615 gra). Mesatarisht 89% e pensioneve rurale janë pensione të pleqërisë (113,763 persona nga të cilët 75,949 gra), 6% pensione invaliditeti (7,129 persona nga të cilët 3,171 gra) dhe 5 % pensione familjare (6,192 persona nga të cilët 3,082 gra). Në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 vlera e pensionit mesatar mujor urban u rrit me 2.2% (pra nga 15,527 lekë në 15,875 lekë) dhe vlera e pensionit mesatar mujor rural u ul me 0.1% (nga 8,808 lekë në 8,792 lekë)

180. Nga përfituesit(et) e pensioneve urbane, në vitin 2019, 47,1% janë gra. Raporti gjinor për përfituesit e pensioneve rurale ndryshon ndjeshëm, me 66,4% të të siguruarve që janë gra. Mosha mesatare e daljes në pension është 65.1 vjeç për burrat dhe 61 vjeç për gratë, ndërsa për nënat me shumë fëmijë është 55.8 vjeç. Në këtë vit, numri i kontribuesve vullnetarë arrin në 5,453 persona të siguruar, ndër të cilët 63,3 % janë gra.

181. Pensioni Social është një përfitim që i jepet çdo shtetaseje/shtetasi shqiptare e/i cili: i)ka mbushur moshën 70 vjeç; ii)është me qëndrim të përhershëm në Shqipëri të paktën për pesë vitet e fundit; iii) nuk plotëson kushtet për asnjë lloj pensioni nga skema e detyrueshme; dhe iv) nuk ka të ardhura, ose të ardhurat që përfiton nga çdo burim tjetër, janë më të ulëta se të ardhurat që jep pensioni social. Pensioni social është një shumë bazë minimale dhe nga 6,750 lekë/muaj në vitin 2015 është rritur 7,283 lekë/muaj në 2018. Bëjnë përjashtim individët me të ardhura të pjesshme nga pronësia, interesa bankare, aksione, etj. Në këto raste, shuma e pensionit social që jepet është më e vogël se 7,262 lekë/muaj. Zbritja është në varësi të të ardhurave. Sipas të dhënave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që nga hyrja në fuqi e këtij ligji (2015) janë rreth 2,173 gra që përfitojnë pension social.

Gratë rome dhe egjiptiane

182. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016 – 2020, synon rritjen e aksesit në shërbimet publike nëpërmjet heqjes së vazhdueshme të barrierave për dy komunitetet në shëndetësi arsimim më të plotë, punësim, etj. dhe integrimit, të plotë të tyre. Rritja e numrit të romëve dhe egjiptianëve që përdorin shërbimet bazë shëndetësore; më shumë djem dhe vajza rome dhe egjiptiane që përfundojnë të gjitha nivelet e arsimit; më shumë familje rome dhe egjiptiane të përfshira në programet e strehimit direkt dhe indirekt; përmirësimi i

përfshirjes së anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian në programet e mbrojtjes sociale, etj., janë disa nga objektivat kryesore të këtij plani veprimi.

183. MSHMS-ja po zbaton Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016 – 2020, një dokument kompleks për zgjidhjen e çështjeve të mprehta të minoritetit Rom dhe Egjiptian. Plani përcakton qëllimet strategjike sipas fushave të regjistrimit civil, edukimit dhe promovimit të dialogut ndërkulturor, punësimit dhe arsimit profesional, kujdesit shëndetësor, strehimit, integrimit urban dhe mbrojtjes sociale.

184. Në kuadër të programit kombëtar të Kujdesit Shëndetësor në Komunitet miratuar në vitin 2018, MSHMS ofroi shërbimin e dedikuar, pa pagesë për gratë rome dhe egjiptiane, të cilat përfituan falas ekografitë obstetrikale dhe gjinekologjike, pap test, vizita dhe të gjitha shërbimet e nevojshme. Qëllimi i nismës ishte përmirësimi i cilësisë së jetës për çdo grua, me fokus të veçantë te gratë e margjinalizuara, për marrjen e shërbimeve shëndetësore në kohë dhe me cilësi. Shërbimet gjinekologjike pranë Maternitetit "Mbretëresha Geraldinë" për gratë rome, egjiptiane dhe gratë në nevojë ofrohen në një orar të dedikuar.

185. Në VKM nr. 101/2015 "Për miratimin e paketës së shërbimeve shëndetësore, në kujdesin shëndetësor parësor publik, që financohet nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor", theksohet se grave rome dhe egjiptiane u duhet kushtuar vëmendje e veçantë në identifikim, ndjekje dhe këshillim sipas një plani individual vizitash kontrolli dhe ndjekje nga personeli shëndetësor së bashku me specialisten/specialistin obstetër të konsultorit të gruas, apo të maternitetit në mungesë të tij.

186. Nga sistemi RomAlb rezulton se sigurimi i paketave të kujdesit për foshnjat dhe nënat për nënat rome dhe egjiptiane që lindin në një spital u zbatua me sukses, me rritje të numrit të nënave nga 1,961 në 2016 në 2,059 në 2017, 7,753 në 2018 dhe 11,797 në 2019.

187. Janë informuar mbi çështjet e shëndetit fizik, mendor dhe riprodhues, STDs, imunizimi i fëmijëve 0–14, përdorimi i drogës etj., 4,605 romë dhe egjiptianë në vitin 2016 (2,775 gra);

10,258 romë dhe egjiptianë në vitin 2017 (5,285 gra); 16,650 romë dhe egjiptianë në vitin 2018 (9,877 gra) dhe 30,003 romë dhe egjiptianë në vitin 2019 (17,850 gra).

188. Gratë rome dhe egjiptiane përfituese të Ndihmës Ekonomike janë përfshirë në programet e riintegrimit. Për vitin 2016 kanë përfituar 112 romë dhe egjiptianë (89 gra), për vitin 2017 kanë përfituar 554 romë dhe egjiptianë (295 gra), për vitin 2018 kanë përfituar 729 romë dhe egjiptianë (336 gra) dhe për vitin 2019 kanë përfituar 1,785 romë dhe egjiptianë (846 gra).

189. Nga programi i mbrojtjes sociale kanë përfituar 4 viktima të trafikimit rome dhe egjiptiane në vitin 2016, 2 viktima të trafikimit rome dhe egjiptiane në vitin 2017, 1 viktimë e trafikimit në vitin 2018 dhe 3 viktima të trafikimit rome dhe egjiptiane në vitin 2019. Pranë Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, kanë marrë shërbim 9 egjiptianë (4 gra, 5 fëmijë) dhe 4 romë (2 gra, 2 femijë) për vitin 2016, 3 egjiptianë të mitur të pashoqëruar dhe 2 romë (1 grua,1 fëmijë) për vitin 2017, 11 romë (4 gra, 7 fëmijë) për vitin 2018, 11 romë (3 gra, 8 fëmijë) dhe 2 egjiptianë (1 grua, 1 fëmijë) për vitin 2019 dhe 4 romë (1 grua, 3 fëmijë) për vitin 2020.

Gratë me AK

190. Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016 – 2020, është hartuar në përputhje të plotë me parimet themelore të Konventës Ndërkombëtare për të drejtat e Personave me AK dhe Strategjinë e Bashkimit Evropian për Personat me AK, në kuadër të procesit të integrimit të Shqipërisë. Aksesueshmëria për shërbime dhe informacion; aksesi në sistemin e drejtësisë, pjesëmarrja në tregun e punës, arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës, kujdes shëndetësor i aksesueshëm, i përballueshëm dhe i barabartë, pjesëmarrja në jetën publike dhe politike, shërbimeve/përfitimeve të aksesueshme, të përballueshme financiarisht, etj., janë disa nga qëllimet strategjike të parashikuara në këtë plan veprimi, përfshirë dhe për gratë me AK. Është në proces hartimi i Planit Kombëtar vijues. Nga numri i përgjithshëm 55,235 PAK, 22,407 janë gra/vajza me AK.

191. Të regjistruar në zyrat e punësimit, si punëkërkuese/punëkërkues të papunë janë 542 PAK (281 gra) në vitin 2019 (krahasuar me 518 në 2018). Punësimi i grave me AK është shumë i vështirë, por ato janë pjesëmarrëse në proceset konsultuese, hartim politikash e legjislacioni, në tryeza ndërministrore e seanca dëgjimore në Parlament.

Gratë në emigracion

192. Gjatë punës së strukturave të Ministrisë së Brendshme janë respektuar gjithmonë të gjitha parimet ndërkombëtare në trajtimin e grave migrante, për mosdiskriminimin, barazisë së burrit dhe të gruas, bashkimit familjar dhe parimin e *Non-refoulement*.

193. Kuadri ligjor i viteve të fundit është harmonizuar me legjislacionin e BE dhe synon ndërtimin e një politike migratore sa më të fortë dhe koherente. Aktet normative janë përmirësuar në aspektin e procedurave, dokumenteve të udhëtimit, vizave, punësimit, qëndrimit, bashkimit familjar, mbrojtjes së të drejtave të të gjithë migrantëve dhe familjeve të tyre, me fokus të veçantë te respektimi i parimeve ndërkombëtare në trajtimin e grave migrante.

194. Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i saj i Veprimit 2019 – 2022 (miratuar me VKM 400/2019), synon rritjen e ndërgjegjësimit të migrantëve për të drejtat e tyre dhe lehtësimin e aksesit në forma të ndryshme të mbështetjes/shërbimeve. Vëmendje e veçantë i kushtohet reduktimit të pengesave për gëzimin efektiv të të drejtave për emigrantet gra. Disa nga masat synojnë: hartimin brenda vitit 2020, të një plani të i ri emergjence (kontigjence) që Shqipëria të menaxhojë flukset e përziera, duke marrë parasysh vulnerabilitetet e popullatave në lëvizje (të mitur të pashoqëruar, viktima trafikimi, azil kërkues, individë me aftësi të kufizuara etj.),; përmirësimin e infrastrukturës në pikat e kalimit kufitar për të përmbushur siç duhet nevojat specifike të migrantëve (fëmijë, të moshuar, persona me aftësi të kufizuara etj.); trajnimin e punonjësve të kufirit për identifikimin e kategorive vulnerabël në rastet e flukseve të përziera masive; zhvillimin e procedurave standarde të qarta për kthimin vullnetar të asistuar, përfshirë për kategoritë vulnerabël; promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të migrantëve; inkurajimin e pjesëmarrjes së grave në policinë kufitare, etj.

195. Gjatë vitit 2019, 11,890 imigrantë të parregullt (2,790 gra) janë kapur dhe trajtuar në vendin tonë, duke shënuar një rritje krahasuar me vitin e kaluar, kur janë kapur dhe trajtuar 6,893 imigrantë me qëndrim të parregullt (404 gra).

196. Gjatë vitit 2015, të huaj me leje qëndrimi në Shqipëri ishin 10,563 persona (3,877 gra), gjatë vitit 2016 ishin 12,519 persona (4,195 gra), gjatë vitit 2017 ishin 12,906 persona (4,511 gra), gjatë vitit 2018 ishin 14,162 persona (4,959 gra) gjatë vitit 2019 ishin 13,507 persona (5,001 gra)66.

197. Gjatë vitit 2015, numri i aplikimeve të shtetasve shqiptarë të cilët kanë kërkuar azil ishte 67,100 aplikime[67], gjatë vitit 2016 ishte 29,645 aplikime, gjatë vitit 2017 ishte 22,735 aplikime, gjatë vitit 2018 ishte 19,825 aplikime, gjatë viti 2019 ishin 20,740 aplikime.

Gratë LBTI

198. Policia e Shtetit ka përmirësuar sistemin kompjuterik të përpunimit të të dhënave statistikore mbi krimet e urrejtjes, ku për çdo vepër të Kodit Penal, gjenerohet e dhëna e motivit për shkak të orientimit seksual.

199. Për vitet 2016 dhe 2017 nuk janë evidentuar raste, për vitin 2018 janë 6 raste, për vitin 2019 janë 7 raste dhe për vitin 2020 nuk ka pasur raste të regjistruara për krimin me bazë urrejtjen, për shkak të orientimit seksual.

200. Policia e Shtetit dhe Akademia e Policisë kanë rifreskuar modulet e trajnimit68 për punonjësit e policisë mbi çështjet LGBTI.

Gratë në qendrat e vuajtjes së dënimit

---

[66]http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/migracioni-dhe-integrimi-i-migrant%C3%ABve/#tab2.

[67] https://easo.europa.eu/sites/default/files/Statistical-tables-2.pdf.

[68] Mbështetur nga Këshilli i Evropës.

201. Në Planin e Veprimit për Sistemin e Burgjeve 2019 – 2021 janë përfshirë masa konkrete mbi programet dhe aktivitetet rehabilituese për gratë e dënuara/të paraburgosura dhe trajnimin e stafit.

202. Për përmirësimin e trajtimit të grave në institucionet penale, ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe rritjen e aktiviteteve me karakter rehabilitues dhe riintegrues, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 8 OJF që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut, me fokus gratë e privuara nga liria. Ato ofrojnë shërbime psikologjike, ligjore dhe mjekësore, aktiviteteve ndërgjegjësuese me gratë e burgosura, etj. Janë zbatuar projekte69 me fokus kryesisht riintegrimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të grave të paraburgosura dhe të dënuara për vepra të dhunës në familje.

203. Ofrohen programe trajtimi[70] për autorët e krimeve, me qëllim parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave. Në Institucionin për të mitur Kavajë prej tetorit 2017 po zhvillohet kursi i pirografisë[71], që synon të zhvillojë te gratë kulturën dhe aftësitë për punë artizanale. Gjatë vitit 2019 për herë të parë është hapur *website* '*Made in Prison*'[72], ku shiten produktet e punimeve artizanale të bëra nga gratë e dënuara dhe të paraburgosura.

204. Gratë e dënuara dhe të paraburgosura janë akomoduar në një Institucion të veçantë dhe mbahen nën mbikëqyrjen dhe kujdesin vetëm të personelit gra. Të dhënat statistikore për periudhën korrik 2016 – maj 2020:

Mesatarja e grave në institucionet penale gjatë vitit 2016 – maj 2020			
Vitet	**Të dënuara**	**Të paraburgosura**	**Gjithsej**
2016	56	47	103
2017	48	41	89
2018	63	39	102
2019	60	31	91
Maj 2020	30	19	49

205. Trajtimi i grave të dënuara dhe të paraburgosura bëhet në përshtatje me kapacitetin, arsimin, gjendjen social-ekonomike, prirjet dhe aftësitë që ato kanë. Stafi i IEVP-ve mundëson përkrahjen morale, kualifikimin profesional, arsimimin, edukimin, zhvillimin e aftësive shoqërore, këshillimin, pjesëmarrjen në aktivitete të përbashkëta dhe nxitjen e kontakteve me jashtë, në mënyrë që të zgjerohet perspektiva e riintegrimit shoqëror pas lirimit.

206. Personeli i kujdesit social bën vlerësimin e nevojave psikologjike e sociale, aftësitë dhe motivimin për punë e formim profesional dhe harton planin e vuajtjes së dënimit për çdo të burgosur dhe programin e individualizuar të trajtimit për grupe të veçanta, i cili përgatitet nga një grup specialistesh/specialistësh, i përbërë nga psikologe/psikologë, punonjëse/punonjës socialë dhe edukatore/edukatorë. Plani i dënimit përfshin këshillim, terapi, edukim, arsimim, formim profesional, punësim, shërbim bibliotekar, si dhe çdo shërbim tjetër të nevojshëm.

207. Përmes Terapisë së Sjelljes Konjitive që synon të ulë recidivizmin punohet me të gjitha gratë e burgosura për t'u dhënë mundësi të ndërtojnë aftësi dhe qëndrime prosociale, duke pakësuar sjelljet e natyrës penale; organizimit të kurseve profesionale73 në kujdestari fëmijësh, sekretari, parukeri dhe rrobaqepësi; punësimit brenda burgut; përfshirjes në terapinë e artit

[69] Me mbështetjen e Agjencive të Kombeve të Bashkuara apo Delegacionit të Bashkimit Evropian.

[70] Në bashkëpunim me "Linjën e Këshillimit për Burra dhe Djem".

[71] Në bashkëpunim me CARITAS-in Shqiptar.

[72] Kjo nismë është zbatuar në kuadër të një projekti të Organizatës 'Orkidea", financuar nga Ambasada Amerikane.

[73] Mesatarisht 70 gra të burgosura ndjekin kurset profesionale gjatë një muaji. Kurset përzgjidhen sipas kërkesave dhe aftësive të grave.

përmes pikturës, pirografisë, art-craft etj.; përfshirjes në aktivitete edukative, kulturore, sportive e fetare.

208. Ekzaminimi psikologjik dhe terapitë e ndërhyrjes me medikamente antipsikotike zhvillohen rregullisht për gratë e dënuara/të paraburgosura me probleme të shëndetit mendor, të cilat ndiqen nga mjekët psikiatër të spitalit të burgjeve. Ato trajtohen në një Seksion të Kujdesit të Veçantë në përputhje me kërkesat e ligjit për Shëndetin Mendor dhe protokollet e miratuara nga MSHMS për trajtimin personave me çrregullime të shëndetit mendor. Aktualisht trajtohen 3 gra me diagnoza të ndryshme të shëndetit mendor.

209. Për të gjitha gratë në prag lirimi, 6 muaj para lirimit hartohet programi prag-lirimi. Në tetor 2017 është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me bashkinë e Tiranës, për forcimin e rrjeteve mbështetëse për riintegrim në komunitet të të burgosurve, përmes mbështetjes së ndërsjellë të nismave për projekte të ndryshme sociale në ndihmë të kategorive në nevojë në sistemin e burgjeve, përfshirë edhe të miturit në konflikt me ligjin. Është iniciuar një proces koordinimi edhe me bashkitë e tjera për të ofruar shërbime konkrete riintegrimi për gratë (dhe të dënuarit e tjerë) që priten të rikthehen në jetën e lirë.

210. Kujdes i veçantë i kushtohet ruajtjes, përmirësimit ose rivendosjes së lidhjeve të grave dënuarave me familjen. Për gratë që kanë fëmijë të mitur, zhvillohet një program i posaçëm dhe favorizues për lidhjet me familjen, i quajtur "Prindërimi në distancë". Gratë mund të takohen me të afërmit e tyre 4 herë në muaj dhe në raste festash apo ngjarje të veçanta, lejohen takime shtesë dhe rritje të orarit të takimit. Të dënuarave u lejohet të mbajnë me vete fëmijët deri në moshën 3 vjeç. Institucioni krijon mundësinë që e dënuara të jetojë me fëmijën në seksionin e posaçëm të grave me fëmijë. Për kujdesin dhe asistencën ndaj këtyre fëmijëve funksionojnë edhe çerdhe të posaçme.

211. Në shtator 2016, DPB realizoi vlerësimin e nevojave të të burgosurve për forcimin e aksesit në arsim dhe formim profesional. Në vlerësim u përfshinë 70 të burgosur ndër të cilët 20 të mitur dhe 10 gra të dënuara. Përfundimet u adresuan në takime pune me përfaqësues të institucioneve shtetërore që mbulojnë çështjet respektive.

212. Rekomandimet e Këshillit të Evropës për Sistemin e Burgjeve janë përkthyer në gjuhën shqipe me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

213. Çështjet gjinore dhe të riintegrimit të grave të dënuara janë pjesë e moduleve të trajnimit të stafit. Gjatë vitit 2019 janë trajnuar rreth 40 punonjës të disiplinave të ndryshme që punojnë me kategorinë e grave të dënuara/të paraburgosura.

214. Të gjithë personat e paraburgosur dhe të dënuar me burgim përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, dhe përfitojnë, pa pagesë, të gjitha shërbimet që ofron skema e sigurimit shëndetësor. Analizat laboratorike zhvillohen brenda 72 orëve për çdo të burgosur grua që hyn në sistemin e burgjeve. Analizat kryhen pranë laboratorit në spitalin e burgjeve.

215. Në vitin 2016 u kryen 27 mamografi dhe 27 pap test, në vitin 2018 u kryen 40 *check-up*, 32 Mamografi dhe 50 pap test dhe gjatë vitit 2019 janë kryer 15 mamografi për gra të dënuara dhe të paraburgosura. Për të gjitha ekzaminimet mjekësore janë zhvilluar sesione informuese në bashkëpunim me MSHMS[74]. Gjatë periudhës 2018 – 2019 janë realizuar ekzaminime vullnetare për Hepatit B, C, HIV/AIDS për 24 gra në vitin 2018 dhe 14 gra në vitin 2019.

Gratë azilkërkuese

216. Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë merr masa që azilkërkueses/azilkërkuesit t'i sigurojë përfaqësim ligjor falas dhe përkthyes në gjuhën që ai/ajo kupton dhe regjistron të gjitha të dhënat për çdo rast që kërkon azil në Shqipëri.

217. Azilkërkuesja/Azilkërkuesi ka të drejtë të qëndrojë në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkues (QKPA) gjatë kohëzgjatjes së procedurës për dhënien e statusit të refugjatit/mbrojtjes ndërkombëtare. Nëse i është refuzuar aplikimi për azil i lejohet të qëndrojë në territor apo të akomodohet në qendër derisa të mbarojnë procedurat e ankimit apo afatet për

[74] Dhe organizatën *Stop Aids*.

ushtrimin e tyre. Në qoftë se azilkërkuesja/azilkërkuesi ka mundësi të qëndrojë jashtë qendrës pritëse dhe përballon kushtet minimale të jetesës, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët vendos largimin e saj/tij brenda 30 ditëve nga Qendra. Azilkërkueset/Azilkërkuesit pajisen me leje qëndrimi dhe kartë shëndeti. Drejtoria vendos në mënyrë konsensuale dhe kolegjiale me shumicë të votave dhe vendimi paraqitet në formë të shkruar të arsyetuar.

218. Azilkërkuesja/Azilkërkuesi ka të drejtë të qëndrojë në territorin e RSH deri në përfundimin e procedurës së filluar prej saj/tij, gjithashtu dhe anëtarët e familjes së azilkërkueses/azilkërkuesit, të cilët kanë ardhur në Shqipëri së bashku me të, kanë të drejtë të qëndrojnë. Azilkërkueses/Azilkërkuesit i garantohet e drejta e moskthimit, e drejta e strehimit, e ushqimit, e kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve të tjera publike për nevoja ngushtësisht vetjake, të ofruara në QKPA. Azilkërkueset/Azilkërkuesit e mitur akomodohen së bashku me prindërit e tyre ose pjesëtarët madhorë të familjes, përgjegjës për ato/ata.

219. QKPA është institucion ku akomodohen dhe trajtohen persona të huaj apo pa shtetësi që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në Shqipëri. Aty sigurohen nevojat jetike bazë, ofrohet kujdes shëndetësor në qendra shëndetësore shtetërore ose private, trajtim psikologjik dhe konsulencë juridike nga specialistët e fushës. Të gjitha apartamentet janë të pajisura me dushe dhe tualete, ujë i ngrohtë 24/24, sistem ngrohje–ftohje, *wi-fi*, menu ushqimore sipas nevojave (p.sh për diabetikët), etj. Drejtuesi i Qendrës merr të gjitha masat bashkë me Sektorin e Mbështetjes së Azilkërkuesve të shoqërojë dhe të lehtësojë aksesin e azilkërkueseve/azilkërkuesve pranë strukturave përkatëse shëndetësore.

220. QKPA ofron edhe shërbime sociale-integruese, asistencë psikosociale, respektim të diversiteteve (racore, etnike, fetare, kulturore, etj.), organizim të aktiviteteve e udhëtimeve të ndryshme dhe mbulon të gjitha shpenzimet e arsimimit të tyre. Sigurinë fizike, e ofron nëpërmjet kamerave, që rrethojnë të gjithë ambientet dhe janë funksionale 24 orë/ditë. Qendra ruhet nga shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike.

221. Qendra ofron shpërndarje të detergjenteve apo materialeve të ndryshme për përdorim vetjak. Në mënyrë periodike bëhet dezinfektimi i ambienteve të përbashkëta (mensa, biblioteka, sallë interneti, salla e lojërave për fëmijë, territori i qendrës), pastrimi dhe higjienizimi i gjithë territorit. Në shërbim të azilkërkueseve/azilkërkuesve është dhe lavanteria, salla e internetit, përdorimi i bibliotekës dhe dhoma e lodrave për fëmijë.

222. Për vitin 2017 janë akomoduar 21 gra/vajza, për vitin 2018, 246 gra/vajza, për vitin 2019, 829 gra/vajza, dhe për janar-prill 2020 janë akomoduar 295 gra/vajza në QKPA. Qendra ka marrëdhënie të mira bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare që punojnë për azilkërkuesit dhe refugjatët75

Neni 16
Bashkëpronësi për të dy bashkëshortët

223. Ligji 110/2018 për noterinë ka sjellë risi në çështjet e rregullimit të barazisë gjinore në aspektin e mbrojtjes së pasurive të grave dhe vajzave. Aktet noteriale që përmbajnë kalimin e pasurive të paluajtshme, duhet të përmbajnë detyrimisht edhe deklarimin e regjimit pasuror martesor, duke cilësuar shprehimisht prezumimin e bashkëpronësisë ligjore, në rastet kur pasuria është e fituar përgjatë martesës dhe kur bashkëshortët nuk kanë përcaktuar me kontratë regjimin e pasurive të ndara. Dëshmia e trashëgimisë nuk mund të cenojë pjesën e bashkëshortes/bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës. Noterja/noteri(ja) duhet detyrimisht t'i bashkëlidhë aktit përkatës certifikatën martesore të bashkëshortes/bashkëshortit pasjetues.

224. Në rastet e tjetërsimit ose njohjes së pronësisë mbi sendet e paluajtshme ose të drejtave reale mbi to për personat fizikë, noterja/noteri i bashkëngjit aktit përkatës noterial certifikatën familjare dhe/ose martesore të palës blerëse dhe bën përshkrimin/shënimin përkatës në kontratë,

---

[75] UNHCR, RMSA, Kryqi i Kuq, Caritas, etj.

duke cituar si blerës/bashkëpronar bashkëshorten/bashkëshorten jo prezent, *ipso jure*, për shkak të fitimit të të drejtave të pronësisë gjatë martesës, në regjimin pasuror martesor në bashkësi.

225. Kur noteri/noteri konstaton se pasuria e paluajtshme e përfituar përgjatë martesës, për të cilën kërkohet të kryhet akti noterial për tjetërsimin ose njohjen e pronësisë mbi sendet e paluajtshme, ose të drejtave reale mbi to, figuron e regjistruar vetëm në emrin e njërit prej bashkëshortëve dhe bashkëshortja/bashkëshorti i prezumuar bashkëpronar ka ndërruar jetë, noterja/noteri kërkon lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë dhe regjistrimin e trashëgimtarëve në certifikatën e pronësisë së pasurisë për të cilën kërkohet të kryhet tjetërsimi ose njohja e pronësisë.

Martesa e fëmijëve

226. Informacioni është dhënë te neni 5 paragrafi 75, 76.

Gratë dhe vajzat e ngujuara

227. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit, ka hartuar Planin e Veprimit 2057/2018 për parandalimin, zbulimin, dokumentimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale ndaj veprave penale të vrasjeve të kryera për motive të gjakmarrjes dhe hakmarrjes76. Është ngritur Shtabi i drejtimit kundër këtyre krimeve, i cili ka për detyrë të drejtojë, kontrollojë dhe koordinojë të gjithë veprimtarinë e strukturave vartëse për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në këtë drejtim.

228. Në vendin tonë ka 75 familje me 159 persona të ngujuar (me vetëkufizim lirie), nga të cilët 25 fëmijë. Nga këto 15 familje me 56 persona janë larguar jashtë shtetit. Gratë nuk janë subjekte të vetëkufizimit të lirisë (ngujimit) për shkak të gjakmarrjes, por ato vuajnë pasojat e ngujimit të familjareve të tyre burra/djem.

Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim

229. Në të gjitha veprimet e përshkruara më sipër në zbatim të rekomandimeve të CEDAW, Shqipëria merr në konsideratë edhe Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit, duke i reflektuar fushat kryesore të saj në politikat, strategjitë dhe planet kombëtare të veprimit.

Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm

230. Parlamenti në dhjetor 2017 miratoi një rezolutë që angazhohej për promovimin, zbatimin dhe monitorimin e agjendës 2030 dhe OZHQ-ve, nëpërmjet proceseve zhvillimore gjithëpërfshirëse, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të Shqipërisë dhe integrimin në BE. Një Raport Vullnetar Kombëtar (VNR) iu paraqit Forumit Politik të Nivelit të Lartë të OKB-së për Zhvillim të Qëndrueshëm në korrik 2018, ndërsa përgatitja e një analize buxhetore për koston e zbatimit të OZHQ-ve dhe një vlerësim i nevojave të INSTAT është në proces77.

231. Mbështetja e Agjencive të OKB-së për zbatimin kombëtar të Agjendës 2030 ka filluar që gjatë përgatitjes së SKZHI II (2015 – 2020), si dhe në pilotimin e treguesve të qeverisjes në Shqipëri për OZHQ 16. Duke punuar me INSTAT, UNCT ka zhvilluar mjete dhe studime për hartimin e të dhënave zyrtare përkundrejt raportimit të treguesve të OZHQ-ve. Në vitin 2016 u krijua një grup i përbashkët i të dhënave të KB-INSTAT dhe në vitin 2017 u krijua një Task-Forcë e Qeverisë së Shqipërisë dhe KB-së për OZHQ-të, për të mbështetur përgatitjen e Raportit Vullnetar Kombëtar, ndërgjegjësimin e publikut dhe advokimin mbi OZHQ-të dhe agjendën 2030, si dhe për hartimin e metodologjisë së parashikimit të kostove për arritjet kombëtare të OZHQ-ve. Përpjekjet informuese të agjencive të KB-së sollën si rezultat edhe nënshkrimin e një

---

[76] Objekti i këtij Plani Veprimi është: Goditja e fenomenit të gjakmarrjes dhe hakmarrjes duke bashkëpunuar ngushtë me pushtetin vendor dhe organizatat jo fitimprurëse për zgjidhjen me pajtim të konflikteve; Forcimi i bashkëpunimit me organin e prokurorisë për hetimin e shpejtë të këtyre veprave penale dhe vënien para drejtësisë të autorëve të tyre; Organizimi i masave të gjithanshme për kapjen e autorëve të vrasjeve në tërësi dhe të atyre për gjakmarrje në veçanti si një masë e madhe parandaluese për vazhdimin e gjakmarrjes; Forcimi i bashkëpunimit me drejtoritë arsimore e shkollat për edukimin e brezit të ri me frymën e tolerancës dhe parandalimin e krimit.

[77] INSTAT Ka inventarizuar indikatorët lidhur me SDG; ka ndërtuar dashboardin e SDG (bashkëpunim me UNDP) ka përgatitur 2 publikime; ka shfrytëzuar burimet e brendshme (vrojtimet ekzistuese) duke shtuar module të reja për matjen e indikatorëve shtesë të SDG, etj.

deklarate të angazhimit në mbështetje të zbatimit të OZHQ-ve, nga rreth 25 universitete, në shtator 2017. Fondi i agjencive të KB-së për Përshpejtimin e OZHQ-ve për Shqipërinë u lançua në prill të vitit 2018, në mbështetje të zbatimit të agjendës kombëtare 2030.

Shpërndarja e Vëzhgimeve Përfundimtare

232. Vëzhgimet Përfundimtare të CEDAW janë marrë në konsideratë dhe u janë shpërndarë të gjitha institucioneve dhe OJF-ve për të koordinuar veprimet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në to.

Mbështetja Teknike

233. Qeveria shqiptare ka pasur dhe vijon të ketë një mbështetje të vazhdueshme teknike nga organizatat ndërkombëtare, sidomos agjencitë e OKB për zbatimin e CEDAW dhe të detyrimeve që rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtarë të ratifikuar.

234. Në vitin 2018, MEPJ me mbështetjen e UNFPA dhe UnWomen në Tiranë zbatoi projektin për monitorimin e konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Kjo platformë e integruar në faqen zyrtare të MEPJ-së shërben si një mekanizëm monitorimi për të ndjekur zbatimin e rekomandimeve në kuadrin e Konventës CEDAW dhe rekomandimet e Shqyrtimit Universal periodik (UPR). Gjithashtu, këto agjenci kanë mbështetur institucionet shqiptare me ekspertizë gjatë hartimit dhe shqyrtimit të Raportit kombëtar në kuadër të Mekanizmit Universal Periodik, gjatë vitit 2019. Një kontribut dhe mbështetje e rëndësishme është ofruar në kuadër të përgatitjes dhe konsultimit të këtij Raporti.

235. agjencitë e OKB-së në Tiranë kanë ofruar këto vite kontribut thelbësor në fusha prioritare që lidhen me zbatimin e Konventës si: mbështetje për zhvillimin dhe konsolidimin e kuadrit ligjor mbi të drejtat e grave dhe barazinë gjinore; forcimi i kapaciteteve kombëtare si buxhetimi gjinor, statistikat gjinore dhe dhunën ndaj grave.

Shtojcat pjesë përbërëse e Raportit

Tabela e përmbajtjes

Shtojca 1. Ndryshime ligjore …….....
Shtojca 1.1.1 Aktet nënligjore në zbatim të ligjeve…….....
Shtojca 1.1.2 Strategji të miratuara dhe planet e veprimit……....
Shtojca 2. Aktivitete trajnuese në kuadër të nxitjes së njohurive mbi Konventën dhe Protokollet e saj shtesë dhe mbi promovimin e barazisë gjinore……
Shtojca 2.1.1 Aktivitete trajnuese të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës……
Shtojca 2.1.2 Aktivitete trajnuese të zhvilluara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.....
Shtojca 2.1.3 Aktivitete trajnuese të zhvilluara nga Prokuroria e Përgjithshme.....
Shtojca 3. Të dhënat mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në lidhje me të drejtat e grave, duke përfshirë dhe ato për detyrimin për ushqim .....
Shtojca 4. Kuadri ligjor për barrën e provës në rastet e diskriminimit …. ……....
Shtojca 5. Të drejtat e viktimës së veprës penale.....
Shtojca 6. Kuadri ligjor kundër trafikimit të qenieve njerëzore ……..
Shtojca 7. Të dhënat në lidhje me hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin e trafikantëve të qenieve njerëzore.....
Shtojca 7.1.1 Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.....
Shtojca 7.1.2 Të dhënat nga Prokuroria e Përgjithshme .....
Shtojca 7.1.3 Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë .....
Shtojca 7.1.4 Të dhënat nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda .....
Shtojca 7.1.5 Të dhënat nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar .....
Shtojca 7.1.6 Të dhënat nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda .....
Shtojca 7.1.7 Të dhënat nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar .....

Shtojca 7.1.8 Të dhënat nga Gjykata e Lartë .....
Shtojca 8. Të dhëna mbi trajnimet në fushën e trafikimit .....
Shtojca 9. Të dhëna mbi punësimin ……

Shtojca 1. Ndryshime ligjore

Shtojca 1.1.1 Aktet nënligjore në zbatim të ligjeve

- Ligji nr. 47/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, 'Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare'".

- Udhëzimet e përbashkëta të ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

- nr. 912, datë 27.12.2018, "Për miratimin e modelit dhe procedurave për urdhrin për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme";

- nr. 866, datë 20.12.2018, "Për miratimin e modelit dhe të procedurave për vlerësimin e riskut për rastet e dhunës në familje", të cilat parashikojnë detyrime të posaçme për Policinë e Shtetit.

- Ligji nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"

- VKM-ja nr. 110, datë 6.3.2019, "Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre";

- VKM-ja nr. 55, datë 6.2.2019, "Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti";

- UKM-ja nr. 1, datë 6.3.2019, "Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave, 'Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor'";

- Udhëzimi nr. 1, datë 8.3.2019, i ministrit të Drejtësisë, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave";

- Udhëzimi nr. 2, datë 25.3.2019, i ministrit të Drejtësisë, "Për procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve";

- Udhëzimi nr. 6, datë 20.8.2019, i ministrit të Drejtësisë, "Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi në rastin e dhënies së ndihmës juridike";

- Vendim nr. 231, datë 12.11.2019, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, "Për miratimin e rregullores për rregullat e garantimit të mbrojtjes së detyrueshme dhe caktimin mbi bazë të parimit të rotacionit të avokatit mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në procesin penal";

- Urdhri nr. 225, datë 25.3.2019, i ministrit të Drejtësisë, "Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti";

- Urdhri nr. 226, datë 25.3.2019, i ministrit të Drejtësisë, "Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti";

- Urdhri nr. 59, datë 25.3.2019, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas".

- Ligji nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"

- VKM-ja nr. 54, datë 31.1.2018, "Për rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijës";

- VKM-ja nr. 91, datë 14.2.2018, "Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës";

- VKM-ja nr. 148, datë 13.3.2018, "Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit ndërmjet mekanizmave këshillimorë e koordinues institucionalë, strukturave për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës dhe organizatave jofitimprurëse, për realizimin e politikave kombëtare e vendore, si dhe për shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës";

- VKM-ja nr. 353, datë 12.6.2018, "Për rregullat e funksionimit të grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkive dhe njësive administrative";
- VKM-ja nr. 578, datë 3.10.2018, "Procedurat e referimit dhe të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimi i masave të mbrojtjes";
- VKM-ja nr. 129, datë 13.3.2019, "Procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, përfshirë fëmijët në situatë rruge";
- VKM-ja nr. 111, datë 6.3.2019, "Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës";
- Udhëzim nr. 651, datë 13.9.2019, "Për procedurat e raportimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje" (Udhëzim i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë).
- *Ligji nr. 15/2019, "Për promovimin e punësimit"*
- VKM-ja nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive";
- Urdhri i Kryeministrit nr. 172, datë 24.12.2019, "Për miratimin e strukturës dhe së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA)";
- VKM-ja nr. 17, datë 15.1.2020, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të promovimit të punësimit përmes punësimit, formimit dhe praktikave profesionale";
- VKM-ja nr. 348, datë 29.4.2020, "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të promovimit të punësimit, përmes vetëpunësimit".

Shtojca 1.1.2. Strategji të miratuara dhe planet e veprimit

- Strategjia e Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Plani i Veprimit 2014 – 2017;
- Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e saj të Veprimit 2016 – 2020;
- Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë, 2016 – 2020;
- Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (SKPA) 2014 – 2020;
- Strategjia për Edukimin Ligjor të Publikut 2019 – 2023;
- Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Planit të saj të Veprimit (2019 – 2022);
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020 (SKZHI);
- Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016 – 2020;
- Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë 2016 – 2020;
- Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara, qershor 2016;
- Plani i Veprimit për Riintegrimin Social – Ekonomik të Grave dhe Vajzave Viktima/Viktima të Mundshme të Trafikimit;
- Plani Kombëtar i Veprimit për "Luftën Kundër Trafikimit të Personave 2018 – 2020";
- Planit Kombëtar kundër Tumoreve 2011 – 2020;
- Plani i Veprimit për mbështetjen e gruas sipërmarrëse 2014 – 2020 ";
- Planit Kombëtar të Veprimit mbi personat LGBTI në Republikën e Shqipëri 2016-2020;
- Planit i Veprimit për Sistemin e Burgjeve për periudhën 2019 – 2021;
- Plani i Veprimit për zbatimin e mekanizmit të OKB-së të Rishikimit Periodik Universal të të Drejtave të Njeriut (UPR);
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017 – 2020;
- Dokumenti politik kombëtar për moshimin, shoqëruar me planin e veprimit për periudhën 2020 – 2024;
- Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale, 2016 – 2020;

Shtojca 2: Aktiviteteve trajnuese në kuadër të nxitjes së njohurive mbi Konventën dhe Protokollet e saj shtesë dhe mbi promovimin e barazisë gjinore

Shtojca 2.1.1 Aktivitete trajnuese të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës (periudha gusht 2016 – aktualisht)

29 – 30 shtator 2016	Retreat trajnuese: Hartimi i kurrikulave të reja mbi barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin dhe praktikat pozitive lidhur me vlerësimin e nevojave të gjyqtarëve dhe prokurorëve në çështjet e barazisë dhe mosdiskriminimit me bazë gjinore.	Vlorë Pjesëmarrës: 2 pedagogë të brendshëm të ShM, si edhe 10 staf administrative i ShM-së
24 tetor 2016	Zbatimi i drejtpërdrejtë i Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW). Roli i gjykatës dhe i sistemit të drejtësisë.	Trajnim rajonal Elbasan Hotel Skampini Pjesëmarrës: 3 gjyqtarë; 2 prokurorë; 1 OPGj; 4 inspektorë të KLD-së
25 tetor 2016	Zbatimi i drejtpërdrejtë i Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW). Roli i gjykatës dhe i sistemit të drejtësisë.	Trajnim rajonal Krujë Hotel Panorama Pjesëmarrës: 8 gjyqtare; 4 prokurore; 5 administrate; 5 inspektore
26-27 -28 tetor 2017	Standardet evropiane lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin – rëndësia e njohjes dhe zbatimit të tyre nga sistemi i drejtësisë. Terrenet e mbrojtura - Jurisprudenca e GjEDNj-së dhe GjED-së. Kuadri ligjor vendas dhe praktika gjyqësore lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin. Kuadri institucional lidhur me çështjet e barazisë dhe mosdiskriminimit	White Dream Hotel, Tiranë Pjesëmarrës 11 gjyqtarë
10 qershor 2019	Barazia gjinore dhe dhuna me bazë gjinore – me fokus ndryshimet ligjore, shërbimet ndaj viktimës dhe rehabilitimin/punën me dhunuesit.	Iliria Hotel Pjesëmarrës 10 kandidatë për magjistratë
19 shtator 2019	Teoria e gjinisë dhe salla e gjyqit: Nga përvojat personale deri në vendimet gjyqësore.	Hotel Hilton Tiranë Pjesëmarrës 11 gjyqtarë, 3 kandidatë për magjistrat, profili gjyqtar
20 shtator 2019	Teoria e gjinisë në sallën e gjyqit: Konteksti ndërkombëtar vs ligji dhe praktika shqiptare.	Hotel Hilton Tiranë Pjesëmarrës 12 Gjyqtarë, 3 kandidatë për magjistrat, profili gjyqtar
26 shtator 2019	Paragjykimi gjinor në sallën e gjyqit: Strategjitë individuale dhe organizative për të zvogëluar paragjykimin në vendimet gjyqësore.	Hotel Hilton, Tiranë Pjesëmarrës 10 gjyqtarë, 4 kandidatë për magjistrat profile gjyqtar
4 tetor 2019	Teoria e gjinisë në sallën e gjyqit: Vendimmarrja e bazuar në prova për çështjet e dhunës seksuale dhe të ngacmimit seksual.	Hotel Hilton Tiranë, Pjesëmarrës 7 gjyqtarë, 4 kandidatë për magjistrat profile gjyqtar
8 – 10 janar 2020	Zhvillimi i stafit akademik për çështjet gjinore	Hotel Hilton Tiranë, Pjesëmarrës 6 gjyqtarë, 2 kandidatë për magjistrat profile gjyqtar

29 korrik 2020	Teoritë gjinore dhe ngacmimet seksuale.	*Online* Pjesëmarrës 10 gjyqtare

Shtojca 2.1.2 Aktivitete trajnuese të zhvilluara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Gjatë vitit 2016:

- Në zbatim të urdhrit të drejtorit të Policisë së Shtetit nr. 599, datë 16.6.2016 "Për një shtesë në Planin e Trajnimeve të Policisë së Shtetit për vitin 2016", u zhvillua trajnimi "Dhuna në familje", ofruar nga Këshilli i Evropës, në datat 28 dhe 29 qershor 2016. Në këtë trajnim morën pjesë 25 punonjës policie.

- Gjatë vitit 2016, me mbështetjen e OSCE-së, u zhvilluan trajnime të punonjësve të policisë, për dhunën në familje, në drejtoritë vendore të policisë Tirane, Durrës, Korçë, Vlorë, Gjirokastër, Berat, Lezhë, Fier, Elbasan. Numri i pjesëmarrësve në çdo trajnim është 20 – 25 punonjës policie.

- Po gjatë vitit 2016, me mbështetjen e PNUD-it janë zhvilluar trajnime me temë: "Roli i Policisë së Shtetit në zbatim të ligjit 'Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare' dhe në mekanizmin e reagimit të koordinuar ndaj dhunës në familje". Ky trajnim u realizua me pjesëmarrjen e rreth 100 punonjësve të komisariateve të policisë Krujë, Sarandë, Burrel, Kavajë, Ersekë dhe Përmet.

Gjatë vitit 2018:

- Janë zhvilluar 3 sesione trajnimi 2-ditore "Për hetimin e krimeve seksuale", ku janë trajnuar 60 specialistë për dhunën në familje, të miturit dhe krimet seksuale, si dhe specialistë të krimeve në komisariatet e policisë.

Gjatë vitit 2019:

- Në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë dhe UNDP-në, si dhe bazuar në urdhrin nr. 1/646, datë 16.4.2019, "Për zhvillimin e trajnimeve për ndryshimet ligjore në adresimin e dhunës në familje", u organizuan dhe realizuan trajnime në 12 drejtoritë vendore të policisë, në të cilat morën pjesë rreth 320 punonjës të policie.

- Me mbështetjen e Programit Suedez të Policimit në Komunitet, u organizua trajnimi për njohjen dhe zbatimin e ndryshimeve ligjore në adresimin e dhunës në familje, ku u trajnuan rreth 37 punonjës policie të DVP Kukës (dhjetor 2019).

Gjatë vitit 2020:

- Me mbështetjen e Programit Suedez të Policimit në Komunitet, u organizua trajnimi për njohjen dhe zbatimin e ndryshimeve ligjore në adresimin e dhunës në familje, ku u trajnuan rreth 70 punonjës policie të DVP Elbasan. Janar 2020.

- Në mbështetje të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Policia e Shtetit ka hartuar Planin e Veprimit "Për integrimin e punonjëseve të policisë femra", në zbatim të të cilit janë zhvilluar trajnime për barazinë gjinore dhe nxitjen e njohurive mbi konventën dhe protokollet e saj mbi diskriminim ndaj grave dhe vajzave. Gjatë viteve 2016 – 2020 janë trajnuar 1507 gra dhe vajza në Policinë e Shtetit.

Trajnimet mbi barazinë gjinore dhe kundër diskriminimit janë mundësuar nga programet ICITAP, Këshilli i Evropës, OSBE, PAMECA V, UN WOMEN Albania, mbi "*Women Lidership*".

- Gjatë vitit 2020 janë realizuar me Këshillin e Evropës dhe OSBE takime dhe trajnime mbi promovimin gjinor për t'u njohur me kuadrin ligjor ndërkombëtar për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj Grave CEDAW, Konventa e Stambollit, Protokollin Shtesë të Konventës CEDAW, Konventat e ILO-s për Diskriminimin (Punësimi dhe vendi i punës).

- Janë trajnuar në Akademinë e Sigurisë 500 studentë për të njohur me Manualin Kundër Krimeve të Urrejtjes dhe të drejtat e komunitetit LGBTI.

- Në kuadër të barazisë gjinore dhe ndalimit të diskriminimit, Policia e Shtetit ka miratuar me urdhër të DPPSH-së nr. 96, datë 10.2.2015, "Politika mbi trajtimin e rasteve të ngacmimit dhe

ngacmimit seksual në Policinë e Shtetit". Aktualisht në kuadër të ndryshimeve ligjore është ngritur me urdhër të DPPSH-së nr.86, datë 24.1.2020, një grup pune për rishikimin e kësaj politike. Në zbatim të saj janë trajnuar 700 punonjës policie në qarqet Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Gjirokastër, Fier dhe Vlorë.

2.1.3 Aktivitete trajnuese të zhvilluara nga Prokuroria e Përgjithshme

Institucioni i Prokurorisë ka marrë pjesë në një sërë aktivitetesh ndërkombëtarë si: trajnime, vizita, konferenca, takime operative etj., duke u përfaqësuar me prokurorë, OPGJ dhe ndihmës ligjorë. Ndër këto aktivitete përmendim:

- Trajnimin me temë "Dhuna në familje", organizuar me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara Amerikës, zhvilluar më datë 7 – 11.11.2016, në Budapest;

- Trajnimi me temë "Mbi dhunën me bazë gjinore", organizuar nga Autoriteti Suedez Policor në bashkëpunim me Fondacionin Kvinna till Kvinna, zhvilluar më datë 12 – 22.11.2018, në Austri;

- Pjesëmarrës në Samitin Ndërkombëtar kundër "Trafikimit të personave, skllavërisë moderne, krimit të organizuar dhe shfrytëzimit për punë në Evropë", zhvilluar më datë 21 – 23.2.2018, në Londër;

- Pjesëmarrës në vizitën zyrtarë në Mbretërinë e Holandës, me qëllim njohjen e sfidave të krimit të organizuar, azil kërkimit dhe trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe bashkëpunimi i autoriteteve qendrore dhe lokale, zhvilluar më datë 7 – 8.2.2018, në Amsterdam, Roterdam, Hagë;

- Pjesëmarrës në trajnime e vizita studimore të zhvilluara jashtë vendit, në vitet 2016 dhe 2018, në Budapest ku kanë marrë pjesë 3 prokurorë të shkallëve të para; në Austri, ku ka marrë pjesë 1 prokurore e shkallës së parë; në Londër ku ka marrë pjesë 1 prokurore e shkallës së parë në Prokurorinë për Krime të Rënda; në Amsterdam, Roterdam dhe Hagë ku ka marrë pjesë 1 prokuror i Prokurorisë së Përgjithshme.

Shtojca 3. Të dhënat mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në lidhje me të drejtat e grave, duke përfshirë dhe ato për detyrimin për ushqim

- Për periudhën 1.7.2016 – 31.12.2016 rezulton një total çështjesh prej 6100 (gjashtëmijë e njëqind) çështje me objekt: "pensione ushqimore", 719 (shtatëqind e nëntëmbëdhjetë) çështje me objekt: "takim me fëmijë", dhe 4 (katër) çështje me objekt: "kujdestari fëmije". 5624 çështje "pensione ushqimore" janë në ekzekutim të vazhdueshëm, nga këto 1593 (njëmijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) çështje me objekt: "pensione ushqimore" nuk shlyhet detyrimi për pamundësi paguese nga ana e debitorit dhe veprimet procedurale përsëriten në mënyrë të vazhdueshme për verifikim të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të tij me qëllim ekzekutimin e detyrimit; për 219 (dyqind e nëntëmbëdhjetë) çështje detyrimi shlyhet pjesërisht dhe jo i plotë, gjithashtu për paaftësi paguese; 462 (katërqind e gjashtëdhjetë e dy) çështje janë ekzekutuar tërësisht dhe në zbatim të nenit 125, të ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, janë aplikuar 70 kallëzime penale për mosdhënie të mjeteve për jetesë ndaj debitorëve.

- Për periudhën 1.1.2017 – 31.12.2017 rezulton një total çështjesh prej 6132 (gjashtëmijë e njëqind e tridhjetë e dy) çështje me objekt: "pensione ushqimore"; 825 (tetëqind e njëzet e pesë) çështje me objekt: "takim me fëmijë"; dhe 12 (dymbëdhjetë) çështje me objekt: "Kujdestari fëmije". 6064 çështje "pensione ushqimore" janë në ekzekutim të vazhdueshëm, nga këto 1758 çështje, me objekt: "pensione ushqimore", nuk shlyhet detyrimi për pamundësi paguese nga ana e debitorit dhe veprimet procedurale përsëriten në mënyrë të vazhdueshme për verifikim të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të tij me qëllim ekzekutimin e detyrimit; për 231 çështje detyrimi shlyhet pjesërisht dhe jo i plotë, gjithashtu për paaftësi paguese; 65 çështje janë ekzekutuar tërësisht dhe në zbatim të nenit 125, të ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, janë aplikuar 80 kallëzime penale për mosdhënie të mjeteve për jetesë ndaj debitorëve.

- Për periudhën 1.1.2018 – 31.12.2018 rezulton një total çështjesh prej 6547 (gjashtëmijë e pesëqind e dyzet e shtatë) çështje me objekt: "pensione ushqimore"; 966 (nëntëqind e

gjashtëdhjetë e gjashtë) çështje me objekt: "takim me fëmijë"; dhe 11 (njëmbëdhjetë) çështje me objekt "kujdestari fëmije". 6477 çështje "pensione ushqimore" janë në ekzekutim të vazhdueshëm, nga këto, 2488 çështje me objekt: "pensione ushqimore" nuk shlyhet detyrimi për pamundësi paguese nga ana e debitorit dhe veprimet procedurale përsëriten në mënyrë të vazhdueshme për verifikim të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të tij, me qëllim ekzekutimin e detyrimit; për 215 çështje detyrimi shlyhet pjesërisht dhe jo i plotë, gjithashtu për paaftësi paguese; 49 çështje janë ekzekutuar tërësisht dhe në zbatim të nenit 125, të ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, janë aplikuar 65 kallëzime penale për mosdhënie të mjeteve për jetesë ndaj debitorëve.

- Për periudhën 1.1.2019 – 31.12.2019 rezulton një total çështjesh prej 7221 (shtatëmijë e dyqind e njëzet e një) çështje me objekt: "pensione ushqimore"; 1134 (njëmijë e njëqind e tridhjetë e katër) çështje me objekt: "takim me fëmijë"; dhe 13 (trembëdhjetë) çështje me objekt "kujdestari fëmije". 7129 çështje "pensione ushqimore" janë në ekzekutim të vazhdueshëm, nga këto, 2754 çështje me objekt: "pensione ushqimore" nuk shlyhet detyrimi për pamundësi paguese nga ana e debitorit dhe veprimet procedurale përsëriten në mënyrë të vazhdueshme, për verifikim të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të tij, me qëllim ekzekutimin e detyrimit; për 216 çështje detyrimi shlyhet pjesërisht dhe jo i plotë, gjithashtu për paaftësi paguese; 67 çështje janë ekzekutuar tërësisht dhe në zbatim të nenit 125, të ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, janë aplikuar 55 kallëzime penale për mosdhënie të mjeteve për jetesë ndaj debitorëve.

- Referuar të dhënave progresive janar 2020 – 30 prill 2020 rezulton një total çështjesh prej 7309 çështje me objekt: "pensione ushqimore", 1115 çështje me objekt: "takim me fëmijë" dhe 10 (dhjetë) çështje me objekt: "kujdestari fëmije".

- Për periudhën 1.1.2020 – 30.9.2020 rezulton një total çështjesh prej: 7432 çështje me objekt "pensione ushqimore", dhe 1203 çështje me objekt: "takim me fëmijë" dhe 14 çështje me objekt: "kujdestari fëmije". 7205 çështje "pensione ushqimore" janë në ekzekutim të vazhdueshëm, nga këto, 2932 çështje me objekt: "pensione ushqimore" nuk shlyhet detyrimi për pamundësi paguese nga ana e debitorit dhe veprimet procedurale përsëriten në mënyrë të vazhdueshme, për verifikim të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të tij, me qëllim ekzekutimin e detyrimit; për 228 çështje detyrimi shlyhet pjesërisht dhe jo i plotë, gjithashtu për paaftësi paguese; 222 çështje janë ekzekutuar tërësisht dhe në zbatim të nenit 125, të ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, janë aplikuar 43 kallëzime penale për mosdhënie të mjeteve për jetesë ndaj debitorëve.

Shtojca 4. Kuadri ligjor për barrën e provës në rastet e diskriminimit

- Ligji nr. 10221/2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", parashikon shpërndarjen/zhvendosjen e barrës së provës në rastet e diskriminimit, në nenin 36, pika 6, ku përcaktohet se: "Pasi paditësi paraqet prova, mbi të cilat bazon pretendimin e tij dhe në bazë të të cilave gjykata mund të prezumojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji.".

- Kodi i Procedurave Administrative, i miratuar me ligjin nr. 44/20151, parashikon një rregullim të posaçëm për barrën e provës për rastet e diskriminimit, në nenin 82, pika 2, ku përcaktohet se: "Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj".

- Kodi i Punës, me ndryshimet që i janë bërë me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015, parashikon rregullim të posaçëm për rastet e diskriminimit në punësim dhe profesion, në nenin 9, pika 10, ku përcaktohet se: "Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë".

Shtojca 5. Të drejtat e viktimës së veprës penale

- Neni 58, i Kodit të procedurës Penale, shtuar pika 3, me ligjin nr. 8813, datë 13.6.2002, dhe ndryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, parashikon se:

1. Viktima e veprës penale ka të drejtë:

a) të kërkojë ndjekjen penale të fajtorit;

b) të përfitojë kujdes mjekësor, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat ose institucionet përgjegjëse për ndihmën ndaj viktimave të veprës penale;

c) të komunikojë në gjuhën e saj dhe të ndihmohet nga një përkthyes, interpretues i gjuhës së shenjave ose lehtësues i komunikimit për personat me aftësi të kufizuara, në të folur dhe në të dëgjuar;

ç) të zgjedhë mbrojtës dhe, kur është rasti, të përfitojë ndihmë juridike falas, sipas legjislacionit në fuqi;

d) të kërkojë në çdo kohë informacion për gjendjen e procedimit, si dhe të njihet me aktet e provat, pa cenuar parimin e sekretit hetimor;

dh) të kërkojë marrjen e provave, si dhe të parashtrojë kërkesa të tjera përpara organit procedues;

e) të informohet për arrestimin e të akuzuarit dhe lirimin e tij, në kushtet e caktuara në këtë Kod;

ë) të njoftohet për mosfillimin e procedimit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;

f) të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;

g) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;

gj) të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;

h) të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;

i) të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar;

j) të ushtrojë të drejta të tjera të parashikuara nga ky Kod.

2. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre.

3. Viktima që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron të drejtat e saj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit të tij, përveçse kur kjo nuk është në interesin e viktimës. Kur vëren papajtueshmëri mes interesave të viktimës dhe atyre të përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit, gjykata cakton një kujdestar të posaçëm, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes.

4. Trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtat e parashikuara në shkronjat "a", "e", "ë", "f ", "g" dhe "j", të paragrafit 1, të këtij neni. Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor.

- Neni 58/a, i Kodit të Procedurës Penale, i shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, parashikon se përveç të drejtave të parashikuara në nenin 58 dhe parashikimeve të tjera të këtij Kodi, si dhe legjislacionin e posaçëm për të miturit, viktima e mitur ka të drejtë:

a) të shoqërohet nga një person i besuar prej tij;

b) të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale;

c) të kërkojë, nëpërmjet përfaqësuesit, që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut.

2. Organi procedues duhet të trajtojë viktimën e mitur të veprës penale duke mbajtur parasysh moshën, personalitetin dhe rrethana të tjera, me qëllim shmangien e pasojave të dëmshme për zhvillimin dhe edukimin e saj të ardhshëm.

3. Nëse ekziston mundësia që viktima është e mitur dhe mosha e viktimës nuk dihet, prezumohet se ajo është e mitur.

4. Viktima e mitur pyetet pa vonesë nga persona të specializuar për këtë qëllim. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, biseda regjistrohet me mjete audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Ky regjistrim mund të përdoret si provë në procedimin penal dhe vlerësohet së bashku me provat e tjera, sipas kritereve që parashikohen nga paragrafi 4, i nenit 361/a, të këtij Kodi. Kur viktima e mitur është nën 14 vjeç, biseda zhvillohet në mjedise të përshtatura për të.

- Neni 58/b, i Kodit të Procedurës Penale, i shtuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, parashikon se veç të drejtave të parashikuara në nenet 58 dhe 58/a, të këtij Kodi, viktima e abuzuar seksualisht dhe viktima e trafikimit të qenieve njerëzore kanë gjithashtu të drejtë:

a) të pyeten pa vonesë nga një oficer i policisë gjyqësore ose prokuror i të njëjtës gjini;

b) të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me jetën private, e cila qartësisht nuk ka lidhje me veprën penale;

c) të kërkojnë të dëgjohen nëpërmjet mjeteve audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi.

Shtojca 6: Kuadri ligjor kundër trafikimit të qenieve njerëzore

- Ligji nr. 13/2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, 'Për të Huajt'", parashikon një mbrojtje më të mirë për viktimat e huaja të trafikimit. Neni 53/b (lëshimi i lejes së qëndrimit për arsye humanitare) dhe neni 54 (lëshimi i lejeve të qëndrimit për viktimat e trafikimit) përcaktojnë procedurat për lëshimin e lejes së qëndrimit për viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, qëllimet e reflektimit për një periudhë prej 3 muajsh (neni 54) dhe sigurimin e lejes së qëndrimit për mbrojtje afatgjatë.

- Ligji nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", ka për qëllim rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe programeve publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimit profesional. Ky ligj i përfshin viktimat e trafikimit apo viktimat e mundshme të trafikimit te grupet e veçanta të punëkërkuesve të disavantazhuar në tregun e punës (shkronja i), pika 4, neni 3. Kategoria e viktimave të trafikimit apo viktimave të mundshme të trafikimit përfitojnë nga shërbimet e punësimit dhe programet e nxitjes së punësimit në zbatim të ligjit për nxitjen e punësimit. Në 15 janar 2020, u miratua vendimi i Këshillit të Ministrave "Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale". Sipas këtij vendimi, viktimat e trafikimit të regjistruar si punëkërkues të papunë përfitojnë nga programi i punësimit. Programi i punësimit është një program njëvjeçar punësimi (shkronja a) dhe c), seksioni III, VKM-ja dt. 15/2020).

- Ligji nr. 34/2019, "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara", qëllimi i këtij ligji është miradministrimi dhe përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga organet e drejtësisë dhe pasurive të sekuestruara me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimi financiar i viktimave të krimit.

- Ligji nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën r Shqipërisë" (i cili ka hyr në fuqi në 18.7.2019) ka për qëllim të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore; në nenin 4, germa "x", dhe në nenin 7, "Përfituesit e ndihmës ekonomike", germa "ç" viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre përfitojnë ndihmë ekonomike.

- Ligji nr. 22/2018, "Për strehimin social", i cili, ndër të tjera parashikon me përparësi kushtet për strehimin e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit (neni 16 "Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve"), subvencionimin e qirasë për VT/VMT (neni 34 "Rregullat e përgjithshme mbi subvencionimin e qirasë") dhe përparësi në përmirësimin e kushteve të banimit (neni 43 "Përfituesit nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit"); dhe te kreu X "Programi i banesave të specializuara ka një nen të veçantë, neni 60 "Banesat e specializuara për viktimat e

trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje", ku parashikohet që: Banesat e specializuara për viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje pajisen me shërbimin e punonjësve të specializuar socialë dhe u garantohet mbrojtje nga punonjësit e Policisë së Shtetit në rastet e rrezikut për jetën dhe shëndetin; duhet të pajisen me infrastrukturën e nevojshme për njoftimin e policisë, në raste rreziqesh ose emergjencash; jepen me qira, duke iu nënshtruar respektimit të kushteve, të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga programi i banesave sociale me qira, i parashikuar në këtë ligj.

- Ligji nr. 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (i miratuar në datën 30.3.2017 dhe hyrë në fuqi në datën 1 gusht 2017). Ndryshimet e bëra, e sjellin KPP-në në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare të parashikuara nga instrumentet ndërkombëtarë, në të cilët Shqipëria bën pjesë dhe nëpërmjet këtyre ndryshimeve janë përmirësuar ndjeshëm të drejtat dhe pozita e viktimës së veprave penale, duke përfshirë edhe parashikime të posaçme për viktimën e trafikimit të qenieve njerëzore. Më konkretisht, është prezantuar detyrimi për pjesëmarrjen si palë në proces të viktimës së veprës penale, duke garantuar aksesin e saj në procesin penal, janë shtuar nene të tjera, specifikisht për viktimat e trafikimit, në të cilat janë parashikuar si figura të posaçme viktima e mitur dhe viktima e abuzuar seksualisht apo subjekt i trafikimit përkatësisht neni 58, 58/a dhe 58/b, 59, 60 dhe 61 i KPP-së.

- Në nenin 75/a, të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon ndër të tjera, çdo vepër penale të kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal. Pra, trafikimi i qenieve njerëzore përfshihet në kompetencat e kësaj gjykate, vetëm në rast se vepra penale ka qenë produkt i veprimtarisë së grupit të strukturuar kriminal, organizatave terroriste, apo banda e armatosur. Në të kundërt, këto lloj veprash vijojnë të gjykohen nga gjykatat e rretheve gjyqësore, në varësi të kompetencës së tyre tokësore dhe lëndore. Kjo gjykatë ka juridiksion në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë për gjykimin e çështjeve të mësipërme.

- Ligji nr. 37/2017, "Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur" (i miratuar në datën 30.3.2017, hyri në fuqi më 1 janar 2018). Qëllimi i këtij Kodi është të garantojë një kornizë ligjore për drejtësinë penale për fëmijët, të promovojë riintegrimin e fëmijës në konflikt me ligjin penal dhe marrjen nga ana e fëmijës me një rol konstruktiv në shoqëri, mbrojtjen e të drejtave të fëmijës viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale dhe të parandalojë riviktimizimin dhe viktimizimin dytësor të fëmijës që ka qenë më parë viktimë e një vepre penale.

- Ligji nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", përcakton qartë se çfarë do të thotë mbrojtje e fëmijës, duke qartësuar se cilat janë "masat e mbrojtjes" që mund të aplikojnë punonjësit kur konstatojnë raste të fëmijëve që janë në situatë të pasigurt për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Ligji për herë të parë parashikon mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge në kuadër të mbrojtjes që i garantohet fëmijëve që punojnë dhe shfrytëzohen për punë, adresimin e formave të ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve siç është bulizmi, dhuna në shkolla, dhuna në familje, abuzimi seksual, shfrytëzimi ekonomik dhe fëmijët në situatë rruge, siguria e fëmijëve në mjedisin digjital, fëmijët e pashoqëruar ose viktima të trafikimit, etj.

- Ligji nr. 70/2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, 'Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pronës'", parashikon se dispozitat e tij zbatohen për pasuritë e personave që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, mbi të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm, për kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet e Kodit Penal të "Trafikimit të personave të rritur" dhe "Trafikimit të të miturve". Ky ligj ofron një mjet tjetër me të cilin VT-të mund të fitojë kthimin nëpërmjet Skemës së Kompensimit të Shtetit dhe përcakton krijimin e një fondi të posaçëm për parandalimin e krimit të organizuar. Ky fond përdor si burim, pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara (pasuritë konfiskohen dhe konfiskohen me vendimin e Gjykatës). Fondi i veçantë është caktuar për qëllime sociale, duke përfshirë rehabilitimin dhe integrimin e

viktimave të trafikimit (neni 37/2-c). Neni 37/3-b parashikon që nga ky fond përfitojnë edhe OJQ-të, duke përfshirë edhe strehëzat.

- Ligji nr. 32/2017, datë 30.3.2017, "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë".

- Ligji nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", parashikon ndihmë juridike për viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme të trafikimit, i përjashton nga taksat gjyqësore viktimat e trafikimit dhe dhunës në familje dhe krijon zyra lokale të ndihmës juridike. Qëllimi kryesor i ligjit është që kategoritë në nevojë, të cilët janë më të diskriminuarit në lidhje me qasjen në drejtësi, do të përfitojnë nga shërbimet falas të ndihmës juridike të ofruar nga shteti. Gjithashtu, një tjetër qëllim shumë i rëndësishëm i ligjit është që të bëjë shërbimin profesional dhe të specializuar. Eliminimi i korrupsionit në mes të avokatëve.

- Ligji nr. 518, datë 4.9.2018, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror, komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar".

- VKM-ja nr. 499, datë 29.8.2018, "Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit", me të cilën u miratuan Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit. PSV-të janë dokumenti bazë për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe asistencën e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit. Qëllimi i miratimit të PSV-ve është mbrojtja, përfshirë identifikimin në kohën dhe mënyrën e duhur të viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit, të rritur apo të mitur, shqiptarë, të huaj apo persona pa shtetësi, për të gjithë llojet e shfrytëzimit, të trafikimit të brendshëm apo ndërkombëtar, të lidhur apo jo me krimin e organizuar.

- VKM-ja nr. 770, datë 26.12.2018, "Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018 – 2020", me të cilën u miratua Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër trafikimit të personave 2018 – 2020. Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave shpreh përkushtimin e shtetit dhe qeverisë shqiptare, të institucioneve shtetërore dhe joshtetërore, të aktorëve antitrafikim që punojnë në strukturat publike dhe jopublike, për të minimizuar fenomenin e trafikimit të personave. Aktivitetet e parashikuara në PKV 2018 – 2020 kanë si synim të përmirësojnë funksionimin e një sistemi gjithëpërfshirës nëpërmjet forcimit të mekanizmit të identifikimit, mbrojtjes dhe riintegrimit të viktimave të trafikimit. Aktivitetet parandaluese në këtë Plan Veprimi adresojnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe informimit publik lidhur me legjislacionin kombëtar e Konventat Ndërkombëtare antitrafikim, me të gjitha format e trafikimit të personave (trafikimi i brendshëm, shfrytëzimi për punë të detyruar të fëmijëve dhe të rriturve, lypja nga fëmijët, fëmijët në situatë rruge etj.), si dhe pasojat e tij.

Shtojca 7. Të dhënat në lidhje me hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin e trafikantëve të qenieve njerëzore

Shtojca 7.1.1 Të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Viti 2016

- Policia e Shtetit ka identifikuar gjithsej 69 raste të veprave penale të trafikimit në persona, si dhe 103 raste të veprave penale që kanë lidhje me fushën e Trafikimit në Persona, nga këto:

- 22 raste për "Trafikimi i të miturve" neni 128/b i Kodit Penal;

- 47 raste për "Trafikimi i personave të rritur" neni 110/a i Kodit Penal;

- 81 raste për "Shfrytëzim prostitucioni" neni 114/a i Kodit Penal;

- 22 raste për "Mbajtje të ambienteve për prostitucion" neni 115, i Kodit Penal.

- Operacionet policore të kryera gjatë vitit 2016:

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2016, lidhur me veprat penale të trafikimit të personave dhe vepra penale që kanë lidhje me fushën e trafikimit të personave, Policia e Shtetit ka realizuar 22

operacione policore me 222 autorë nga të cilët 41 të arrestuar, 17 janë shpallur në kërkim, 33 të ndaluar, 130 ndiqen në gjendje të lirë. Të ndara sipas veprave penale janë:

- "Trafikim të miturish" - 2 operacione policore;
- "Trafikim personash" - 6 operacione policore;
- "Shfrytëzim prostitucioni" dhe "Mbajtja e ambienteve për prostitucion" - 14 operacione policore.

- Operacionet ndërkombëtare:

Gjatë kësaj periudhe raportimi, nga Policia e Shtetit, janë kryer 2 operacione policore në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë si: SELEC, INTERFORCE, INTERPOL etj., si më poshtë:

- Operacioni policor "TEMPESTA II", gjatë të cilit u arrestuan 7 persona në kërkim ndërkombëtar si pjesë e një organizate kriminale, për veprat penale "Shfrytëzim femrash për prostitucion", si dhe "Trafikim lëndësh narkotike";
- Nga Europol është zhvilluar në Aachen, Gjermani, operacioni i përbashkët policor "CICCONIA AL.

Viti 2017:

- Gjatë vitit 2017, nga Strukturat për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme janë referuar në Prokurori 115 procedime penale, të cilat ndiqen me metoda speciale të hetimit, nga të cilat, 94 procedime penale janë për veprat penale "Trafikimi i personave", "Trafikimi i të miturve", "Shfrytëzim prostitucioni", "Kontrabandim të personave".
- Është rritur shkëmbimi i informacionit me partnerët ndërkombëtarë nëpërmjet zyrës së INTERPOL, EUROPOL, SELEC etj., me qëllim zhvillimin e hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta për goditjen e aktivitetit kriminal në drejtim të trafiqeve të paligjshme, kryesisht ndaj personave të dyshuar se trafikojnë persona të rritur dhe të mitur për qëllime shfrytëzim për prostitucion, lypje apo punë të detyruar.
- Një bashkëpunim shumë të mirë me partnerët ndërkombëtarë ka pasur në drejtim të shkëmbimit të informacioneve, si edhe në drejtim të zhvillimit të operacioneve të përbashkëta dhe hetimeve paralele. Kështu, gjatë vitit 2017, janë ndjekur 2 hetime të përbashkëta me homologët spanjollë, për veprën penale "Trafikim i personave të rritur", në ngarkim të një grupi prej 18 shtetasish shqiptarë. Janë evidentuar gjithsej 202 vepra penale për trafikim të personave, nga të cilat 154 zbuluar ose 76.3 %, me 260 autorë. Nga këto, janë identifikuar gjithsej 80 raste të veprave penale të trafikimit të personave, si dhe 122 raste të veprave penale që kanë lidhje me fushën e trafikimit të personave, konkretisht:
- 22 raste për "Trafikimi i të miturve", neni 128/b, i Kodit Penal;
- 58 raste për "Trafikimi i personave të rritur", neni 110/a, i Kodit Penal;
- 93 raste për "Shfrytëzim prostitucioni", neni 114/a, i Kodit Penal;
- 24 raste për "Mbajtje të ambienteve për prostitucion", neni 115, i Kodit Penal.
- Gjatë periudhës analizuese janë goditur 7 grupe kriminale me 92 persona të implikuar, për veprat penale "Shfrytëzim prostitucioni", "Ushtrim prostitucioni", "Mbajtje e ambienteve për prostitucion", parashikuar nga nenet 113, 114, 115 të Kodit Penal, me 69 autorë, nga të cilët 37 arrestuar, 8 ndaluar, 19 proceduar në gjendje të lirë dhe 5 janë shpallur në kërkim. Ka pasur një rritje në drejtim të evidentimit të veprave penale të trafikimit të personave, e cila përfshin trafikimin e personave të rritur dhe të të miturve, shfrytëzimin për prostitucion, si dhe një ulje të veprave penale të kontrabandimit të personave në 3 vepra. Mbështetur në të dhënat statistikore, si dhe në analizën e situatës kriminale, Shqipëria mbetet një vend origjine për trafikimin e shtetasve shqiptarë drejt vendeve të BE-së, por jo vetëm për qëllime prostitucioni dhe lypje.

Viti 2018

- Për sa i përket veprave penale që kanë lidhje me trafikimin e personave janë identifikuar gjithsej 93 raste, ku 77 janë për nenin 114 të Kodit Penal "Shfrytëzim prostitucioni" dhe 16 janë për nenin 115, të Kodit Penal "Mbajtja e lokaleve për prostitucion".

- Gjatë periudhës së raportimit, janë finalizuar vetëm 3 operacione në drejtim të veprat penale "Mbajtje e ambienteve për prostitucion", "Shfrytëzim prostitucioni", "Ushtrim prostitucioni", Nenet 114, 115, 113 dhe 283 të K. Penal me 25 autorë, 7 autorë të arrestuar në flagrancë, 16 ndiqen në gjendje të lirë dhe 4 në kërkim.

- Nga ana e Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, për vitin 2018 janë evidentuar 4 viktima të mundshme trafikimi, të gjitha femra me shtetësi shqiptare:

- 3 VMT janë për shfrytëzim prostitucioni – 3 femra – 3 shqiptare;

- 1 VMT është viktimë e dhunës në familje me elemente të trafikimit;

- 2 nga 4 VMT janë minorene.

Viti 2019:

- Për periudhën janar – dhjetor 2019, janë evidentuar gjithsej 134 vepra penale në fushën e trafiqeve të paligjshme: neni 110/a "Trafikimi i personave" – 34 vepra penale, neni 128/b "Trafikimi i të miturve" – 7 vepra penale dhe vepra penale që lidhen me trafikimin e personave neni 114 "Shfrytëzim prostitucioni" – 71 vepra penale, neni 115 "Mbajtja e lokaleve për prostitucion" – 20 vepra penale dhe "Përdorimi i shërbimeve nga persona të trafikuar" – 2 vepra penale,

Gjatë periudhës 1 janar – 30 prill 2020:

- Janë evidentuar, referuar gjithsej 107 vepra penale, 105 zbuluar, me 176 autorë të implikuar, nga të cilat: 67 të arrestuar, 2 ndaluar, 98 në gjykim të lirë, 11 larguar. Të ndarë sipas drejtimeve kemi:

- "Trafikim personash", evidentuar 6 V.P, me 10 autorë;

- "Trafikim të miturish", evidentuar 4 V.P, me 4 autorë;

- "Përdorimi shërbimeve nga persona të trafikuar", evidentuar 1-V.P, me 1 autorë;

- "Veprime që lehtësojnë trafikimin" evidentuar 1-V.P, me 1 autorë;

- "Ndihmë për kalim të paligjshëm" 66-V.P evidentuar me 132 autorë;

- "Shfrytëzim prostitucioni", evidentuar 20 V.P, me 20 autorë;

- "Mbajtje lokaleve për prostitucion", evidentuar 6-V.P, me 6 autorë

Shtojca 7.1.2 Të dhënat nga Prokuroria e Përgjithshme

Viti 2016

- Nga të dhënat statistikore të ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme, për periudhën janar-dhjetor 2016 rezulton se, prokuroria ka regjistruar 19 procedime penale me 4 të pandehur dhe persona nën hetim për veprën penale të "Trafikimit të personave të rritur", ndërkohë që gjithsej në hetim në këtë periudhë kanë qenë 55 procedime dhe 24 të pandehur dhe persona nën hetim, ndërkaq 5 procedime penale me 9 të pandehur janë dërguar për gjykim. Nga gjykata është vendosur deklarimi fajtor dhe dënimi për 13 të pandehur.

- Lidhur me "Trafikimin e të miturve", janë regjistruar 8 procedime penale, gjithsej në hetim në këtë periudhë kanë qenë 16 procedime dhe 13 të pandehur dhe persona nën hetim. Ndërkaq 3 procedime penale me 9 të pandehur janë dërguar për gjykim dhe nga gjykata është vendosur deklarimi fajtor dhe dënimi për 9 të pandehur.

Viti 2017

- Për periudhën janar – dhjetor 2017 rezulton se, Prokuroria ka regjistruar 24 procedime penale me 6 të pandehur dhe persona nën hetim për veprën penale të "Trafikimit të personave të rritur", ndërkohë që, gjithsej në hetim në këtë periudhë kanë qenë 55 procedime dhe 16 të pandehur dhe persona nën hetim, ndërkaq 1 procedim penal me 1 të pandehur është dërguar për gjykim.

- Lidhur me "Trafikimin e të miturve", janë regjistruar 6 procedime penale me 4 të pandehur dhe persona nën hetim, gjithsej në hetim në këtë periudhë kanë qenë 15 procedime me 7 të pandehur dhe persona nën hetim. Ndërkaq 3 procedime penale me 3 të pandehur janë dërguar për gjykim.

- Gjatë vitit 2017 është arrestuar në Greqi 1 shtetas shqiptar, me qëllim ekstradimi në Shqipëri, për të cilin autoritetet shqiptare kanë paraqitur kërkesa ekstradimi. Ky subjekt është shpallur në kërkim ndërkombëtar për kryerjen e veprës penale të "Trafikimit të personave të rritur".

- Në lidhje me letërporositë që autoritetet gjyqësore të huaja kanë dërguar në Shqipëri rezulton se janë dërguar 3 letërporosi nga Kosova, Holanda dhe Bosnjë-Hercegovina për veprën penale të "Trafikimit të personave".

- Ndërsa në lidhje me letërporositë që Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë (për shkak të kompetencës lëndore të ushtrimit të ndjekjes penale në çështjet e trafikimit të personave) ka dërguar për autoritetet gjyqësore të huaja rezulton se: janë dërguar 9 letërporosi për autoritetet e huaja për veprat penale të trafikimi të personave, përkatësisht 7 letërporosi për veprën penale të "Trafikimit të personave të rritur" drejtuar Belgjikës, Spanjës, Francës, Kosovës, 2 Italisë e Norvegjisë dhe 2 letërporosi për veprën penale të "Trafikimit të të miturve", drejtuar Spanjës.

Viti 2018

- Nga të dhënat statistikore të 9-të mujorit 2018 rezulton se, prokuroria ka regjistruar 16 procedime penale me 3 të pandehur/persona nën hetim për veprën penale të "Trafikimit të personave të rritur", që i përkasin trafikimit seksual, si dhe ka dërguar për gjykim 1 procedim penal me 3 të pandehur, me një viktimë të rritur.

- Për veprën penale "Trafikimi i të miturve", prokuroria ka regjistruar 3 procedime penale dhe 1 të pandehur, që i përkasin trafikimit seksual. Ndërkaq, 1 procedim penal me 3 të pandehur, me dy viktima të mitura është dërguar për gjykim dhe nga gjykata është vendosur deklarimi fajtor dhe dënimi i 3 të pandehurve, duke caktuar për secilin masa dënimi nga 10 vjet gjer në 18 vjet burgim.

Viti 2019

- Për veprën penale "Trafikimi i personave të rritur" të dhënat statistikore evidentojnë se, prokuroria nga viti 2018 ka mbartur 41 procedime penale, me 8 të pandehur apo persona nën hetim, prej të cilëve 3 persona me masë sigurimi "arrest në burg". Në 9 mujorin 2019 ka regjistruar 10 procedime penale me 4 të pandehur apo persona nën hetim, prej të cilëve 3 persona me masë sigurimi "arrest në burg", si dhe dërguar për gjykim 1 procedim penal me 1 të pandehur. Nga gjykata është vendosur deklarimi fajtor dhe dënimi për 2 të pandehur, shifër në të cilën përfshihen dhe persona të mbartur në gjykim.

- Për veprën penale "Trafikimi i të miturve", nga viti 2018 janë mbartur 11 procedime penale, me 2 të pandehur apo persona nën hetim, prej të cilëve 2 persona me masë sigurimi "arrest në burg". Në 9 mujorin 2019 janë regjistruar 2 procedime penale, me 2 të pandehur me masë sigurimi "arrest në burg" dhe janë dërguar për gjykim, 1 procedim penal me 2 të pandehur me masës sigurimi "arrest në burg". Gjykata ka vendosur deklarimi fajtor dhe dënimin e 4 të pandehurve, shifër në të cilën përfshihen dhe personat e mbartur në gjykim.

Shtojca 7.1.3 Të dhënat nga Ministria e Drejtësisë

Për periudhën janar – dhjetor 2016, Ministria e Drejtësisë rezulton të ketë statistikat e mëposhtme:

- Kërkesa për ekstradime të shteteve të huaja drejtuar Shqipërisë:
- 3 kërkesa për veprën penale "Trafikim i qenieve njerëzore".

Kërkesa për ndihmë juridike të shteteve të huaja drejtuar Shqipërisë

- 12 kërkesa për veprën penale "Trafikim i qenieve njerëzore".

Kërkesa për ekstradime të Shqipërisë drejtuar shteteve të tjera:

- 4 kërkesa për veprën penale "Trafikim i qenieve njerëzore".

Kërkesa për ndihmë juridike nga Shqipëria drejt shteteve të tjera:

- 30 letërporosi për veprën penale "Trafikim i qenieve njerëzore".

- Për periudhën janar – dhjetor 2017, Ministria e Drejtësisë rezulton të ketë statistikat e mëposhtme lidhur me veprat penale të "Trafikimit të personave të rritur", neni 110/a, "Trafikimit të femrave", neni 114/b dhe "Trafikimit i të miturve", neni 128/b dhe konkretisht:

Kërkesa për ekstradime të shteteve të huaja drejtuar Shqipërisë:

- 2 kërkesa për veprën penale "Trafikim i personave të rritur", neni 110/a.
Kërkesa për ndihmë juridike të shteteve të huaja drejtuar Shqipërisë:
- 2 kërkesa për veprën penale "Trafikim i personave të rritur", neni 110/a.
Kërkesa për ndihmë juridike nga Shqipëria drejt shteteve të tjera:
- 5 kërkesa për veprën penale "Trafikim i personave të rritur", neni 110/a;
- 1 kërkesë për veprën penale "Trafikim i femrave", neni 114/b;
- 3 kërkesa për veprën penale "Trafikim i të miturve", neni 128/b.
Për vitin 2018, Ministria e Drejtësisë rezulton të ketë statistikat e mëposhtme:
"Trafikimit të personave të rritur", neni 110/a:
- Letërporosi për Itali 3, për Belgjikë 1 dhe për Greqi 1;
- Ekstradim nga Italia 1 dhe nga Greqia 1.
"Trafikimi i të miturve", neni 128/b:
- Letërporosi për Kosovë 1;
- Ekstradim nga Italia 1.
Neni 114/a:
- Ekstradime nga Greqia 5;
- Ekstradim për Kosovë 1;
- Letërporosi për Greqi 3, për Itali 2, për Gjermani 1 dhe për Holandë 2.

Shtojca 7.1.4 Të dhënat e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda
Viti 2016
- Numri i personave të dënuar për veprat e trafikimit në njerëz, është 20 (njëzet), ku:
- 13 për "Trafikimi i personave të rritur" neni 110/a i Kodit Penal; dhe
- 7 për "Trafikimi i të miturve" neni 128/b i Kodit Penal.

Pra, gjatë kësaj periudhe raportimi, ka përfunduar gjykimi për 13 çështje penale, që i përkasin veprave penale të parashikuar nga nenet: 110/a/1/2/4, të Kodit Penal, dhe nenet 128/b/1/3, të Kodit Penal.

Numri i të pandehurve për të cilët është përfunduar gjykimi me vendim përfundimtar për vitin 2016, është 20 persona nga të cilët janë të dënuar me vendim fajësie si më poshtë:
Për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a, i Kodit Penal:
- 1 i dënuar me 16 vjet burgim.
Për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a/2, i Kodit Penal:
- 1 dënuar me 6 vjet e 8 muaj burim;
- 1 dënuar me 8 vjet burgim;
- 1 dënuar me 11 vjet burgim.
Për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a/4 të K. Penal:
- 1 dënuar me 16 vjet burim;
- 1 dënuar me 13 vjet burgim;
- 1 dënuar me 12 vjet burgim;
- 1 dënuar me 10 vjet burgim;
- 1 dënuar me 8 vjet burim;
- 1 dënuar me 5 vjet burgim;
- 1 dënuar me 4 vjet burgim;
- 2 dënuar me 15 vjet burgim.
Për veprën penale të parashikuar nga neni 128/b/1, i Kodit Penal:
- 2 të dënuar 6 vjet e 8 muaj vjet burg.
Për veprën penale të parashikuar nga neni 128/b/3, i Kodit Penal:
- 3 të dënuar me 15 vjet burg secili;
- 1 i dënuar me 15 vjet e 6 muaj burgim;
- 1 i dënuar me 10 vjet burgim.

Viti 2017

Për periudhën raportuese, numri i personave të dënuar për veprat e trafikimit të personave, është 7 (shtatë), ku:

- 6 persona për "Trafikimi i personave të rritur", neni 110/a i Kodit Penal; dhe
- 1 person për "Trafikimi i të miturve", neni 128/b i Kodit Penal.

Konkretisht:

- Për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a/2, i Kodit Penal: 1 i dënuar me 8 vjet e 8 muaj burgim;
- Për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a/3, i Kodit Penal: 1 i dënuar me 17 vjet;
- Për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a/4, i Kodit Penal: 4 të dënuar me nga 15 vjet secili;
- Për veprën penale të parashikuar nga neni 128/b/3, i Kodit Penal: 1 i dënuar me 16 vjet burgim.

Viti 2018

Gjykata ka përfunduar gjykimin për 4 çështje penale, që i përkasin veprave penale të parashikuar nga nenet: 128/b/1/3 dhe 114/b/1, të K. Penal. Aktualisht (në janar të vitit 2019), janë në gjykim 5 çështje penale, të cilat janë mbartur nga vitit 2018.

Numri i të pandehurve për të cilët është përfunduar gjykimi me vendim përfundimtar të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda për vitin 2018, është 4 persona, si më poshtë vijon:

Për veprën penale të parashikuar nga neni 128/b/1, i Kodit Penal:

- 1 (një) i dënuar me 7 (shtatë) vjet e 4 (katër) burgim;
- 1 (një) i dënuar me 11 (njëmbëdhjetë) vjet burgim;
- 1 (një) i dënuar me 18 (tetëmbëdhjetë) vjet burgim;
- 1 (një) i dënuar me 6 (gjashtë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim;

Shtojca 7.1.5 Të dhënat nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar[78]

Viti 2019

Numri i të dënuarve për trafikim të qenieve njerëzore, si dhe masat e dënimit të dhënë për ta nga gjykata, janë si më poshtë vijon:

- ka përfunduar gjykimi për 3 çështje penale, që i përkasin veprave penale të parashikuar nga nenet: 110/a/4 dhe 128/b/3, të K. Penal.
- numri i të pandehurve për të cilët është përfunduar gjykimi me vendim përfundimtar për vitin 2019, është 5 (pesë) persona:

Për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a/4 të K. Penal:

- 1 i dënuar me 10 vjet burgim, në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale;
- 1 i dënuar me 17 vjet burgim;

Për veprën penale të parashikuar nga neni 128/b/3 i K. Penal:

- 2 të dënuar me 15 vjet burgim;

Për veprën penale të parashikuar nga neni 114/2 i K. Penal:

- 1 i dënuar me 7 vjet e 6 muaj burgim.

Shtojca 7.1.6 Të dhënat nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda

Viti 2016

---

[78]Referuar vendimit nr. 286, datë 18.12.2019, "Për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar" të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku sipas të cilit është vendosur: "Fillimi i funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar më datë 19.12.2019", Gjykata e Apelit për Krime të Rënda emërtohet Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Nisur nga ky fakt statistikat janë të ndara në dy periudha kohore përkatësisht nga data 1 janar 2019 deri më 18 dhjetor 2019, si Gjykatë e Apelit për Krime të Rënda dhe nga data 19 dhjetor 2019 deri më 31 dhjetor 2019, si Gjykatë e Posaçme e Apelit për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar.

Numri i personave të dënuar për veprat e trafikimit në njerëz, është 16 (gjashtëmbëdhjetë), ku 4 për "Trafikimi i personave të rritur", neni 110/a i Kodit Penal dhe 10, për "Trafikimi i të miturve" neni 128/b i Kodit Penal. Për 2 prej tyre, është ndryshuar akuza nga neni 110/a i Kodit Penal, në nenin 124/b, të Kodit Penal.

Pra, për veprën penale të "Trafikimi i personave të rritur", parashikuar nga neni 110/a/4 i Kodit Penal, nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, janë dënuar gjithsej 7 (shtatë) persona, nga të cilët:

- 1 (një) person i dënuar me 13 (trembëdhjetë) vjet burgim;
- 1 (një) person i dënuar 12 (dymbëdhjetë) vjet burgim;
- 1 (një) person i dënuar me 10 (dhjetë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim;
- 1 (një) person i dënuar me 10 (dhjetë) vjet burgim;
- 2 (dy) persona i dënuar me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim;
- 1 (një) person i dënuar me 6 (gjashtë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.

Për veprën penale të "Trafikim i të miturve", në bashkëpunim, parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal, nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, janë dënuar gjithsej 6 (gjashtë) persona, nga të cilët:

- 1 (një) person i dënuar me 10 (dhjetë) vjet burgim;
- 1 (një) person i dënuar me 10 (dhjetë) e 4 (katër) muaj burgim;
- 2 (dy) persona të dënuar me 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjet burgim;
- 2 (dy) persona të dënuar me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim.

Për veprën penale të "Trafikim i të miturve", parashikuar nga neni 128/b/1 i Kodit Penal, nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, është dënuar 1 (një) person me 6 (gjashtë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.

Viti 2017

- Numri i personave të dënuar me vendim të formës së prerë, për veprën penale të "Trafikimit të personave" është 9 dhe 1 është shpallur i pafajshëm: 8 të dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a i Kodit Penal dhe 1 i dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 128/b i Kodit Penal.

Viti 2018

- Për veprën penale të "Trafikimit të personave" parashikuar nga neni 110/a/2 i Kodit Penal, janë gjykuar tre persona, nga të cilët 2 janë dënuar me nga 15 vjet burgim dhe 1 është dënuar me 8 vjet burgim.

- Për veprën penale të "Trafikimit të të miturve" në bashkëpunim, parashikuar nga neni 128/b/1 i Kodit Penal, janë gjykuar dy persona, nga të cilët 1 është dënuar me 7 vjet e 4 muaj burgim dhe 1 është dënuar me 11 vjet burgim.

Shtojca 7.1.7 Të dhënat nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Viti 2019

- Për periudhën nga data 1.1.2019 deri më 18.12.2019 në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda janë gjykuar 3 çështje penale që i përkasin veprave penale të parashikuara nga nenet 110/a/4 dhe 128/b/1 të Kodit Penal. Numri i të pandehurve për "Trafikim të qenieve njerëzore" për të cilët është përfunduar gjykimi me vendim përfundimtar është 3 çështje penale që i përkasim veprave penale të parashikuara nga nenet 110/a/4 dhe 128/b/1 të Kodit Penal, si më poshtë vijon:

Për veprën penale të parashikuar nga neni 110/a/4 i Kodit Penal:

- 1 i dënuar me 10 vjet burgim.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 128/b/l të Kodit Penal:

- 1 i dënuar me 10 vjet burgim;
- 1 i dënuar me 6 vjet e 8 muaj burgim.

Për veprën penale të parashikuar nga neni 114/l i Kodit Penal.

- 1 i dënuar me 2 vjet e 8 muaj burgim.

Për periudhën nga data 19.12.2019 deri më 31.12.2019 në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar janë gjykuar 2 çështje penale që i përkasim veprave penale të parashikuara nga nenet 110/a/4 dhe 128/b/1 të Kodit Penal.

Për veprën penale "Trafikim i personave të rritur" të parashikuar nga neni 110/a/4 i Kodit Penal dhe për veprën penale "Shfrytëzimi i prostitucionit" parashikuar nga neni 114/l i Kodit Penal:

- 2 (dy) person në gjykim për të cilin është shpallur moskompetencë lëndore e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe dërgimi i çështjes penale në Gjykatën e Apelit Durrës.

- Për veprën penale "Trafikim i të miturve" të parashikuar nga neni 128/b/3 i Kodit Penal:

- 2 (dy) person në gjykim për të cilin është shpallur moskompetencë lëndore e Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe dërgimi i çështjes penale në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Shtojca 7.1.8 Të dhënat nga Gjykata e Lartë

Viti 2016

- Numri i personave të dënuar për veprën penale të trafikimit të personave, është 5 (pesë), ku 2 për "Trafikimi i personave të rritur" neni 110/a i Kodit Penal dhe 3 për "Trafikimi i të miturve" neni 128/b i Kodit Penal.

Për sa i përket masës së dënimit, rezulton 1 (një) i dënuar me 14 vjet burgim dhe 1 (një) i dënuar me 11 vjet burgim për nenin 110/a të Kodit Penal "Trafikimi i personave të rritur". Lidhur me nenin 128/b të Kodit Penal "Trafikimi i të miturve" rezulton 1 (një) i dënuar me 15 vjet burgim dhe 2 (dy) të dënuar me nga 17 vjet burgim.

Viti 2017

- Nga të dhënat statistikore të Gjykatës së Lartë për Krime të Rënda rezulton se, numri i personave të dënuar për veprën penale të trafikimit të personave, është 6 (gjashtë), ku 5 prej tyre për "Trafikim i personave të rritur" neni 110/a i Kodit Penal dhe 1 për "Trafikim i të miturve", neni 128/b i Kodit Penal.

Viti 2018

- Për këtë periudhë raportimi, në Gjykatën e Lartë janë regjistruar 2 çështje me objekt trafikimin e të miturve, 2 çështje me objekt trafikimin e të rriturve, por kjo gjykatë nuk ka marrë asnjë vendim për këto çështje.

Viti 2019

- Gjatë periudhës raportuese, Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar çështje gjyqësore, si rezultat i pamundësisë objektive në krijimin e trupave gjykues me numër të mjaftueshëm gjyqtarësh për zhvillimin e proceseve gjyqësore përgjatë vitit 2019.

Shtojca 8. Të dhëna mbi trajnimet në fushën e trafikimit

Viti 2016:

- Me qëllim forcimin e kapaciteteve të strukturave shtetërore për zbatimin me rigorozitet të Procedurave Standarde të Veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave/viktimave të 15 mundshme të Trafikimit, Drejtoria e Antitrafikut në bashkëpunim me IOM zhvilluan trajnime në 12 qarqe dhe, konkretisht në datat: 23 – 24 shkurt Lezhë, Shkodër, 1 mars Elbasan; 2 mars Korçë; 9 mars Durrës, 11 mars Tiranë, 16 mars në Fier dhe 17 mars në Vlorë, 30 mars në Kukës, 31 mars në Dibër, 6 prill në Berat dhe 13 prill në Gjirokastër, ku morën pjesë 388 persona nga këto 173 punonjës të strukturave të Drejtorive Vendore të Policisë, komisariateve dhe drejtorive të kufirit dhe migracionit.

- Gjatë këtij viti, Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin, me qëllim forcimin e mekanizmave për mbrojtjen e viktimave në të gjithë zinxhirin e drejtësisë penale dhe rritjen e aftësive dhe kapaciteteve profesionale, ka realizuar trajnimin e 4 (katër) punonjëseve të policisë kufitare femra dhe 3 (tre) punonjësve të policisë kufitare së bashku me prokurorinë dhe gjykatën.

- Për identifikimin e imigrantëve të parregullt që hyjnë/dalin në/nga Shqipëria, të cilët mund të jenë VT/VTM, 134 punonjës të policisë kufitare janë trajnuar nga Caritas Shqiptar. Për marrjen e të dhënave biometrike të imigrantëve janë instaluar 15 *lavie scanera* në Pikat kryesore të Kalimit Kufitar dhe në Drejtoritë Vendore për Kufirin dhe Migracionin.

- Gjithashtu, ËVA është duke bashkëpunuar me TdH në zbatimin e një projekti me titull "Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe riintegrimi i fëmijëve migrantë në Shqipëri", i cili është zbatuar përgjatë periudhës tetor 2016 – shtator 2017 në Bashkinë Lezhë, me synim përmirësimin e qëndrueshëm të kushteve të jetesës së mbi 160 familjeve dhe fëmijëve vulnerabël për të parandaluar migracionin e pasigurt dhe për të ndihmuar riintegrimin e migrantëve të kthyer nëpërmjet qasjes në shërbime cilësore sociale, përfshirë, arsimin, trajnime profesionale apo ofrimin e mundësive që gjenerojnë të ardhura. Grupet e synuara nga kjo ndërhyrje në bashkinë Lezhë janë: 160 familje, fëmijë dhe të rinj vulnerabël ndaj migrimit të pasigurt dhe të rrezikshëm (duke synuar vajza dhe djem), 50 profesionistë nga Shërbimi Social Rajonal, NJMF-të, ofruesit e shërbimeve publike përfshirë institucionet arsimore, qendrat shëndetësore, qendrat e trajnimit profesional, qendrat komunitare, OJF-të që ofrojnë shërbime, grupe komunitare, KRAT-et, policia e kufirit dhe migracionit dhe seksioni i trafiqeve të paligjshme.

- Zyra e Koordinatorit Kombëtar dhe IOM me mbështetjen e organizatës së Kombeve të Bashkuara organizuan në datën 13 prill 2016 trajnimin ndërsektorial "Identifikimi, referimi dhe ndihma për viktimat e trafikimit".

- Gjatë muajit tetor 2016, në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut u zhvillua takimi informues për përmirësimin e zbatimit të MKR-së lidhur me luftën kundër trafikimit të personave, organizuar nga ZKKA, Policia e Shtetit dhe OSCE. Në këtë takim morën pjesë specialistët e trafiqeve pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Qarkut Gjirokastër. specialistë të Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit të Qarkut Gjirokastër, si dhe specialistë rendit pranë Komisariatit të Policisë Gjirokastër.

Viti 2017

- Masat për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave të mundshme të trafikimit dhe fëmijëve të pashoqëruar në situatë migrimi ka qenë një fushë tjetër e rëndësishme e trajtuar nga Prezenca e OSBE-së gjatë vitit 2017. Prezenca hartoi një analizë të nevojave të punonjësve të kufirit dhe migracionit për të zbatuar procedurat e përzgjedhjes së migrantëve të parregullt. Kjo analizë u prezantua në takimin e përbashkët UNHCR/OSBE mbi "Forcimin e identifikimit dhe referimit të migrantëve dhe refugjatëve në Shqipëri", ku bashkë me strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit u diskutuan hapat e mëtejshëm për përmirësimin e aftësive të strukturave ligjzbatuese në lidhje me trajtimin e migrantëve të parregullt. Prezenca gjithashtu bashkëpunoi me organizatën Terre des Hommes për hartimin e aktit nënligjor "Për kthimin dhe riatdhesimin e fëmijëve të pashoqëruar", në zbatim të ligjit "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës".

- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin në Shqipëri (IOM) në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme/Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Antitrafikim/Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, Komitetet Rajonale Antitrafik, Drejtoritë Rajonale Arsimore, dhe aktorë të tjerë, në muajt tetor 2017 – mars 2018 zhvilluan një fushatë informimi dhe ndërgjegjësimi për të parandaluar migracionin e parregullt nga Shqipëria në Bashkimin Evropian me temë "Zgjidhni Mundësitë, Jo Migracionin e Parregullt". Fushata iu përgjigj edhe prioriteteve të Qeverisë Shqiptare për të siguruar një përgjigje efektive ndaj menaxhimit të migracionit nga Shqipëria, nëpërmjet respektimit të regjimit të liberalizimit të vizave midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian (zona Shengen) dhe veçanërisht Holandës dhe Belgjikës.

- Gjatë periudhës raportuese, Akademia e Sigurisë në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) dhe Departamentin e Kufirit dhe Migracionit kanë zhvilluar trajnime me temë "Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore" dhe "Vlerësimi për të

miturit e pashoqëruar në flukset migratore". Në trajnime morën pjesë mbi 40 punonjës të Policisë së Kufirit dhe Migracionit.

- Caritas Shqiptar në bashkëpunim me Departamentin për Kufirin dhe Migracionin gjatë periudhës qershor-korrik 2017 në zbatimit të projektit "Strehim dhe akses për fuqizimin e grave migrante të rrezikuara nga trafikimi" ka organizuar 5 trajnime për mbrojtjen e personave të rrezikuar në qarqet Tiranë, Gjirokastër, Shkodër, Kukës dhe Korçë. Në trajnime morën pjesë punonjës të Drejtorive Vendore të Policisë, Drejtorive të Kufirit dhe Migracionit, Prefekturat, Shërbimi Social Shtetëror, Zyrat e Punës, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, Kryqi i Kuq, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, Shërbimi Informativ, "Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar", Drejtoritë e Shëndetit Publik, Bashkia dhe Këshilli i Qarkut, etj.

- Trajnimet u zhvilluan mbi mënyrën e përmirësimit të sistemit të mbrojtjes për gratë refugjate të rrezikuara, ku morën pjesë 206 punonjës, si dhe informuan mbi hapat konkretë që duhen ndërmarrë nga autoritetet vendase për ofrimin e shërbimeve mbrojtëse. Trajnimet synuan në fuqizimin e kapaciteteve të përfaqësuesve të institucioneve lokale me qëllim përmirësimin e procesit të identifikimit, referimit dhe mbrojtjes së grupeve të rrezikuara migratore, koordinimit të aktorëve kyç lokalë të përfshirë në ofrimin e shërbimet mbrojtëse, si dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave përgjegjëse për identifikimin dhe referimin me ato përgjegjëse për mbrojtjen dhe integrimin1.

Viti 2018

- Gjatë periudhës 2018–2019, organizata "Të Ndryshëm dhe të Barabartë" ka organizuar 6 trajnime njëditore në qarqet Tiranë, Fier, Elbasan, Dibër, Kukës dhe Korçë, për rritjen e njohurive dhe aftësive të agjencive të zbatimit të ligjit në lidhje me legjislacionin kundër trafikimit, veçanërisht ligjet e reja të miratuara gjatë zbatimit të reformës në drejtësisë me pjesëmarrjen e rreth 194 personave: përfaqësues të institucioneve dhe agjencive të zbatimit të ligjit, Prokurorisë, Gjykatës, Policisë, Përmbarimit, Institucioni i Prefektit (KRAT), Avokatë, Media, si dhe përfaqësues të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbime dhe ndihmë ligjore për viktimat e veprës penale. Këto aktivitete u përqendruan në aspektet praktike të veprimeve dhe rolit të secilit aktor në ofrimin e ndihmës për viktimat e trafikimit, përfshirë procedurat e aplikuara, pozicionin e viktimave në gjykata dhe të gjitha mjetet dhe standardet ligjore të zbatueshme në favor të viktimave të veprave penale, veçanërisht për viktimat e trafikimit.

- Në kuadër të projektit "Respektimi dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit njerëzor nga agjencitë lokale të zbatimit të ligjit", financuar nga Ambasada e SHBA-së/Zyra e Marrëdhënieve me Publikun, Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave në bashkëpunim me Qendrën psikosociale "Vatra" realizoi gjatë muajve janar-mars 2018, 5 trajnime me strukturat e policisë së shtetit dhe prokurorë të 5 qarqeve: Kukës, Fier, Durrës, Shkodër dhe Vlorë. Pjesëmarrës në trajnime ishin rreth 80 punonjës të agjencive lokale të zbatimit të ligjit, si: punonjës nga Sektori për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme, Policisë Kufitare dhe Migracionit, strukturat e Rendit Publik, oficerë të Policisë Gjyqësore dhe prokurorë të Qarqeve.

- Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave në bashkëpunim me OSBE-në, më datë 17 – 18 shtator 2018, në Akademinë e Sigurisë zhvilluan trajnimin me temë "Përdorimi i teknologjisë së informacionit në luftën kundër trafikimit të personave", me pjesëmarrjen e 20 efektivëve të policisë.

- Për vitin 2018, nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në total janë trajnuar 41 punonjës për çështjet kundër trafikimit të qenieve njerëzore e konkretisht; 23 punonjës kanë marrë pjesë në trajnimet me temë "Lufta Kundër Trafikimit të Qenieve njerëzore", organizuar nga FRONTEX dhe Akademia e Sigurisë dhe 18 punonjës kanë marrë pjesë në trajnimin me temë" Identifikimi i grupeve vulnerabël në flukset migratore mikse", organizuar në bashkëpunim me IOM.

- Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar trajnime me temë "Përmirësimi i zbatimit të MKR-së për identifikimin dhe referimin e VT/VMT dhe Procedurat Standarde të Veprimit, dhe

"Hetimet proaktive, trendi i trafikimit të qenieve njerëzore", ku kanë marrë pjesë 132 punonjës nga Strukturat e Hetimit të Trafiqeve të Paligjshme në DVP dhe Sektori për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme, si edhe përfaqësues nga Prokuroria për Krimet e Rënda.

- Për vitin 2018, janë zhvilluar rreth 70 trajnime ku kanë marrë pjesë punonjës nga Strukturat e Hetimit të Trafiqeve të Paligjshme në DVP, Sektori për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin si edhe përfaqësues nga Prokuroria për Krimet e Rënda, Prokurorisë, Gjykatës, Përmbarimit, Institucionit të Prefektit, PMF, punonjësve të shëndetësisë, arsimit, psikologët e shkollave, punonjësit e policisë, zyrat e punës, ISHP, si dhe përfaqësues të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbime për viktimat e veprës penale ku janë trajnuar rreth 173 punonjës.

- Për vitin 2018, në bashkëpunim me partnerët shtetërorë dhe joshtetërorë janë zhvilluar gjithsej rreth 236 takime dhe aktivitete informuese me nxënës, me të rinj dhe me komunitetin në kuadër të punës ndërgjegjësuese mbi fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe skllavërisë moderne.

- Në bashkëpunim me partnerët shtetërorë dhe joshtetërorë janë zhvilluar gjithsej 156 takime dhe aktivitete informuese me nxënës, me të rinj dhe me komunitetin në kuadër të punës ndërgjegjësuese mbi fenomenin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe skllavërisë moderne.

Viti 2019

- Është hartuar urdhri nr. 413, datë 5.4.2019, i Drejtorit të PSH për zbatim në të gjitha Drejtoritë Vendore të Policisë "Procedurat Standarde të Veprimit të Strukturave për Identifikimin, Mbrojtjen dhe Referimin e VMT-ve".

- Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar trajnime me temë "Përmirësimi i zbatimit të MKR-së për identifikimin dhe referimin e VT/VMT dhe Procedurat Standarde të Veprimit, dhe "Hetimet proaktive, trendi i trafikimit të qenieve njerëzore", ku kanë marrë pjesë 132 punonjës nga Strukturat e Hetimit të Trafiqeve të Paligjshme në DVP dhe Sektori për Hetimin e Trafiqeve të Paligjshme, si edhe përfaqësues nga Prokuroria për Krimet e Rënda.

- Nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në total janë trajnuar 41 punonjës për çështjet kundër trafikimit të qenieve njerëzore e konkretisht; 23 punonjës kanë marrë pjesë në trajnimet me temë Lufta Kundër Trafikimit të Qenieve njerëzore", organizuar nga FRONTEX dhe Akademia e Sigurisë dhe 18 punonjës kanë marrë pjesë në trajnimin me temë" Identifikimi i grupeve vulnerabël në flukset migratore mikse", organizuar në bashkëpunim me IOM.

- Vetëm në vitin 2019, nga strukturat e policisë janë zhvilluar 32 trajnime në të gjithë vendin, me pjesëmarrjen e 2036 punonjësve të policisë, sipas urdhrit nr. 413, datë5. 4.2019, të Drejtorit të Policisë së Shtetit.

- Gjithashtu nga Ambasada Amerikane në Tiranë, në bashkëpunim me Policinë Shqiptare, është zhvilluar një numër i konsiderueshëm trajnimesh në ILEA Budapest/Hungari me temë Lufta kundër "Trafikimit të Qenieve njerëzore", me pjesëmarrjen e 24 punonjësve të policisë nga struktura të Seksioneve të trafiqeve të paligjshme. Departamenti i Policisë Kriminale në bashkëpunim me OSBE, CEPOL, FRONTEKX, IOM, Ambasadën Austriake në Tiranë dhe Akademinë e Policisë kanë trajnuar 115 punonjës policie.

- Gjatë vitit 2019, shkolla e Magjistraturës në datat 6 – 7 shkurt, ka zhvilluar: aktivitetin trajnues me temë "Trafikimi i qenieve njerëzore; Ndjekja dhe gjykimi penal i veprave të trafikimit të qenieve njerëzore në përputhje me risitë në Kodin e Procedurës Penale; Të drejtat e viktimës së trafikimit gjatë procesit penal", me pjesëmarrës 1 prokuror, si dhe në datën 12 mars 2019 dhe 10 prill 2019 ka zhvilluar dy aktivitete trajnuese me temë "Viktima dhe procesi penal"; ndryshimet dhe shtesat e ligjit nr. 35/2017 dhe standardet ndërkombëtare; Mbrojtja nga riviktimizimi; Probleme të padisë civile në procesin penal; Dëmshpërblimi i viktimave; me pjesëmarrës 23 prokurorë.

- ZKKA në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (Departamenti për Kufirin dhe Migracionin), Drejtorinë e Azilit dhe Shtetësisë dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), në datën 8 maj 2019, zhvilluan në Korçë trajnimin kombëtar në zbatim

të projektit "Lufta kundër kontrabandimit të migrantëve përgjatë rrugës bregdetare të Ballkanit Perëndimor".

- ZKKA në bashkëpunim me Prokurorinë e Tiranës, Gjykatën për Krimet e Rënda, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (Departamenti për Kufirin dhe Migracionin), Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Koalicionin Kombëtar të Strehëzave Antitrafikim dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), në datën 21 maj, në Tiranë zhvilluan trajnimin me temë "Përqasja multidisiplinare dhe e orientuar drejt viktimës e ndërmarrë nga agjencitë e zbatimit të ligjit në hetimet për krimet lidhur me migracionin", në zbatim të projektit "Ngritja e kapaciteteve dhe mekanizmat për identifikimin dhe mbrojtjen e grupeve vulnerabël migrantë në Ballkanin Perëndimor - FAZA III". Në trajnim kanë marrë pjesë mbi 30 persona.

- Nga Ambasada Amerikane në Tiranë, në bashkëpunim me Policinë Shqiptare, është zhvilluar një numër i konsiderueshëm trajnimesh në ILEA Budapest/Hungari me temë Lufta kundër "Trafikimit të Qenieve njerëzore", me pjesëmarrjen e 24 punonjësve të policisë nga struktura të Seksioneve të trafiqeve të paligjshme. Departamenti i Policisë Kriminale në bashkëpunim me OSBE, CEPOL, FRONTEX, IOM, Ambasadën Austriake në Tiranë dhe Akademinë e Policisë kanë trajnuar 115-punonjës policie. Për vitin 2019, nga ASHMDF është identifikuar rasti i 1 fëmije në kufi. Rasti është referuar dhe menaxhuar nga strukturat përgjegjëse.

- Në vitin 2019, u zhvillua trajnimi me temë "Identifikimi dhe referimi i kategorive të cenueshme në flukset migratore", në bashkëpunim me IOM dhe Zyrën e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave. Në trajnim morën pjesë rreth 44 persona.

- Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit, ka realizuar sesione ndërgjegjësuese me qëllim rritjen e shërbimeve cilësore dhe treguesve për identifikimin e VT/VMT; Sesionet informuese janë realizuar në 6-të Komisariate e Tiranës, ku fokusi ka qenë me policimin në komunitet.

- Takime informuese në pikat kufitare Moriqan, Hani I Hotit me qëllim identifikimin dhe referimin e rasteve VT/VMT.

- Në periudhën shkurt- mars 2019, organizata Terre des hommes në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (Departamenti për Kufirin dhe Migracionin dhe ZKKA ka realizuar dy trajnime një ditore në Elbasan dhe Shkodër (me 30 pjesëmarrës) mbi zbatimin e Procedurave Standarde të Unifikuara të Veprimit (PSUV) për profesionistët e fushës. Pjesëmarrës në trajnim kanë qenë punonjës të policisë, punonjës social dhe psikologë të bashkive përkatëse.

- Në bashkëpunim me DPPSH (Departamenti për Kufirin dhe Migracionin), Drejtorinë e Azilit dhe Shtetësisë, si dhe IOM ka zhvilluar 9 trajnime, në Tiranë, Kukës, Korçë dhe Gjirokastër në zbatim të projektit "Lufta kundër kontrabandimit të migrantëve përgjatë rrugës bregdetare të Ballkanit Perëndimor".

Shtojca 9. Të dhëna mbi punësimin

Të dhëna administrative nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit në vite

	2015	**2016**	**2017**	**2018**	**2019**
Totali i punëkërkuesve të papunë	145,147	93,889	83,497	64,781	68,589
Punëkërkuese të papunë femra	73,208	49,735	44,220	34,172	36,523
Të papunë që mbështeten me të ardhura (Përfitues të ndihmës ekonomike dhe pagesës së papunësisë) Femra	65,458 33,061	45,738 23,960	41,251 21,181	22,345 11,225	24,651 12,454
Punëkërkues të papunë afatgjatë Femra	68,885 33,721	54,323 28,007	42,594 21,622	32,473 17,850	35194 19,221
Punëkërkues të papunë nga grupet e veçanta Femra	13,470 6,164	7,600 3,778	7,162 3,602	6.557 3,168	7,919 3,835

Totali i punësimeve të realizuara nga zyrat e punësimit Femra	1,222 53%	25,170 53,5%	23,136 50,5%	32,846 50,4%	30,391 49%
Të papunë të përfshirë në programet e nxitjes së punësimit Femra	5,805 70%	5,211 56%	5,264 62%	4,808 55%	5,338 50%
Punëkërkues të papunë që ndjekin falas kurse profesionale në qendrat publike Femra	13,887 5,672	12,710 5,678	9,461 4,454	8,470 4,779	8714 4,832



Shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe grup-moshës

Employment rate sex and age grup

%

Grup-mosha Age-group	Burra - Men		Gra- Women		Gjithsej - Total	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Total (15 +)	**59,0**	**60,1**	**45,3**	**46,9**	**52,1**	**53,4**
15-64	66,7	68,2	52,4	54,4	59,5	61,2
20-64	73,9	74,7	57,4	59,7	65,6	67,1
15-24	30,6	31,2	20,4	22,2	25,7	26,7
25-29	73,4	74,6	54,1	61,7	63,9	68,3
25-54	80,7	80,9	67,0	69,2	73,7	75,0
55-64	71,4	73,7	45,2	46,9	58,2	60,4
65+	18,7	19,6	10,3	11,5	14,4	15,4

Burimi: Anketa e Forcave të Punës

Source: Labour Force Survey

Shkalla e punësimit (15-64 vjec) (%)

Employment rate (15-64 years) (%)